FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 233

Tiranë – E mërkurë, 30 dhjetor 2020

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr. 11886, datë 28.12.2020	Për emërimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.....	19597
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1076, datë 24.12.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, si dhe për trajtimin e personelit mjekësor në strukturat e Forcave të Armatosura", të ndryshuar.....	19597
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1079, datë 24.12.2020	Për dhënie ndihme financiare nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë për mbështetjen e funksionimit të Këshillit Kombëtar Shqiptar në Serbi dhe zyrave të tij në Preshevë e Medvegjë dhe Këshillit Kombëtar të Shqiptarëve në Mal të Zi e zyrës koordinuese të tij në Plavë.....	19617
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1080, datë 24.12.2020	Për transferimin, në pronësi të Bashkisë Tiranë, të Njësisë Administrative Farkë, të pasurisë 353/12, zona kadastrale 3292.....	19617
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1081, datë 24.12.2020	Për miratimin e planit të veprimit të strategjisë ndërsektoriale "Agjenda Digjitale e Shqipërisë", 2020–2022.....	19620
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1082, datë 24.12.2020	Për transferimin, në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tiranë, të Njësisë Administrative Tiranë, të disa pronave.....	19621
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1083, datë 24.12.2020	Për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimet e legalizuara.....	19652
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1084, datë 24.12.2020	Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe të planit të veprimit 2020–2025.....	19696

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1086, datë 24.12.2020	Për miratimin e protokollit për ndryshim dhe shtesë në marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për bashkëpunim të ndërsjellë në fushën e sigurisë.....	19702
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1088, datë 24.12.2020	Për përcaktimin e mënyrës dhe të procedurave të regjistrimit e publikimit të të dhënave për pronarët përfitues, si dhe të njoftimit nga autoritetet shtetërore kompetente e nga subjektet e detyruara.....	19703
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1089, datë 24.12.2020	Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve, si dhe për përcaktimin e kritereve shtesë që duhet të përmbushin strukturat për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve.....	19709
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1091, datë 24.12.2020	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 220, datë 12.3.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kategorisë së tatimpaguesve dhe të kritereve të përdorimit të procedurës së thjeshtëzuar të fiskalizimit".....	19713
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1092, datë 24.12.2020	Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike eolike dhe veprave ndihmëse në zonën e Semanit, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria "Greentech" sh.p.k.....	19714
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1093, datë 24.12.2020	Për shpronësimin për interes publik të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga projekti "Ndërtimi i segmentit rrugor 'Hidrocentrali i Banjës – Gramsh dhe Ura e Trashovicës'" (shtesat).....	19716
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1094, datë 24.12.2020	Për miratimin e Metodologjisë Kombëtare të Llogaritjes së Performancës së Energjisë në Ndërtesa.....	19717
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1096, datë 24.12.2020	Për miratimin e buxhetit për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, për vitin 2021.....	19934
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1102, datë 24.12.2020	Për përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2021.....	19935
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1111, datë 24.12.2020	Për disa ndryshime në vendimin nr. 262, datë 6.4.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për shpalljen e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik në Spitallë, Durrës".....	19936

DEKRET
Nr. 11886, datë 28.12.2020

PËR EMËRIMIN E GJYQTARIT TË GJYKATËS KUSHTETUESE

Në mbështetje të neneve 93, 125, pika 1, 127, pika 3, 129, 149/d, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 7, 7/a, pika 4, 7/b, 7/dh, pika 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; pasi administrova Listën Përfundimtare të Renditjes së Kandidatëve të lejuar për kandidim, dhe Raportin e Arsyetuar të Renditjes për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtuese, vakancë e parakohshme, shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019, pasi u njoha me praktikën dokumentare të vendimmarrjes dhe vlerësimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për kandidatin e lejuar për plotësimin e kësaj vakance, përcjellë me shkresën nr. 551 prot., datë 28.12.2020; pasi vlerësova kandidaten e ngelur në garë për plotësimin e kësaj vakance; si dhe duke vlerësuar njëkohësisht nevojën jetike që ka vendi për plotësimin dhe funksionimin sa më parë dhe në mënyrë të qëndrueshme të Gjykatës Kushtetuese, në përfundim të shqyrtimit vendosa të,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Sonila Bejtja emërohet gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 1076, datë 24.12.2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 555, DATË 11.8.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE ME ARSIM TË LARTË DHE TË PUNONJËSVE TË INFERMIERISTIKËS NË SISTEMIN E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE NJËSINË MJEKËSORE USHTARAKE PRANË SPITALIT UNIVERSITAR TË TRAUMËS, SI DHE PËR TRAJTIMIN E PERSONELIT MJEKËSOR NË STRUKTURAT E FORCAVE TË ARMATOSURA", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Titulli i vendimit ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të personelit mjekësor, të punonjësve të tjerë me arsim të lartë dhe të punonjësve të personelit teknik të shkencave mjekësore, në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalin përkatës".

b) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen:

a) personeli mjekësor dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë të sistemit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë;

b) personeli teknik i shkencave mjekësore në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë;

c) personeli mjekësor, punonjësit e tjerë civilë me arsim të lartë dhe personeli teknik i shkencave mjekësore, në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës;

ç) personeli mjekësor ushtarak në strukturat e Forcave të Armatosura, vetëm për efekt të kryerjes së shërbimeve (roje, gatishmëri, urgjencë);

d) personeli mjekësor civil dhe personeli teknik i shkencave mjekësore, civilë, në strukturat e Forcave të Armatosura të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes;

dh) punonjësit e Njësisë së Helikopterëve të Transportit Mjekësor të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes;

e) personeli mjekësor dhe personeli teknik i shkencave mjekësore në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalin përkatës.".

c) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Struktura dhe nivelet e pagave për:

a) punonjësit e administrimit të përgjithshëm nga "specialist" deri në "titullar institucioni", në strukturat shëndetësore universitare, në spitalet rajonale, në spitalet psikiatrike dhe në spitalet bashkiake, janë sipas lidhjes nr. 1/AP, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) personelin mjekësor në strukturat shëndetësore universitare dhe në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, janë sipas lidhjes nr. 1, kreu 1.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

c) nëpunësit/punonjësit e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, janë sipas lidhjes nr. 1, kreu 1.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

ç) personelin mjekësor në Qendrën Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët, janë sipas lidhjes nr. 1, kreu 1.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

d) personelin mjekësor në spitalet psikiatrike, rajonale dhe bashkiake, janë sipas lidhjes nr. 1, kreu 1.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

dh) personelin mjekësor dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë në Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, janë sipas lidhjes nr. 1, kreu 1.5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

e) personelin mjekësor dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë në Qendrën e Shërbimeve Mjekësore, janë sipas lidhjes nr. 1, kreu 1.6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

ë) personelin mjekësor dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë në Qendrën e Inxhinierisë Biomjekësore, janë sipas lidhjes nr. 1, kreu 1.7, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

f) personelin mjekësor dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë në Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore, janë sipas lidhjes nr. 1, kreu 1.8, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

g) punonjësit me arsim të lartë në Qendrën Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore dhe Qendrën Kombëtare të Edukimit në Vazhdim, janë sipas lidhjes nr. 1, kreu 1.9, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

gj) punonjësit e Njësisë së Helikopterëve të Transportit Mjekësor të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes, janë sipas lidhjes nr. 1, kreu 1.10, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

h) personelin mjekësor dhe personelin teknik të shkencave mjekësore në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalin përkatës, janë sipas lidhjes nr. 8, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

i) personelin mjekësor civil, në strukturat e Forcave të Armatosura të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes, janë sipas lidhjes nr. 9, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

j) personelin teknik të shkencave mjekësore të sistemit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, personelin teknik të shkencave mjekësore, civilë, të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe personelin teknik të shkencave mjekësore në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, janë sipas lidhjes nr. 2 me krerët përkatës, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.".

ç) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Paga e grupit (kolona 1 e lidhjes nr. 1 me krerët përkatës, kolona 1 e lidhjes nr. 2 me krerët përkatës, kolona 3 e lidhjes nr. 6, kolona 1 e lidhjes nr. 7, kolona 1 e lidhjes nr. 8 dhe kolona 1 e lidhjes

nr. 9), përcaktohet sipas lidhjeve përkatëse të këtij vendimi dhe vlera e saj është sipas lidhjes nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

d) Në fund të pikës 6 shtohen fjalët "... lidhjes nr. 8 dhe lidhjes nr. 9.".

dh) Në fund të pikës 7 shtohen fjalët "... lidhjes nr. 5, lidhjes nr. 6 dhe lidhjes nr. 8.".

e) Pika 9/2 ndryshohet, me këtë përmbajtje:

"9/2 Për punonjësit e personelit teknik të shkencave mjekësore:

a) kur punojnë brenda rrethit të tyre, por larg vendbanimit dhe kthehen brenda ditës, 3 000 lekë në muaj.

b) kur nuk kthehen në vendbanim brenda ditës, 4 000 lekë në muaj.".

ë) Pas pikës 10, shtohen pikat 10/1 dhe 10/2, me këtë përmbajtje:

"10/1 Trajtimi financiar i punonjësve mjekësorë të korpusit akademik të Fakultetit të Mjekësisë, të Universitetit të Tiranës që shërbejnë në institucionet shëndetësore, për shërbimin që ofrojnë pranë këtyre strukturave, është si vijon:

	Kualifikimi/Grada/Titulli shkencor	Trajtimi financiar (lekë në muaj)
1	Shef shërbimi Profesor,	75 000
2	Shef shërbimi Profesor i asociuar	70 000
3	Shef shërbimi Doktor i shkencave	67 000

10/2 Trajtimi financiar i punonjësve mjekësorë të korpusit akademik të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Tiranës që shërbejnë pranë Institutit të Shëndetit Publik, për shërbimin që ofrojnë pranë këtyre strukturave, është 70 000 lekë në muaj.".

f) Pikat 15 dhe 15/1 shfuqizohen.

2. Në vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Në lidhjen nr. 6/6, emërtesa: "Mjek në strukturat e Forcave të Armatosura" shfuqizohet.

b) Në lidhjen nr. 8/1, emërtesa: " Mjek" shfuqizohet.

3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2021, të përballohen nga fondet e miratuara për politikat e reja të pagave, në ligjin e buxhetit për vitin 2021.

4. Në vendimin nr. 717, datë 23.6.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore", të ndryshuar, në lidhjen II/4, emërtesat "Ndihmësmjek" dhe "Infermier" shfuqizohen.

5. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2021.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Lidhja nr. 1 (Kreu 1/AP)

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e administrimit të përgjithshëm nga "specialist" deri në "titullar institucioni" në struktura shëndetësore universitare, në spitalet rajonale, spitalet psikiatrike dhe spitalet bashkiake

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Titullar institucioni në QSU "Nënë Tereza".	1	2%	0	118.600	25.000
2	Titullar institucioni në: - Spitalin Universitar të Sëmundjeve të Mushkërive "Shefqet Ndroqi" Tiranë; - Spitalin Universitar Obsetrik Gjinekologjik nr 1 dhe nr 2 Tiranë; - Spitalin Universitar të Traumës Tiranë.	1	2%	0	118.600	15.000
3	Titullar institucioni në: - Klinikën Stomatologjike Universitare Tiranë; - Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut. - Zëvendëstitullar institucioni në QSU "Nënë Tereza".	1	2%	0	110.000	15.000
4	Titullar institucioni në spitalet rajonale. Titullar institucioni në spitalet psikiatrike. Zëvendëstitullar institucioni në: - Spitalin Universitar të Sëmundjeve të Mushkërive "Shefqet Ndroqi" Tiranë; -Spitalin Universitar Obsetrik Gjinekologjik nr 1, nr 2 Tiranë; - Klinikën Stomatologjike Universitare Tiranë; - Spitalin Universitar të Traumës Tiranë; - Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.	1	2%	0	97.000	
5	Titullar institucioni në spitalet bashkiake.	1	2%	0	95.000	
6	Zëvendëstitullar institucioni në spitalet rajonale/psikiatrike/bashkiake.	1	2%	0	82.000	
7	Drejtor drejtorie në QSU "Nënë Tereza".	1	2%	0	82.000	
8	Përgjegjës sektori biomedikal.	1	2%	0	74.000	
9	Administrator për Polin e administrimit të integruar në QSU "Nënë Tereza".	1	2%	0	65.000	
10	Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes në spitalet universitare dhe në QKTGJ.	1	2%	0	61.000	
11	Përgjegjës sektori në sektorët mbështetës në spitalet universitare. Përgjegjës sektori Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.	1	2%	0	59.000	

	Përgjegjës sektori në Klinikën Stomatologjike Universitare.					
12	Përgjegjës sektori në spitalet rajonale dhe psikiatrike.	1	2%	0	49.000	
13	Specialist/inxhinier biomedikal në spitalet universitare dhe në QKTGJ.	1	2%	0	61.000	
14	Përgjegjës sektori në spitalet bashkiake. Specialist/inxhinier biomedikal në spitalet rajonale, psikiatrike dhe bashkiake.	1	2%	0	49.000	
15	Specialist auditi/Specialist në QSU "Nënë Tereza".	1 ose 2 ose 3	2%	0	43.000	
16	Specialist auditi/Specialist në: - spitalet universitare; - Klinikën Stomatologjike Universitare Tiranë; - Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.	1 ose 2 ose 3	2%	0	40.000	
17	Specialist auditi/Specialist në spitalet rajonale dhe psikiatrike.	1 ose 2 ose 3	2%	0	38.000	
18	Specialist në spitalet bashkiake.	1 ose 2 ose 3	2%	0	34.200	

Lidhja nr. 1 (Kreu 1.1)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin mjekësor në strukturat shëndetësore universitare dhe në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Shef Shërbimi infektiv në QSUNT.	1	2%	0	103.600	8000
2	Shef Shërbimi.	1	2%	0	103.600	
3	Shef reparti infektiv në QSUNT.	1	2%	0	90.300	8000
4	Shef reparti/klinike (kirurgji,urgjencë etj) Shef i Qendrës së Gruas. Shef njësie në QSUT.	1	2%	0	90.300	
5	Shef reparti/klinike reanimacioni.	1	2%	0	90.300	1100
6	Shef reparti/klinike psikiatrie.	1	2%	0	90.300	5000
7	Shef i Laboratorit Klinik Biokimik. Shef reparti kimioterapi. Shef laboratori. Shef i Qendrës së Diagnozës Molekulare.	1	2%	0	90.300	2200
8	Shef Reparti Rezatimi.	1	2%	0	90.300	4600
9	Shef sektori mjekësor. Shef farmacie.	1	2%	0	82.460	
10	Përgjegjës i Sektorit të Laboratorëve/ Shef i Bankës së Gjakut/Shef i Sektorit të Mbledhjes dhe Përpunimit të Gjakut në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.	1	2%	0	82.460	2500
11	Mjek. Stomatolog. Biolog,kimist,fizikant në preparatori. Mikrobiolog,parazitolog,virolog, mykolog. Përgjegjës qendre DDD. Përgjegjës njësie në QSUNT. Specialist fizkulture (fizioterapi neurologji).	1	2%	0	79.800	
12	Mjek/Biokimist/Biolog në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.	1	2%	0	79.800	1600
13	Mjek infeksionist në QSUNT.	1	2%	0	79.800	8000

14	Mjek kirurg (specialitete kirurgjikale). Mjek onkolog. Mjek fizioeterapevt. Mjek obseter gjinekolog. Mjek pneumoftiziatër.	1	2%	0	79.800	1100
15	Mjek radilolog. Toksikolog, alkolog, kimist, në laboratorin toksikologjik. Kimist në laboratorin biokimik. Fizikant në laboratorin biokimik. Biolog në laboratorin biokimik.	1	2%	0	79.800	1600
16	Mjek radiolog , në shërbimin infektiv në QSUNT. Mjek në kabinetin e ekografisë, në Shërbimin Infektiv në QSUNT.	1	2%	0	79.800	8000
17	Mjek kimioterapeut. Mjek hematolog. Mjek infeksionist. Mjek në pranim urgjence. Mjek në njësinë nozokomiale. Mjek laboratori. Mjek histopatolog. Mjek në shërbimin e gjakut.	1	2%	0	79.800	2000
18	Mjek në Inspektoriatin Sanitar. Inspektor sanitar. Farmacist.	1	2%	0	79.800	2500
19	Farmacist në Laboratorin Toksikologjik. Mjek në hemodinamikë.	1	2%	0	79.800	2800
20	Mjek anatomopatolog. Mjek anestezist, reanimator. Mjek në pavionin e rezatimit. Specialist ne qendren e diagnozës molekulare. Mjek pediater neonatolog. Fizikant kobalti.	1	2%	0	79.800	3700
21	Mjek, psikologë, punonjës socialë që punojnë në psikiatri.	1	2%	0	79.800	5000

Lidhja nr. 1 (Kreu 1.2)

Struktura dhe nivelet e pagave për nëpunësit/punonjësit e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor

I. **Në drejtorinë qendrore dhe në drejtoritë rajonale**

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Drejtor i Përgjithshëm.	1	2%	0	118.100	
2	Zëvendësdrejtor i përgjithshëm.	1	2%	0	106.000	
3	Drejtor drejtorie në drejtorinë qendrore.			0	100.000	
4	Drejtor i drejtorisë rajonale.	1	2%	0	104.000	
5	Përgjegjës sektori në drejtorinë qendrore. Drejtor drejtorie në drejtoritë rajonale.	1	2%	0	80.700	
6	Përgjegjës sektori në drejtoritë rajonale.	1	2%	0	61.000	
7	Specialist (niveli i parë).	1 ose 2 ose 3	2%	0	49.000	
8	Specialist (niveli i dytë).	1 ose 2 ose 3	2%	0	38.000	

II. **Në njësitë vendore të kujdesit shëndetësor**

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1.	Titullar i njësive vendore të kujdesit shëndetësor me qendër në qarqe.	1	2%	0	100.000	
2.	Titullar i njësive vendore të kujdesit shëndetësor me qendër në bashki.	1	2%	0	95.000	
3	Shef shërbimi.	1	2%	0	93.000	
4.	Përgjegjës sektori.	1	2%	0	46.000	

5.	Përgjegjës i shërbimeve të shëndetit mendor.	1	2%	0	72.800	5.000
6.	Mjek/specialist në shërbimet e shëndetit publik.	1	2%	0	64.400	7.000
7.	Mjek/Stomatolog/Farmacist/Inxhinier/Specialist në sektorin e shërbimit parësor.	1	2%	0	64.400	
8.	Mjek/Psikolog/Punonjës social që punojnë në shërbimet e shëndetit mendor.	1	2%	0	64.400	5.000
9.	Specialist.	1 ose 2 ose 3	2%	0	38.200	
10.	Kryeinfermjer/Kryevaksinator.	1	2%	0	53.200	
11.	Teknik specialitetesh shëndetësore.	1 ose 2 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	2%	0	47.000	1.100
12.	Infermjer/Terapist në shërbimet e shëndetit mendor.	1 ose 2 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	2%	0	47.000	5.000
13.	Infermjer.	1 ose 2 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	2%	0	47.000	

Lidhja nr. 1 (Kreu 1.3)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin mjekësor në Qendrën Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1.	Drejtor i Përgjithshëm.	1	2%	0	105.000	
2.	Zëvendësdrejtor i përgjithshëm.	1	2%	0	85.000	
3.	Shef shërbimi.	1	2%	0	82.000	
4.	Përgjegjës sektori.	1	2%	0	46.000	
5.	Mjek. Specialist pediatër neuropediatër. Psikiatër për fëmijë dhe adoleshentë.	1	2%	0	67.000	5.000
6.	Specialist psikolog, punonjës social/terapist/fizioterapist/Logopedist/Pedagogji e specializuar.	1 ose 2 ose 3	2%	0	64.400	5000
7.	Specialist promocioni.	1 ose 2 ose 3	2%	0	36.000	
8.	Specialist.	1 ose 2 ose 3	2%	0	34.200	

Lidhja nr. 1 (Kreu 1.4)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin mjekësor në spitalet psikiatrike, rajonale dhe bashkiake

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Shef Shërbimi në Anatomopatologji.	1	2%	0	90.300	3500
2	Shef shërbimi.	1	2%	0	82.000	
3	Shef Shërbimi Reanimacioni. Shef Shërbimi Infektiv. Shef Shërbimi Obsetrik Gjinekologjik. Shef Shërbimi Kirurgji. Shef Shërbimi Ortopedi.	1	2%	0	82.000	1100
4	Shef Shërbimi në imazheri. Shef Shërbimi Neuropsikiatri.	1	2%	0	82.000	1600
5	Shef Shërbimi Psikiatri.	1	2%	0	82.000	5000
6	Shef reparti/klinike. Përgjegjës/shef kabineti. Përgjegjës/shef laboratori /Poliklinike/fizioterapi.	1	2%	0	64.400	
7	Shef i Bankës së Gjakut. Shef Reparti Imazheri. Shef Reparti. Pneumoftiziatri.	1	2%	0	64.400	1100
8	Shef reparti/klinike Psikatri.	1	2%	0	64.400	5000
9	Përgjegjës Laboratori Klinik/Biokimik/Bakterologjik.	1	2%	0	64.400	2500
10	Përgjegjës/Shef reparti Anatomopatologji.	1	2%	0	64.400	3700
11	Mjek. Stomatolog. Kimist.	1	2%	0	64.400	
12	Mjek infeksionist. Mjek urgjence. Mjek laboratori. Kimist, fizikant laboratori.	1	2%	0	64.400	1100
13	Mjek onkolog. Mjek kirurg (specialitete të ndryshme kirurgjikale).	1	2%	0	64.400	1100

	Mjek hematolog. Mjek i bankës së gjakut. Mjek obsetër gjinekolog. Mjek pneumoftiziatër. Mjek fizioterapevt.					
14	Mjek radiolog.	1	2%	0	64.400	1600
15	Mjek higjenist. Farmacist.	1	2%	0	64.400	2500
16	Mjek anatomopatolog. Mjek anestezist reanimator.	1	2%	0	64.400	3700
17	Mjek,psikolog,punonjës socialë që punojnë në Psikiatri.	1	2%	0	64.400	5000

Lidhja nr. 1 (Kreu 1.5)

Struktura dhe nivelete e pagave për personelin mjekësor dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë në Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore

	EMËRTIMI	**PAGA MUJORE**				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Drejtor.	1	2%	0	100.000	7.000
2	Zëvendës drejtor.	1	2%	0	85.000	7.000
3	Shef sektori në sektorët për kontrollin e barnave.	1	2%	0	82.000	
4	Shef sektori në sektorët e tjerë	1	2%	0	50.500	
5	Farmacist. Analist. Mjek. Inxhinier për pajisjet mjekësore	1	2%	0	75.000	4000
6	Farmacist Inspektor për Kontrollin Farmaceutik.	1	2%	0	75.000	5000
7	Specialist.	1 ose 2 ose 3	2%	0	34.200	

Lidhja nr. 1 (Kreu 1.6)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin mjekësor dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë në Qendrën e Shërbimeve Mjekësore

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Drejtor	1	2%	0	74.000	
2	Shef sektori	1	2%	0	55.000	
3	Mjek.Stomatolog.	1	2%	0	64.400	
4	Specialist.	1 ose 2 ose 3	2%	0	42.000	

Lidhja nr. 1 (Kreu 1 .7)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin mjekësor dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë në Qendrën e Inxhinierisë Biomjekësore

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa per vjetersi (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK)	Shtesa per pozicion (SHP)	Shtesa per kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Drejtor.	1	2%	0	85.000	
2	Përgjegjës i zyrës teknike. Përgjegjës reparti.	1	2%	0	61.000	
3	Shef sektori.	1	2%	0	55.000	
4	Inxhinier biomedikal.	1	2%	0	49.000	
5	Specialist.	1 ose 2 ose 3	2%	0	34.200	

Lidhja nr. 1 (Kreu 1.8)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin mjekësor dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë në Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Drejtor i përgjithshëm.	1	2%	0	118.600	
2	Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm	1	2%	0	100.900	
3	Drejtor drejtorie	1	2%	0	81.800	
4	Përgjegjës sektori	1	2%	0	71.700	
5	Specialist (mjek)	1	2%	0	79.800	2000
6	Specialist.	1 ose 2 ose 3	2%	0	50.500	

Lidhja nr. 1 (Kreu 1.9)

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit me arsim të lartë në Qendrën Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore dhe Qendrë Kombëtare të Edukimit në Vazhdim.

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa per vjetersi (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK)	Shtesa per pozicion (SHP)	Shtesa per kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Drejtor.	1	2%	0	100.900	
2	Shef sektori.	1	2%	0	62.700	
3	Specialist për akreditimin. Specialist.	1 ose 2 ose 3	2%	0	50.500	

Lidhja nr. 1 (Kreu 1.10)

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Njësisë së Helikopterëve të Transportit Mjekësor të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në strukturat e ministrisë së Mbrojtjes

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Kryepilot	1	2%	0	81.800	8000
2	Pilot	1	2%	0	78.100	8000
3	Teknik Helikopteri fluturues	1	2%	0	74.800	

Lidhja nr.2 (Kreu 2.1)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin teknik të shkencave mjekësore në strukturat shëndetësore universitare dhe personelin teknik të shkencave mjekësore, civilë, në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Kryeinfermjer Shërbimi Psikiatrik		2%	0	56.000	6000
2	Kryeinfermjer shërbimi në shërbimin infektiv në QSUNT. Kryeinfermjer/Kryemami i Përgjithshëm		2%	0	56.000	8000
3	Kryelaborant në Shërbimin e Anatomisë Patologjike. Kryeinfermjer Shërbimi i Terapisë Intensive. Kryeinfermjer Shërbimi Onkologjik. Kryelaborant Rrezatim Kobalti. Kryelaborant në Histopatologji. Kryeinfermjerë të Repartit të Rrezatimit.		2%	0	56.000	3400
4	Kryeinfermjer Reparti/Njësi Psikiatrik.		2%	0	56.000	5000
5	Kryeinfermjer Reparti në Shërbimin Infektiv në QSUNT.		2%	0	56.000	8000
6	Kryeinfermjer shërbimi Neurokirurgji. Kryeinfermjer/kryemami reparti i Terapisë Intensive/Stroke dhe Post stroke. Kryeinfermjer në Hemodinamikë.		2%	0	56.000	2600
7	Kryeinfermjer kimioterapi. Kryelaborant klinik biokimik. Kryinfermjer në urgjencën e Sëmundjeve të Brendshme. Kryeinfermejer/mami salle. Kryeinfermjer/mami e dhomës së zgjimit. Infermjer në hemodinamikë. Kryelaborant imunolog,bakteriolog.		2%	0	56.000	1800
8	Kryeinfermjer shërbimi (kirurgji, neurologji, djegie plastike, kardiokirurgji, maksilofacial, infektiv, pediatrik infektive, obsetrik). Kryeinfermjer/kryemami në Repartin e Kirurgjisë. Kryemami turni në Kirurgji/në Obsetrikë. Kryeinfermjer reparti Infektiv. Kryeinfermjer reparti (fizioterapi, urologji, urgjencës së neurologjisë, neurokirurgji, onkologji). Kryeinfermjer/kryemami salle operacioni.		2%	0	56.000	1100
9	Kryeinfermjer shërbimi. Kryelaborant shërbimi. Kryemami shërbimi. Kryeinfermjer/Kryelaborant në QKTGJ		2%	0	56.000	
10	Infermjer/laborant në psikiatri.		2%	0	53.200	5000

11	Laborant histopatolog.		2%	0	53.200	3400
12	Infermjer/Mami reanimacioni, neonatologji. Infermjer ne dhomën e zgjimit.		2%	0	53.200	2650
13	Infermjer në kimioterapi.		2%	0	53.200	1800
14	Kryelaborant imazherie.		2%	0	53.200	1500
15	Specialist i sektorit të kujdesjeve infermjerore.		2%	0	53.200	1100
16	Kryeinfermjer në repartin e alergologjisë.		2%	0	53.200	
17	Laborant radiolog në onkologji.		2%	0	47.000	3700
18	Laborant rezatim kobalti.		2%	0	47.000	3400
19	Laborant në mjeksinë bërthamore.		2%	0	47.000	2650
20	Infermjer në njësinë e inspektoriatit sanitar dhe infeksioneve nazokomiale. Infermjer/mami në sallën e operacionit.		2%	0	47.000	2100
21	Kryeinfermjer reparti pranim urgjence. Laborant klinik biokimik. Infermjer në punktin e gjakut. Infermjer në hematologji. Infermjer në onkologji. Infermjere endoskopie. Infermjer/laborant bakterilog, imunolog.		2%	0	47.000	1800
22	Infermjer reparti radiologjik/angio CT. Teknik imazherie dhe angio CT. Laborant radiolog. Kryeinfermjer (pranim urgjence, djegie plastike, kirurgji). Kryemami në qendrën e gruas.		2%	0	47.000	1500
23	Infermjer/mami (kirurgji, maksilofaciale, neurokirurgji, kardiokirurgji, djegie plastike, obsetrike, gjinekologji/patologji barre/neonatologji). Infermjer salle. Infermjer/Laborant në QKTGJ.		2%	0	47.000	1100
24	Kryeinfermjer neonatologji. Kryemami pranimi. Kryeinfermjer në kabinetin e dializës. Kryemami/Kryeinfermjer reparti/klinik/turni. Kryeinfermjer konsultash në sëmundjet e brendshme. Kryelaborant bakterolog,imunolog,ortopedi stomatologjike).		2%	0	47.000	
25	Infermjer pavioni rezatimi.		2%	0	45.000	3310
26	Infermjer në shërbimin infektiv në QSUNT.		2%	0	45.000	8000
27	Infermjer pranim urgjence, (njësia e kordinimit të urgjencës).		2%	0	45.000	1800
28	Infermjer në hemodializë.		2%	0	45.000	1500
29	Infermjer fizioterapi.		2%	0	45.000	1100
30	Laborant (ezhe, ortopedi, stomatologji). Infermjer. Mami.Logopedi. Infermjer çerdhe për personelin. Kujdestar. Prozektor.		2%	0	45.000	
31	Kujdestar në psikiatri.		2%	0	39.550	5000

Lidhja nr. 2 (Kreu 2.2)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin teknik të shkencave mjekësore në Qendrën Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Infermjer.		2%	0	45.000	

Lidhja nr. 2 (Kreu 2.3)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin teknik të shkencave mjekësore në spitalet psikiatrike, rajonale e bashkiake dhe personelin teknik të shkencave mjekëore, civilë, në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura të sistemit të ministrisë së Mbrojtjes

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Kryeinfermjer i përgjithshëm në spitalet psikiatrike.		2%	0	56.000	6000
2	Kryeinfermjer reparti në spitale psikiatrike.		2%	0	56.000	5000
3	Kryeinfermier i përgjithshëm.		2%	0	56.000	1100
4	Laborant në Anatominë Patologjike		2%	0	53.200	3400
5	Kryelaborant në laboratorin klinik biokimik, bakterologjik. Kryeinfermjer (kirurgji , reanimacion, sallë operacioni, obsetrikë gjinekologji).		2%	0	53.200	1100
6	Kryeinfermjer.		2%	0	53.200	
7	Infermjer në psikiatri Laborant në psikiatri		2%	0	47.000	5000
8	Infermjer reanimacioni. Ndihmës anestezist. Ndihmës farmacist. Laborant radiologjie. Infermjer në imazheri. Infermjer salle. Infermjer në hemodializë.		2%	0	45.000	1500
9	Kryeinfermjer në poliklinikën e spitalit. Infermjer (fizioterapi, ergoterapi, logoterapi, neuropsikiatri, infektiv, dispanceri të sëmundjeve ngjitëse, kirurgji, ortopedi, obsetrikë, gjinekologji,pneumoftiziatri, onkologji,dispanceri). Infermjer në repartin e lindjes. Infermjer/laborant në bankën e gjakut, hematologji. Përgjegjës turni.		2%	0	45.000	1100
10	Kryeinfermjer në Qendrën e Sterilizimit. Infermjer pranim urgjence. Laborant klinik biokimik /bakteriologjik.		2%	0	45.000	600
11	Infermjer.		2%	0	45.000	
12	Kujdestar në Psikiatri.		2%	0	39.550	5000
13	Kujdestar në Pediatri. Ndihmës infermjer.		2%	0	39.550	

Lidhja nr. 2 (Kreu 2.4)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin teknik të shkencave mjekësore në Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Laborant.		2%	0	54.000	

Lidhja nr. 2 (Kreu 2.5)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin teknik të shkencave mjekësore në Qendrën e Shërbimeve Mjekësore

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa per vjetersi (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK)	Shtesa per pozicion (SHP)	Shtesa per kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Kryeinfermjer.		2%	0	56.000	
2	Infermjer. Ndihmës stomatologë.		2%	0	45.000	

Lidhja nr. 2 (Kreu 2.6)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin teknik të shkencave mjekësore në Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Kryeinfermier urgjence.		2%	0	56.000	2000
2	Infermier urgjence.		2%	0	53.200	2000

Lidhja nr. 2 (kreu 2.7)

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit në Njësinë e Helikopterëve të Transportit Mjekësor të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në strukturat e ministrisë së Mbrojtjes

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Teknik i përgjithshëm. Teknik elektrik.		2%	0	39.000	

Lidhja nr. 3

Vlera e pagës së grupit sipas nivelit arsimor

GRUPI	LLOJI I DIPLOMËS	PAGA NË LEKË
1	Master i Shkencave. Master i Arteve. Master Profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike. Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit te lartë.	14000
2	Master Profesional. Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.	11000
3	Bachelor. Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.	10000
4	Diplomë e shkollës së mesme për personelin teknik të shkencave mjekësore, Lidhja nr. 2	8000
5	Dëftesë lirimi (arsimi 8/9 vjeçar) dhe kurse infermierie, për personelin teknik të shkencave mjekësore, Lidhja nr. 2	6000

Lidhja nr. 4

Struktura dhe nivelet e pagave për mjekët me tituj dhe grada shkencore

KUALIFIKIMI/GRADA/TITULLI SHKENCOR	PAGA (LEKË/MUAJ)	Shtesat
Shef shërbimi nga kategoria "Profesor"	123.800	31.400
Shef shërbimi nga kategoria "Docent"	106.700	30.200
Profesor	121.000	31.300
Profesor i asociuar	105.200	30.100
Docent	95.800	29.500

Lidhja nr. 5

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e personelit me tituj akademikë, në Institutin e Shëndetit Publik

Nr rendor	Emërtimi	Paga	Shtesë për kushte pune.
1.	Zëvendës titullar institucioni nga kategoria "Profesor"	130.500	10.000
2.	Zëvendës titullar institucioni nga kategoria "Docent"/"Doktor"	123.800	10.000
3.	"Përgjegjës i Njësisë bazë nga kategoria "Profesor"	123.800	10.000
4.	"Përgjegjës i Njësisë bazë nga kategoria Docent/Doktor	106.700	10.000
5.	"Përgjegjës sektori nga kategoria "Profesor".	123.800	10.000
6.	"Përgjegjës sektori nga kategoria "Docent/Doktor	106.700	10.000
7.	Profesor	121.000	10.000
8.	Profesor i Asociuar	105.200	10.000
9.	Docent (Doktor)	95.800	10.000
10.	Docent (Master)	91.800	10.000
11.	Kërkues i parë	90.300	10.000
12.	Kërkues.	73.400	10.000

Lidhja nr. 6

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e tjerë me arsim të lartë në Institutin e Shëndetit Publik

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE					
		Kategoria	Paga e Grupit (PG	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	Shtesë për kushte pune
	1	2	3	4	5	6	
1	Titullar insitituciono	II-a	1	2%	0	118.100	10.000
2	Zëvendëstitullar ekonomik	III-a	1	2%	0	80.800	
3	Drejtor i Drejtorisë së Mbrojtjes nga Rrezatimet. Drejtor i drejtorisë së shërbimeve mbështetëse	III-a	1	2%	0	80.800	
4	Përgjegjës sektori në njësitë e përmbajtjes pa tituj e grada.	III-a/1	1	2%	0	75.000	
5	Përgjegjës sektori mbështetës.	III-b	1	2%	0	61.000	
6	Specialist në njësitë e përmbajtjes pa tituj e grada.	III-b	1 ose 2 ose 3	2%	0	61.000	
7	Specialist në sektorët mbështetës.	IV-b	1 ose 2 ose 3	2%	0	38.000	

Lidhja nr. 7

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin teknik të shkencave mjekësore në Institutin e Shëndetit Publik

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e Grupit (PG)	**Shtesa për vjetërsi (SHV)**	**Shtesa për Kualifikim (SHK)**	**Shtesa për pozicion (SHP)**	**Shtesa për kushte pune (SHKP)**
		1	**2**	**3**	**4**	**5**
1	Laborant mikrobiologji teknike laboratori/infermier në njësinë e epidemiologjisë dhe sëmundjeve infektive.		2%	0	45.000	8000
2	Laborant kimist, mikriobiolog, biokimist në njësinë e shëndetit dhe mjedisit dhe të vivariumit.		2%	0	47.000	3700

Lidhja nr. 8

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin mjekësor dhe personelin teknik të shkencave mjekësore në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalin përkatës

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Shef shërbimi.	1	2%	0	82.000	5000
2	Mjek të përgjithshëm. Mjek të specialiteteve të tjera. Stomatolog. Farmacist.	1	2%	0	64.400	4000
3	Kryeinfermjer.		2%	0	53.200	5000
4	Infermjer.		2%	0	45.000	5000

Lidhja nr. 9

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin mjekësor civil, në strukturat e Forcave të Armatosura të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE			
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)
		1	2	3	4
1	Mjek i përgjithshëm. Mjek të specialiteteve të tjera.	1	2%	0	64.400

VENDIM
Nr. 1079, datë 24.12.2020

PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE NGA KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR MBËSHTETJEN E FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT KOMBËTAR SHQIPTAR NË SERBI DHE ZYRAVE TË TIJ NË PRESHEVË E MEDVEGJË DHE KËSHILLIT KOMBËTAR TË SHQIPTARËVE NË MAL TË ZI E ZYRËS KOORDINUESE TË TIJ NË PLAVË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", me propozimin e Kryeministrit dhe ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e ndihmës financiare nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë për mbështetjen e funksionimit të Këshillit Kombëtar Shqiptar në Serbi dhe të zyrave të tij në Preshevë e Medvegjë dhe Këshillit Kombëtar të Shqiptarëve në Mal të Zi e të zyrës koordinuese të tij në Plavë, në masën:

a) 30 000 (tridhjetë mijë) euro, për Këshillin Kombëtar Shqiptar në Serbi dhe të zyrave të tij në Preshevë e Medvegjë;

b) 30 000 (tridhjetë mijë) euro për Këshillin Kombëtar të Shqiptarëve në Mal të Zi dhe të zyrës koordinuese të tij në Plavë.

2. Ky fond prej 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) eurosh të përballohet nga buxheti i miratuar për vitin 2021 për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, në programin "Shpenzime diplomatike jashtë shtetit".

3. Ngarkohet Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 1080, datë 24.12.2020

PËR TRANSFERIMIN, NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË, TË NJËSISË ADMINISTRATIVE FARKË, TË PASURISË 353/12, ZONA KADASTRALE 3292

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar; me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin, në pronësi të Bashkisë Tiranë, të Njësisë Administrative Farkë, të pasurisë 353/12, zona kadastrale 3292, sipas formularit, gjithsej 1 (një) fletë dhe planvendosjes, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, me qëllim për t'u përdorur në fushën e arsimit.

2. Pasuria e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohet listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 13.6.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Farkë, të qarkut të Tiranës".

3. Bashkisë Tiranë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve pasurinë e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Bashkia : Tiranë

Fusha e perdorimit te Prones:Arsimore

Identifikoi: Albana Hoxha (përgjegjës sektori) ,Rait Halidini (Specialist)
Ervin Nikolla Drejtor I Deleguar
Supervizoi Alban Dokushi,Drejtor (Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit)

Aprovoi: Erion Vellaj (Kryetar)

	A			B			C			
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
3	3292 K-34-100 -(26-B)	353/12	Ullishte	Fshati Selite Rr. Selita e Vjeter	3041		Arsim	Bashkia Tirane	Nj A Farke	shtet, v. 25, fq 222 Per ndertimin e shkollese se re sheshi F-3

PLANVENDOSJE

BASHKIA TIRANË Përgatiti: Specialisti Ing. Topograf RAIF HALIDINI DREJTORIA VENDORE TIRANË JUG	A. IDENTIFIKIMI I PASURISË ZONA KADASTRALE: 3292 NR. I PASURISË: 353/12 VOL.: 25 FQ.: 222 INDEKS HARTE: K-34-100-(26-B) SHKALLA: 1:2500 ADRESA E PASURISË: Rrethi: Tiranë Q/F: Selitë Rr/L: "Selitë e Vjetër" P/G: _____ Shk: _____ K: _____ Ap: _____ B. KUFIZIMET C: PRONARI VERI: 353/2 SHTET JUG: 118/33 LINDJE: 350; 128 PERENDIM: 353/13 D: Data: _____ Ora: _____

KRGJSH

KONTURI I PASURISË SË MIRATUAR ME VKB NR. 43, DATE 29.04.2020, PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË.
SIP. = 3041 M²



LEGJENDE		
1	X= 483828.69	Y= 4574825.90
2	X= 483874.03	Y= 4574803.23
3	X= 483873.68	Y= 4574796.29
4	X= 483862.91	Y= 4574785.67
5	X= 483830.17	Y= 4574758.73
6	X= 483813.52	Y= 4574757.51
7	X= 483816.45	Y= 4574770.51
8	X= 483791.72	Y= 4574792.38

VENDIM
Nr. 1081, datë 24.12.2020

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT TË STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE "AGJENDA DIGJITALE E SHQIPËRISË", 2020–2022

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të veprimit të strategjisë ndërsektoriale "Agjenda Digjitale e Shqipërisë", 2020–2022, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, ministritë dhe institucionet qendrore, të përmendura në tekstin e planit të veprimit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

PLANI I VEPRIMIT Strategjia Agjenda Digjitale e Shqipërisë
2020–2022

I. QËLLIMI STRATEGJIK: Strategjia ndërsektoriale "Agjenda digjitale e Shqipërisë 2015–2020" synon drejtimin më të koordinuar dhe më efikas të investimeve në sektorin e teknologjive të informacionit dhe komunikimeve, me qëllim ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarin dhe përmirësimin e jetesës.

II. QËLLIMI I POLITIKES: Strategjia "SNAD 2015–2020" është pjesë e kuadrit strategjik të hartuar nga qeveria shqiptare dhe mbulon të gjitha fushat e zhvillimit të shoqërisë e qeverisjes.

III. PROGRAMI BUXHETOR 1 QË KONTRIBUON PËR QËLLIMIN E POLITIKËS (Burimet financiare përcaktohen në bazë të planit të veprimit që shoqëron këtë strategji në aneksin 1, në përputhje me kostimin e PBA-së. Gjithashtu, janë marrë në konsideratë edhe burimet e tjera financiare, si: fondet IPA, donacionet apo dhe huat, nëpërmjet të cilave parashikohet të mbulohen boshllëqet financiare.)

Nr.	Masat për çdo objektiv	Referenca e masës me produktet e programit buxhetor	Institucionet përgjegjëse		Treguesit e zbatimit	Afatet për implementimin		Kosto indikative	Kosto (all, euro)		Burimi i financimit		Hendeku financiar	Statusi i aktivitetit
			Shkruaj institucionin përgjegjës (udhëheqës)	Institucion kontribuues (nëse ka)		Afati fillimit	Afati mbarimit				Buxhet i shtetit	Financim i huaj		
Prioriteti Strategjik I: Politika për zhvillimin e qeverisjes elektronike dhe ofrimi i shërbimeve publike interaktive për qytetarët dhe bizneset														
A	**Objektivi Specifik A:** *Shtimi dhe promovimi i shërbimeve elektronike, e-shërbimeve, për qytetarët dhe biznesin. Prioritet do të jetë rritja e transparencës dhe përmirësimi i shërbimeve në administratën publike sipas parimeve të iniciativës "Open Government Partnership";*	**(Plotësimi i kësaj kutie vlen vetëm për rezultatet, jo për objektivin)**				**2020**	**2021**							
	Shpenzim Digjitalizim i Arkivave për DPGJC-në		AKSHI	Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile			198,726,023	198,726,023	ALL		Buxheti i shtetit			
	Përmirësimi i Sistemit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit "Dua Punë"		AKSHI	SHKP		82,801,000		82,801,000	ALL		Buxheti i shtetit			
	Shërbim ekspozimi në *virtual tour* në 3D		AKSHI	Ministria e Kulturës dhe Agjencia për Bashkëqeverisje dhe Dialog		67,123,456		67,123,456	ALL		Buxheti i shtetit			
	Implementimi i platformës elektronike e-Transport		AKSHI	DPSHTRR			131,700,000	131,700,000	ALL		Fondet e DPSHTRR-së			
	Digjitalizimi i shërbimeve doganore		AKSHI	DPD		30,000,000	22,079,999	52,079,999	ALL		Buxheti i shtetit			
	Upgrade i regjistrit elektronik të pasurive të paluajtshme shtimi i një moduli për ofrimin e shërbimeve të ASHK-së me institucione		AKSHI	ASHK		9,913,579		9,913,579	ALL		Buxheti i ASHK-së			
	Ngritja e sistemit elektronik për menaxhimin e ankesave në KPP		AKSHI	KPP				145,564,000	ALL		Buxheti i shtetit			
	Përmirësimi i rrjetit të brendshëm për shkollat dhe blerje pajisje mbështetëse TIK për MASR-në		AKSHI	MASR		33,089,700		33,089,700	ALL		Buxheti i shtetit			
B	OBJEKTIV SPECIFIK B *Inovacioni kundër korrupsionit - Qendra me Një Ndalesë (key objektiv është kostuar i plotë te SNRAP, si dy strategji ndërsektoriale)*													
C	OBJEKTIV SPECIFIK C *Plotësimi dhe përmirësimi i kuadrit ligjor për e-qeverisjen dhe shoqërinë e informacionit*													
	Objektivi 4. *Zhvillimi i Qeverisjes Elektronike Qendrore dhe Vendore (e-Qeverisja)*													
	Zgjerimi i Sistemit Informatik Financiar i Qeverise /SIFQ den në 150 Institucione buxhetore nëpërmjet webportalit dhe menaxhimi i dokumenteve, menaxhimi i fondeve të huaja nëpërmjet tsa dhe kostoja e projekteve.		MF			2018	2022					Donator		
	AFMIS and IPSIS solutions, Albanian Financial Managment Information System (MTPB amd PIM), Integrated Planning System Information System (Portal + DWH)		MF/ME/KM			2018	2022	2,526,160	Euro			Donator		
	Blerje pajisje për *disaster recovery center* të Sistemit të Thesarit		MF			2017	2022	12,396,000	ALL			Buxheti i shtetit		
	Integrimi në EUIS Fiscalis 2020 (*Entry ticket*)		DPT			2015	2020	31,500,000	ALL			Buxheti i shtetit		
	(Realizimi i projektit e-fatura) Përmirësimi i modulit të menaxhimit të kontrollit të faturimit		DPT			2018	2020	1,439,826,666	ALL			Buxheti i shtetit		
II. QËLLIMI I POLITIKES (Shkruaj Qëllimin e politikës të përcaktuar në strategjinë, ku lidhet edhe Plani Veprimit) (Ky Qëllim Politike vendoset te Programi Buxhetor. Konsideroni që një Qëllim Politike mund të zbatohet përmes më shumë se një programi buxheti)														
III. PROGRAMI BUXHETOR 2 i PBA Që FINANCON QËLLIMIN E POLITIKËS (Rasti kur i një̈jti Qëllim i Politikës vlen Dy Programe. Përsëritet tabela, por duke specifikuar, për të .një̈jtin Qëllim Politike, Objektivat Specifike që përcaktohen në Programin 2) (Shkruaj emrin e programit të PBA-së që kontribuon në arritjen e qëllimit të politikës) (Konsideroni që një qëllim politike mund të zbatohet përmes më shumë se një programi buxheti) .														
				Subtotal C.2	**1,724,800**	**622,400**	**622,400**	**480,000**	**-**	**-**	**1,724,800**	**-**	**-**	**-**
		C.3. Ngritja e një sistemi kursesh pranë Shkollës se Magjistraturës dhe Akademisë së Sigurisë në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë më krimet ndaj fëmijëve *online* dhe mënyrat e mbrojtjes së tyre në Internet.	AKCESK	C.3.1 Hartimi i kurrikulave të trajnimit	124,800	62,400	62,400	-			124,800			-
			AKCESK	C.3.2 Organizimi i programeve të trajnimit	1,600,000	560,000	560,000	480,000			1,600,000			-
				Subtotal C.3	**1,724,800**	**622,400**	**622,400**	**480,000**	**-**	**-**	**1,724,800**	**-**	**-**	**-**
		C.4 Krijimi i mekanizmave për standardizimin e punës së analizimit të provave digjitale nga Policia e Shtetit	PSH	C.4.1 Analiza e situatës aktuale mbi mekanizmat për analizimin e provave digjitale	124,800	62,400	62,400	-			124,800			-
			PSH	C.4.2 Hartimi i rekomandimeve	62,400	62,400	-	-			62,400			-
			PSH	C.4.3 Monitorimi i zbatueshmërisë së mekanizmave të krijuar	46,800	46,800	-	-			46,800			-
				Subtotal C.4	**234,000**	**171,600**	**62,400**	**-**	**-**	**-**	**234,000**	**-**	**-**	**-**
		C.5 Krijimi i një grupi pune së bashku me industrinë për të zgjidhur problemet e hetimit dhe identifikimit të personave të dyshuar për abuzim me fëmijët *online*, me fokus të veçantë identifikimin e përdoruesve fundorë nëpërmjet adresave IP	PSH	C.5.1 Hartimi i urdhrit për ngritjen e grupit të punës	-	-	-	-			-			-
			PSH	C.5.2 Hartimi i metodologjisë së bashkëpunimit të grupit të punës	-	-	-	-			-			-
				Subtotal C.5	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**
	Subtotal C.				3,683,600	1,416,400	1,307,200	960,000	-	-	3,683,600	-	-	-
Objektivi Specifik D - Rritja e ndërgjegjësimit dhe edukimi te të gjitha segmentet e shoqërisë për përdorimin e sigurt të Internetit nga fëmijët		D.1 Fushata ndërgjegjësimi me prindërit dhe edukatorët në lidhje me rreziqet dhe problemet me të cilat përballen fëmijët në Internet	AKCESK	D.1.1 Hartimi i kurrikulave të trajnimit	124,800	62,400	62,400	-			124,800			-
			AKCESK	D.1.2 Organizimi i fushatave të ndërgjegjësimit	1,600,000	560,000	560,000	480,000			1,600,000			-
				Subtotal D.1	**1,724,800**	**622,400**	**622,400**	**480,000**	**-**	**-**	**1,724,800**	**-**	**-**	**-**
		D.2 Zhvillimi i programeve të trajnimit me mësuesit e TIK në lidhje me çështjet e Internetit të sigurt	AKCESK	D.2.1 Hartimi i kurrikulave të trajnimit	124,800	62,400	62,400	-			124,800			-
			AKCESK	D.2.2 Organizimi i programeve të trajnimit	1,600,000	560,000	560,000	480,000			1,600,000			-
				Subtotal D.2	**1,724,800**	**622,400**	**622,400**	**480,000**	**-**	**-**	**1,724,800**	**-**	**-**	**-**
		D.3 Zhvillimi i programeve të trajnimit për Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës lidhur me trajtimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje ku rreziku i dhunës, abuzimit, shfrytëzimit apo neglizhimit lidhet me internetin dhe teknologjitë e informacionit	AKCESK	D.3.1 Hartimi i kurrikulave të programeve të trajnimit	124,800	62,400	62,400	-			124,800			-
			AKCESK	D.3.2 Organizimi i fushatave të trajnimit	1,600,000	560,000	560,000	480,000			1,600,000			-
				Subtotal D.3	**1,724,800**	**622,400**	**622,400**	**480,000**	**-**	**-**	**1,724,800**	**-**	**-**	**-**
	Subtotal D				5,174,400	1,867,200	1,867,200	1,440,000	-	-	5,174,400	-	-	-
Objektivi Specifik E - Forcimi i bashkëpunimit ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijëve në Internet		E.1 Promovimi nëpërmjet bashkëpunimit me të gjitha ISP-të i mekanizmave ekzistues të aplikuar në platformat e tyre për sigurinë e fëmijëve në Internet.	AKCESK	E.1.1 Organizimi i aktivitetit për promovimin e mekanizmave të mbrojtjes së fëmijëve në internet	200,000	200,000	-	-			200,000			-
			AKCESK	E.1.2 Hartimi i fletëpalosjeve/materiale informuese me mekanizmat ekzistues për mbrojtjen e fëmijëve në Internet	31,200	31,200	-	-			31,200			-
				Subtotal E.1	**231,200**	**231,200**	**-**	**-**	**-**	**-**	**231,200**	**-**	**-**	**-**
		E.2 Integrimi nga të gjitha ISP-të në platformat e tyre të listës IWF *(Internet Watch Foundation Hash List)* që ndalon çdo individ të hedhë, shkarkojë apo shikojë imazhe apo video të abuzimit seksual të fëmijëve	Propozim i shoqërisë civile (UNICEF)	E.2.1 Hartimi i udhëzimit për integrimin e listës IWF në platformat e ISP-ve	-	-	-	-			-			-
			Propozim i shoqërisë civile (UNICEF)	E.2.2 Monitorimi i zbatueshmërisë së udhëzimit të hartuar	-	-	-	-			-			-
				Subtotal E.2	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**
		E.3 Ngritja e një Komiteti Teknik Këshillues për Sigurinë e Fëmijëve në Internet, pranë Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve	MSH	E.3.1 Takime të komiteteve teknike këshilluese, për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes të fëmijëve.	-	-	-	-			-			-
			MSH	E.3.2 Përcaktim i rregulloreve mbi të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve	-	-	-	-			-			-
				Subtotal E.3	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**
	Subtotal E				231,200	231,200	-	-	-	-	231,200	-	-	-
Total 3					**9,770,400**	**3,858,000**	**3,486,400**	**2,426,000**	**-**	**-**	**9,770,400**	**-**	**-**	**-**

	Specific objective	Sub-Objective	Institucioni përgjegjës	Results	Kosto totale						Kostot në Lek			
						Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	PBA	Donatore	Te tjere	Hendeku
Pozicioni 4 Qëllimi i	**Objektivi Specifik A** - Forcimi i bashkëpunimit	A.1 Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet institucioneve shtetërore për	AKCESK	A.1.1 Hartimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve ndërinstitucionale	140,400	46,800	46,800	46,800			140,400			-
			AKCESK	A.1.2 Krijimi i rrjetit të pikave të kontaktit dhe hartimi i metodologjisë së punës së rrjetit	140,400	46,800	46,800	46,800			140,400			-
			AKCESK	A.1.3 Krijimi i një platforme komunikimi të përbashkët për bashkëpunimin dhe forcimin e	140,400	46,800	46,800	46,800			140,400			-

	institucional në nivel kombëtar	të garantuar sigurinë në nivel kombëtar në hapësrën kibernetike		besimit me ekipet e tjera publike dhe private të CERT dhe CSIRT, dhe komunitetet akademike.										
				Subtotal A.1	421,200	140,400	140,400	140,400	-	-	421,200	-	-	-
		A.2 Krijimi i një instrumenti për shkëmbimin e informacionit përmes pikave të kontaktit të dedikuara nga institucionet përkatëse, në raste të kërcënimeve kibernetike.	AKCESK	A.2.1. Ndërtimi i besimit midis të gjithë aktorëve relevantë, duke përfshirë zhvillimin e një platforme/sistemi kombëtar për shkëmbimin e informacionit në lidhje me ligjet, incidentet dhe kërcënimet e menjëhershme.	140,400	46,800	46,800	46,800			140,400			-
			AKCESK	A.2.2 Zhvillimi dhe zbatimi i një sistemi dhe programeve për shkëmbimin e informacionit, njohurive dhe përvojës midis sektorit publik dhe atij të mbrojtjes dhe sigurisë në fushën e mbrojtjes kibernetike.	140,400	46,800	46,800	46,800			140,400			-
			AKCESK	A.2.3 Përparimi i mekanizmave ekzistuese dhe atyre të reja për bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni me sektorët privatë dhe civilë.	140,400	46,800	46,800	46,800			140,400			-
			AKCESK	A.2.4 Bashkëpunimi i të gjithë aktorëve relevantë në procesin e zhvillimit dhe bashkimit të normave të sigurisë, standardizimin e bashkëpunimit, si dhe përcaktimin dhe vendosjen e nivelit të detyrueshëm të mbrojtjes së subjekteve që menaxhojnë incidentet kibernetike.	140,400	46,800	46,800	46,800			140,400			-
			AKCESK	A.2.5 Hartimin e një formati unifikues me mesazhe ndërgjegjësimi për sigurinë *online* nga ISP, të cilat do të shfaqen në pikat e shitjes	62,400	62,400	-	-			62,400			-
				Subtotal A.2	**624,000**	**249,600**	**187,200**	**187,200**	**-**	**-**	**624,000**	**-**	**-**	**-**
		A.3 Ngritja e një strukture fleksibël me ekspertët më të mirë të sigurisë kibernetike në vend, me qëllim mbështetje në raste krizash kibernetike, testimi dhe vlerësimi të nivelit të sigurisë kibernetike në nivel kombëtar	AKCESK	A.3.1 Krijimi i instrumentit për ngritjen e strukturës	124,800	62,400	62,400	-			124,800			-
			AKCESK	A.3.2 Hartimi i metodologjisë së bashkëpunimit	124,800	62,400	62,400	-			124,800			-
				Subtotal A.3	**249,600**	**124,800**	**124,800**	**-**	**-**	**-**	**249,600**	**-**	**-**	**-**
	Subtotal A				**1,294,800**	**514,800**	**452,400**	**327,600**	**-**	**-**	**1,294,800**	**-**	**-**	**-**
Objektivi Specifik B - Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes kibernetike dhe luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit.		B.1. Zhvillimi i mekanizmave dhe i procedurave efikase, për bashkëpunim ndërkombëtar, në rast të incidenteve kibernetike, sulmeve dhe krizave, sipas parimeve të vendosura ndërkombëtarisht.	AKCESK	B.1.1 Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare si ENISA, FIRST etj., për të qenë në korrent me zhvillimet më të fundit të fushës së sigurisë kibernetike.	140,400	46,800	46,800	46,800			140,400			-
			AKCESK	B.1.2 Hartimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve bilaterale dhe/ose multilaterale ndëinstitucionale për marrjen dhe shpërndarjen e informacionit	140,400	46,800	46,800	46,800			140,400			-
				Subtotal B.1	**280,800**	**93,600**	**93,600**	**93,600**	**-**	**-**	**280,800**	**-**	**-**	**-**
		B.2. Forcimi i bashkëpunimit dhe shkëmbimi i informacionit me NATO/OSBE dhe organizata/forume të tjerë ndërkombëtarë	AKCESK	B.2.1 Pjesëmarrje aktive në takimet e NATO-s për zbatimin e standardeve e rregulloreve ndërkombëtare në kuadër të sigurisë kibernetike	2,700,000	900,000	900,000	900,000			2,700,000			-
			AKCESK	B.2.2 Pjesëmarrja aktive dhe kontribut në ndërtimin e aftësive në nivel global për sigurinë kibernetike dhe aktivitetet e ndërtimit të besimit.	2,700,000	900,000	900,000	900,000			2,700,000			-
			AKCESK	B.2.3 Anëtarësimi dhe pjesëmarrja në aktivitete dhe iniciativa të ndryshme ndërkombëtare në fushën e sigurisë kibernetike *(First, Trust Introducer)*	-	-	-	-			-			-
				Subtotal B.2	**5,400,000**	**1,800,000**	**1,800,000**	**1,800,000**	**-**	**-**	**5,400,000**	**-**	**-**	**-**
	Subtotal B				**5,680,800**	**1,893,600**	**1,893,600**	**1,893,600**	**-**	**-**	**5,680,800**	**-**	**-**	**-**
Total 4					**6,975,600**	**2,408,400**	**2,346,000**	**2,221,200**	**-**	**-**	**6,975,600**	**-**	**-**	**-**
KOSTOJA TOTALE E STRATEGJISË					**522,795,524**	**325,604,908**	**137,127,583**	**56,616,708**	-	-	236,698,724	-	-	374,400

VENDIM
Nr. 1086, datë 24.12.2020

PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT PËR NDRYSHIM DHE SHTESË NË MARRËVESHJEN E BASHKËPUNIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLË NË FUSHËN E SIGURISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e protokollit për ndryshim dhe shtesë në marrëveshjen e bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për bashkëpunim të ndërsjellë në fushën e sigurisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

PROTOKOLL
PËR NDRYSHIM DHE SHTESË NË MARRËVESHJEN E BASHKËPUNIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR BASHKËPUNIMIN TË NDËRSJELLË NË FUSHËN E SIGURISË

Bazuar në nenin 17, pika 3, të "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunim të ndërsjellë në fushën e sigurisë", nënshkruar më 23.3.2015,

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Kosovës, bien dakord për sa vijon:

Në "Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunim të ndërsjellë në fushën e sigurisë", nënshkruar më 23.3.2015, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pas pikës 3, të nenit 1, shtohet pika "a", me këtë përmbajtje:

"a) Palët angazhohen të bashkëpunojnë mes tyre edhe përmes përdorimit të përbashkët të Oficerëve të Kontaktit ose Ndërlidhës, në vendet ku njëra nga palët nuk përfaqësohet me Oficer Kontakti ose Ndërlidhës, me kusht që të jetë marrë pëlqimi i vendit pritës. Ky bashkëpunim nuk përfshin Oficerët e Kontaktit ose Ndërlidhës, pranë organizatave apo organizmave ndërkombëtarë, ku palët janë anëtare".

Neni 2

Në nenin 4, "Autoritetet Kompetente", për palën shqiptare, emërtimi "Ministria e Punëve të Brendshme", zëvendësohet me emërtimin: "Ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë".

Neni 3

Ky protokoll do të hyjë në fuqi ditën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, ku pala njoftojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për përmbushjen e procedurave të tyre të brendshme ligjore të kërkuara për hyrjen në fuqi.

Nënshkruar në Tiranë, më 2.10.2020, në dy origjinale, në gjuhën shqipe, të gjitha tekstet janë njëlloj autentike.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË	PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
Sandër Lleshaj	**Agim Veliu**
MINISTËR	MINISTËR

VENDIM
Nr. 1088, datë 24.12.2020

PËR PËRCAKTIMIN E MËNYRËS DHE TË PROCEDURAVE TË REGJISTRIMIT E PUBLIKIMIT TË TË DHËNAVE PËR PRONARËT PËRFITUES, SI DHE TË NJOFTIMIT NGA AUTORITETET SHTETËRORE KOMPETENTE E NGA SUBJEKTET E DETYRUARA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 7, 6, pikat 8, 9 e 10, e 15, pika 4, të ligjit nr. 112/2020, "Për regjistrin e pronarëve përfitues", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Të gjithë termat e përcaktuar në nenin 3, të ligjit nr. 112/2020, "Për regjistrin e pronarëve përfitues", kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë vendim, ndërsa me termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

a) "Dokument shoqërues", aktet në bazë të të cilave identifikohen e regjistrohen pronarët përfitues të subjektit raportues dhe lloji i kontrollit të pronësisë;

b) "Lloji i regjistrimit", regjistrimi fillestar, ndryshimi ose përditësimi i të dhënave për pronarët përfitues.

2. Aplikimi për regjistrimin fillestar dhe/ose për përditësimin ose ndryshimin e të dhënave për pronarët përfitues bëhet nga personi i autorizuar për të përfaqësuar subjektin raportues nëpërmjet sportelit elektronik, pasi të jetë identifikuar elektronikisht dhe duke përdorur një certifikatë të kualifikuar për nënshkrimin elektronik, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nënshkrimin elektronik.

3. Personi i autorizuar deklaron, nëpërmjet plotësimit të aplikimit, të gjitha të dhënat, sipas fushave të formularëve të miratuar, në përputhje me ligjin për regjistrin e pronarëve përfitues për kryerjen e regjistrimit të kërkuar dhe paraqet dokumentacionin shoqërues përkatës.

4. Të gjitha dokumentet e lidhura me aplikimet e kryera pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) ruhen dhe arkivohen nga QKB-ja vetëm në formatin elektronik.

5. Ministri përgjegjës në fushën e ekonomisë, me propozimin e titullarit të QKB-së, miraton formularët e aplikimit, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për regjistrimin e pronarëve përfitues dhe të legjislacionit në fuqi.

II. PROCEDURAT E APLIKIMIT PËR REGJISTRIMIN E TË DHËNAVE NË REGJISTRIN E PRONARËVE PËRFITUES

1. Personi i autorizuar për të përfaqësuar subjektin raportues që kërkon të kryejë një aplikim për regjistrimin fillestar dhe/ose për përditësimin ose ndryshimin e të dhënave për pronarët përfitues, nëpërmjet sportelit elektronik të QKB-së, duhet të identifikohet elektronikisht nëpërmjet autentifikimit nga portali unik i shërbimeve qeveritare *e-Albania*.

2. Pasi është autentifikuar, sipas pikës 1, të këtij kreu, personi i autorizuar për të përfaqësuar subjektin raportues akseson sportelin elektronik dhe zgjedh llojin e regjistrimit që kërkohet të kryhet. Pas përzgjedhjes së llojit të regjistrimit, sistemi i informatizuar shfaq formularin përkatës të aplikimit, sipas formatit të miratuar, dhe hap dosjen elektronike, e cila mban numrin përkatës (një numër për çdo dosje ose aplikim) të dhënë nga sistemi i informatizuar (numri i çështjes).

3. Pas shfaqjes së formularit dhe hapjes së dosjes elektronike, personi i autorizuar për të përfaqësuar subjektin raportues plotëson elektronikisht formularin, në të gjitha rubrikat e tij, sipas llojit të regjistrimit që kërkohet të kryhet.

4. Personi i autorizuar, për të përfaqësuar subjektin raportues, ngarkon në dosjen e hapur sipas pikës 2, të këtij kreu, dokumentet shoqëruese, që provojnë të dhënat që regjistrohen, të krijuara apo të konvertuara prej tij në format elektronik. Për çdo dokument të ngarkuar në dosjen elektronike, sistemi i informatizuar vendos një kod identifikimi elektronik të sigurt që lidh dokumentin me të dhënat e autentifikimit të personit.

5. Pasi personi i autorizuar për të përfaqësuar subjektin raportues verifikon se të dhënat e plotësuara në formular dhe dokumentet shoqëruese, të ngarkuara në dosjen elektronike sipas pikës 4, të këtij kreu, janë të sakta, i konfirmon ato me mjete elektronike që garantojnë autenticitetin e origjinës dhe pacenueshmërinë e përmbajtjes së dokumenteve në format elektronik, të paktën, nëpërmjet nënshkrimit elektronik të

avancuar të formularit të aplikimit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nënshkrimin elektronik.

6. Pas konfirmimit elektronik të aplikimit, sipas pikës 5, të këtij kreu, sistemi i informatizuar jep konfirmimin automatik të kryerjes së aplikimit nga sporteli elektronik, i cili përmban numrin e dhënë automatikisht nga sistemi i informatizuar (numrin e çështjes), i cili i mundëson aplikantit të ndjekë në çdo kohë gjendjen e procesit të regjistrimit.

7. Sistemi i informatizuar njofton, gjithashtu, personin e autorizuar për të përfaqësuar subjektin raportues, në postën elektronike të deklaruar pranë portalit unik të shërbimeve qeveritare *e-Albania*, duke i dërguar kopje elektronike të formularit të aplikimit të plotësuar dhe të konfirmimit të kryerjes së aplikimit nga sporteli elektronik.

8. Me lëshimin e konfirmimit të kryerjes së aplikimit, sistemi i informatizuar kalon aplikimin dhe dokumentet shoqëruese në format elektronik te nëpunësit e autorizuar (regjistruesit) të QKB-së, për shqyrtim e vendimmarrje.

9. Procedura për regjistrimin nga subjektet raportuese ekzistuese të të dhënave për pronarët e tyre përfitues realizohet sipas parashikimeve të këtij kreu. Subjektet raportuese ekzistuese regjistrojnë të dhënat për pronarët e tyre përfitues jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike nga krijimi i Regjistrit të Pronarëve Përfitues.

III. DOKUMENTACIONI DHE FORMA E KËRKUAR

1. Subjektet raportuese kanë detyrimin të ruajnë e të mbajnë të dhëna dhe dokumente shoqëruese të duhura, të sakta e të përditësuara, në bazë të të cilave përcaktohen pronarët përfitues të subjektit dhe lloji i kontrollit të pronarëve të tyre përfitues. Personi i autorizuar për të përfaqësuar subjektin raportues në aplikimin elektronik për regjistrimin e pronarit përfitues bashkëlidh si dokumentacion shoqërues, në format elektronik, aktet, si më poshtë vijon:

a) Në rastin e regjistrimit fillestar të pronarëve përfitues:

i. dokumentacionin që vërteton numrin unik të identifikimit dhe emrin e subjektit raportues, si dhe datën e regjistrimit të subjektit në regjistrin përkatës;

ii. dokumentacionin që vërteton të dhënat e identifikimit të pronarit përfitues, sipas pikës 3.2.1, të nenit 4, të ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues;

iii. dokumentacionin e autoritetit kompetent regjistrues, që vërteton se pronari përfitues i regjistruar është zotërues i 25 (njëzet e pesë) % ose më tepër të aksioneve/kuotave të kapitalit, të të drejtave të votimit ose të interesave të pronësisë, nëse nuk përmban datën e përcaktimit si pronar përfitues, duhet të depozitohet një dokument tjetër që përmban këtë të dhënë; ose

iv. dokumentacionin tjetër që zotëron subjekti raportues, që përmban informacionin e nevojshëm për identifikimin dhe regjistrimin e pronarit përfitues të tij, sipas ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues.

b) Në rastin e regjistrimit të ndryshimeve të të dhënave të pronarëve përfitues të subjekteve raportuese:

i. dokumentacionin që vërteton numrin unik të identifikimit dhe emrin e subjektit raportues, si dhe datën e regjistrimit të subjektit në regjistrin përkatës;

ii. dokumentacionin që vërteton të dhënat e identifikimit të pronarit përfitues, sipas pikës 3.2.1, të nenit 4, të ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues;

iii. dokumentacionin e autoritetit kompetent regjistrues, që vërteton se pronari përfitues i regjistruar është zotërues i 25 (njëzet e pesë) % ose më tepër të aksioneve/kuotave të kapitalit, të të drejtave të votimit ose të interesave të pronësisë, nëse nuk përmban datën e përcaktimit si pronar përfitues, duhet të depozitohet një dokument tjetër që përmban këtë të dhënë; ose

iv. dokumentacion tjetër që zotëron subjekti raportues, që përmban informacionin e nevojshëm për identifikimin dhe regjistrimin e pronarit përfitues të tij, sipas ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues.

c) Dokumentacioni i përcaktuar në nënndarjet "i", "iii" e "iv", të shkronjës "a", të kësaj pike, duhet të jetë hartuar jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data e regjistrimit fillestar të subjekteve raportuese;

ç) Dokumentacioni i përcaktuar në nënndarjet "i", "iii" e "iv", të shkronjës "b", të kësaj pike, duhet të jetë hartuar jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data e ndodhjes së ndryshimit faktik i të dhënave të pronarëve përfitues;

d) Në rast se pas shterimit të të gjitha mjeteve të mundshme për identifikimin e pronarit përfitues dhe nëse nuk ka arsye për dyshime, subjektet raportuese nuk arrijnë të identifikojnë si pronar përfitues individin, i cili ka në pronësi ose kontrollon i fundit një person juridik, përmes pronësisë direkte ose indirekte të 25 (njëzet e pesë) % ose më tepër të aksioneve/kuotave të kapitalit ose të interesave të pronësisë në një subjekt raportues, sipas përcaktimeve të ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues, atëherë subjektet raportuese duhet të identifikojnë e të regjistrojnë në Regjistrin e Pronarëve Përfitues, si pronar përfitues, individin që:

i. përcakton vendimet e marra nga një person juridik;

ii. kontrollon në çdo lloj mënyre zgjedhjen, emërimin dhe largimin e shumicës së organeve vendimmarrëse dhe/ose organeve ekzekutive të personit juridik.

Në këtë rast, subjektet raportuese duhet të mbajnë dokumentacionin që arsyeton dhe vërteton veprimet e ndërmarra për të identifikuar pronarin përfitues, sipas përcaktimeve të ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues.

dh) Në rastin e përcaktuar në shkronjën "d", të pikës 1, të këtij kreu, përveç dokumenteve të përcaktuara në shkronjën "a" ose në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij kreu, sipas rastit, subjektet raportuese duhet të dorëzojnë edhe një deklaratë me shkrim të nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit raportues, në të cilën të përcaktohen saktësisht hapat e ndërmarrë për identifikimin si pronar përfitues të individit, i cili ka në pronësi ose kontrollon i fundit një person juridik, përmes pronësisë direkte ose indirekte të 25 (njëzet e pesë) % ose më tepër të aksioneve/kuotave të kapitalit ose të interesave të pronësisë në një subjekt raportues, si dhe arsyet për identifikimin dhe regjistrimin në Regjistrin e Pronarëve Përfitues, si pronar përfitues individin, sipas nënndarjeve "i" e "ii", të shkronjës "d", të pikës 1, të këtij kreu.

Deklarata me shkrim e nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit raportues, e përcaktuar në shkronjën "dh", të pikës 1, të këtij kreu, duhet të jetë hartuar jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data e regjistrimit fillestar të subjekteve raportuese ose jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data e ndodhjes së ndryshimit faktik të të dhënave të pronarëve përfitues.

e) Në rast se pas shterimit të të gjitha mjeteve të mundshme për identifikimin e pronarit përfitues dhe nëse nuk ka arsye për dyshime, subjektet raportuese:

i. nuk arrijnë të identifikojnë si pronar përfitues individin, i cili ka në pronësi ose kontrollon i fundit një person juridik, përmes pronësisë direkte ose indirekte të 25% ose më tepër të aksioneve/ kuotave të kapitalit ose të interesave të pronësisë në një subjekt raportues, sipas përcaktimeve të ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues; dhe

ii. nuk arrijnë të identifikojnë si pronar përfitues individin, sipas nënndarjeve "i" dhe "ii", të shkronjës "d", të pikës 1, të këtij kreu,

atëherë subjektet raportuese duhet të identifikojnë dhe të regjistrojnë në Regjistrin e Pronarëve Përfitues, si pronar përfitues, individin/ët që mban pozicionin e drejtuesit/drejtuesve më të lartë të subjektit raportues. Në këtë rast, subjekti duhet të mbajë dokumentacionin që arsyeton dhe vërteton veprimet e ndërmarra për të identifikuar pronarin përfitues, sipas përcaktimeve të ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues.

ë) Në rastin e përcaktuar në shkronjën "e", të pikës 1, të këtij kreu, përveç dokumenteve të përcaktuara në shkronjën "a" ose në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij kreu, sipas rastit, subjektet raportuese duhet të dorëzojnë edhe një deklaratë me shkrim të nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit raportues, në të cilën të përcaktohen saktësisht hapat e ndërmarrë për identifikimin si pronar përfitues të individit, i cili ka në pronësi ose kontrollon i fundit një person juridik, përmes pronësisë direkte ose indirekte të 25 (njëzet e pesë) % ose më tepër të aksioneve/kuotave të kapitalit ose të interesave të pronësisë në një subjekt raportues, si dhe arsyet për identifikimin e regjistrimin në Regjistrin e Pronarëve Përfitues, si pronar përfitues, të individit/individëve të përcaktuar sipas shkronjës "e", të pikës 1, të këtij kreu.

Deklarata me shkrim e nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit raportues, e përcaktuar në këtë shkronjë, duhet të jetë hartuar jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data e regjistrimit fillestar të subjekteve raportuese dhe jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga

data e ndodhjes së ndryshimit faktik të të dhënave të pronarëve përfitues.

2. Personi i autorizuar për të përfaqësuar subjektin raportues, nëpërmjet aplikimit, konfirmon njësinë e dokumentit në format elektronik me origjinalin.

3. Dokumentet shoqëruese nuk duhet të përmbajnë korrigjime ose fshirje të pavërtetuara, sipas dispozitave përkatëse ligjore dhe përmbajtja e tyre duhet të duket qartë, të jetë e lexueshme e të lejojë marrjen e imazhit elektronik të dokumentit.

4. Dokumentet shoqëruese duhet të jenë në gjuhën shqipe. Së bashku me dokumentin shoqërues në shqip, aplikanti mund të depozitojë edhe përkthimin e vërtetuar në gjuhë të huaj. Aktet private dhe dokumentet zyrtare të juridiksioneve të huaja duhet të shoqërohen me përkthimin e vërtetuar në gjuhën shqipe dhe të legalizohen sipas ligjeve në fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

5. Në rast mospërputhjeje të dokumentit shoqërues në gjuhën shqipe me atë në gjuhë të huaj, ky i fundit nuk mund t'u kundrejtohet palëve të treta. Gjithsesi, palët e treta mund t'i kundrejtojnë subjektit të dhënat e përmbajtura në dokumentin në gjuhë të huaj, përveç rastit kur subjekti provon se i treti kishte dijeni për përmbajtjen e dokumentit në gjuhën shqipe.

IV. PROCEDURA E VLERËSIMIT TË APLIKIMIT DHE ARSYET E REFUZIMIT PËR REGJISTRIMIN E TË DHËNAVE TË PRONARËVE PËRFITUES TË SUBJEKTEVE RAPORTUESE

1. Aplikimi dhe dokumentet shoqëruese në format elektronik, dërguar sipas parashikimeve të krerëve II e III, të këtij vendimi, merren në shqyrtim nga nëpunësit e autorizuar të QKB-së për vendimmarrje, sipas radhës së paraqitjes së tyre.

2. Nëpunësi i autorizuar (regjistruesi) i QKB-së verifikon:

a) identitetin e nënshkruesit dhe faktin nëse është person i autorizuar për të bërë regjistrimin;

b) plotësimin e të gjitha të dhënave për pronarët përfitues të kërkuara nga ligji për regjistrin e pronarëve përfitues, si dhe dokumentet shoqëruese;

c) paraqitjen në formën e kërkuar të dokumentacionit shoqërues, që vërteton të dhënat që regjistrohen;

ç) faktin nëse dokumentacioni i paraqitur nuk përmban korrigjime ose fshirje të pavërtetuara, sipas dispozitave përkatëse, si dhe kur përmbajtja e tij nuk duket qartë, është e palexueshme apo pengon marrjen e imazhit elektronik;

d) nëse regjistrimi i të dhënave për pronarët përfitues është paraqitur brenda afateve ligjore të përcaktuara në ligjin për regjistrin e pronarëve përfitues;

dh) faktin nëse janë shlyer sanksionet administrative, të dhëna sipas pikave 2 dhe 3, të nenit 13, të ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues.

3. Gjatë shqyrtimit të aplikimit, nëpunësi i autorizuar (regjistruesi) i QKB-së vlerëson vetëm plotësimin e kërkesave të përcaktuara në pikën 2, të këtij kreu. Në këtë vlerësim, nëpunësi i autorizuar (regjistruesi) nuk mund të shqyrtojë saktësinë e të dhënave, vërtetësinë e dokumenteve, që i bashkëlidhen aplikimit për regjistrim apo përputhshmërinë e përmbajtjes së tyre me kërkesat e ligjit në fuqi. Përgjegjësia për saktësinë dhe vërtetësinë e fakteve, të të dhënave të njoftuara dhe të dokumenteve shoqëruese, të depozituara në regjistrin elektronik, mbahet nga subjektet raportuese dhe personat e autorizuar për të bërë regjistrimin, sipas ligjeve në fuqi.

4. Nëpunësi i autorizuar (regjistruesi) i QKB-së nuk mund ta refuzojë regjistrimin, nëse aplikimi është dorëzuar sipas parashikimeve të ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues dhe në përputhje me kërkesat e pikës 2, të këtij kreu.

5. Nëse nëpunësi i autorizuar (regjistruesi) i QKB-së, pas verifikimeve sipas pikave të mësipërme, vëren se aplikimi është në përputhje me kërkesat e ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues dhe këtij vendimi, miraton aplikimin e kryerjen e regjistrimit, jo më vonë se 2 (dy) ditë pune nga marrja e aplikimit nga subjektet raportuese.

6. Nëpunësi i autorizuar (regjistruesi) i QKB-së refuzon regjistrimin e të dhënave të pronarëve përfitues, nëse:

a) aplikimi nuk është në përputhje me kushtet e përcaktuara në ligj dhe të pikës 2, të këtij kreu;

b) të dhënat, që kërkohen të regjistrohen janë të ndryshme nga të dhënat e regjistrueshme, sipas dispozitave të këtij ligji.

7. Refuzimi bëhet jo më vonë se 2 (dy) ditë pune nga marrja e aplikimit nga subjektet raportuese, shoqëruar me arsyen e refuzimit.

8. Me refuzimin e aplikimit për regjistrimin e pronarit përfitues, subjektet raportuese kanë të drejtë të riaplikojnë për regjistrimin e pronarit përfitues, brenda afatit të parashikuar në ligj.

9. Riparaqitja e aplikimit pas refuzimit trajtohet si aplikim i ri.

V. MËNYRA DHE AFATET E NJOFTIMIT NGA AUTORITETET SHTETËRORE KOMPETENTE, SI DHE MËNYRA E PËRDITËSIMIT APO E NDRYSHIMIT TË TË DHËNAVE NGA QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

1. Autoritetet kompetente shtetërore do të kenë akses elektronik të lirë, direkt dhe të pakufizuar në të dhënat e regjistruara në regjistër, në funksion të përmbushjes së detyrave të tyre ligjore që lidhen me inspektimin e Regjistrit të Pronarëve Përfitues dhe mbledhjen e të dhënave për pronarët përfitues.

2. Nëse gjatë përmbushjes së detyrave të tyre ligjore që lidhen me inspektimin e Regjistrit të Pronarëve Përfitues dhe mbledhjen e të dhënave për pronarët përfitues, autoritetet kompetente shtetërore (Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave; Banka e Shqipërisë; Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve; Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare; Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit) konstatojnë se të dhënat e regjistruara në Regjistrin e Pronarëve Përfitues nuk përputhen me të dhënat në posedim të autoriteteve kompetente shtetërore, atëherë, ato, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e konstatimit, njoftojnë QKB-në në mënyrë elektronike nëpërmjet Regjistrit të Pronarëve Përfitues, duke dërguar edhe dokumentet shoqëruese, që provojnë të dhënat që duhet të përditësohen në regjistër.

3. QKB-ja, jo më vonë se 2 (dy) ditë pune nga marrja e njoftimit nga autoritetet kompetente shtetërore, kryen përditësimin ose ndryshimin në regjistër të të dhënave të pronarëve përfitues të përcaktuara në njoftimin elektronik të tyre dhe të provuara me dokumentet shoqëruese përkatëse.

VI. MËNYRA DHE AFATET E NJOFTIMIT NGA SUBJEKTET E DETYRUARA, NË RASTET KUR TË DHËNAT E REGJISTRUARA NË REGJISTËR NUK PËRPUTHEN ME TË DHËNAT QË ZOTËROJNË, SI DHE MËNYRA E PËRDITËSIMIT APO E KONFIRMIMIT TË TË DHËNAVE TË PRONARËVE PËRFI-TUES NGA SUBJEKTET RAPORTUESE

1. Nëse një subjekt i detyruar, që i nënshtrohet ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, konstaton se të dhënat e regjistruara në Regjistrin e Pronarëve Përfitues nuk përputhen me të dhënat që ai zotëron në përmbushje të detyrave të tij ligjore, lidhur me pronarin përfitues të një subjekti raportues, duhet, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e konstatimit, të njoftojë me shkrim subjektin raportues dhe QKB-në.

2. Me marrjen e njoftimit me shkrim nga subjekti i detyruar, QKB-ja, brenda 2 (dy) ditëve punë, publikon njoftimin në regjistër dhe njofton në mënyrë shkresore subjektin raportues për konstatimin e subjektit të detyruar.

3. Subjekti raportues, brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga data e njoftimit të QKB-së, duhet:

a) të përditësojë në regjistër të dhënat për pronarët e tyre përfitues, sipas këtij ligji, nëse konstatimi i subjektit të detyruar është i saktë; ose

b) të konfirmojë në regjistër të dhënat për pronarët e tyre përfitues, të regjistruara më parë, nëse konstatimi i subjektit të detyruar nuk është i saktë.

4. Përditësimi në regjistër i të dhënave për pronarët e tyre përfitues do të bëhet sipas së njëjtës procedurë, të përcaktuar në kreun II, të këtij vendimi.

5. Në rastin e konfirmimit në regjistër të të dhënave për pronarët e tyre përfitues, ndiqen këta hapa:

a) Pasi është autentifikuar sipas pikës 4, të këtij kreu, personi i autorizuar për të përfaqësuar subjektin raportues akseson sportelin elektronik në *e-Albania* dhe zgjedh llojin e regjistrimit që kërkohet të kryhet. Pas përzgjedhjes së llojit të regjistrimit, sistemi i informatizuar shfaq formularin e konfirmimit të së dhënës, sipas formatit të miratuar, i cili mban numrin përkatës (një numër për çdo dosje ose aplikim), të dhënë nga sistemi i informatizuar (numri i çështjes), si dhe të dhënat e

përgjithshme për subjektin raportues dhe të dhënat e detyrueshme për pronarët përfitues të subjektit raportues;

b) Pasi personi i autorizuar për të përfaqësuar subjektin raportues verifikon se të dhënat e plotësuara në formular janë të sakta, i konfirmon ato me mjete elektronike që garantojnë autenticitetin e origjinës dhe pacenueshmërinë e përmbajtjes së dokumenteve në format elektronik, të paktën, nëpërmjet nënshkrimit elektronik të avancuar të formularit të aplikimit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nënshkrimin elektronik.

c) Me konfirmimin elektronik të aplikimit, sipas shkronjës "b", të kësaj pike, personi i autorizuar për të përfaqësuar subjektin raportues konfirmon automatikisht në regjistër edhe të dhënat për pronarët e tyre përfitues;

ç) Sistemi i informatizuar njofton, gjithashtu, personin e autorizuar për të përfaqësuar subjektin raportues, në postën elektronike të deklaruar pranë portalit unik të shërbimeve qeveritare *e-Albania*, duke i dërguar kopje elektronike të formularit të aplikimit të plotësuar dhe të konfirmimit të kryerjes së aplikimit nga sporteli elektronik.

6. Në rast se subjekti raportues nuk vepron sipas pikës 3, të këtij kreu, atëherë QKB-ja dhe autoriteti përgjegjës për mbajtjen e Regjistrit të Organizatave Jofitimprurëse do të ndërpresin shërbimet e tyre për subjektet raportuese deri në:

a) përditësimin e të dhënave për pronarët e tyre përfitues në regjistër dhe pagimin e gjobës, në rast se ky mospërditësim përbën edhe kundërvajtje administrative sipas pikave 2 dhe 3, të nenit 13, të ligjit; ose

b) konfirmimin në regjistër të të dhënave për pronarët e tyre përfitues, të regjistruara më parë në regjistër.

VII. DISPOZITA PËR NJOFTIMIN E VENDIMEVE

1. Çdo vendim i QKB-së në lidhje me miratimin apo refuzimin e një aplikimi njoftohet nëpërmjet publikimit në regjistër. Data e njoftimit është data e publikimit në regjistër.

2. Gjithashtu, vendimi i publikuar sipas pikës 1, të këtij kreu, i njoftohet me shkrim personit të autorizuar për të përfaqësuar subjektin raportues, edhe në adresën e postës elektronike të deklaruar në sportelin elektronik, pranë portalit unik të shërbimeve qeveritare *e-Albania*.

3. Aplikanti, brenda afatit të paraqitjes së ankimit administrativ, sipas nenit 11, të ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues, mund t'i drejtohet sektorit të informimit dhe asistencës së QKB-së, nëse dëshiron të diskutojë apo të sqarojë shkaqet e një vendimi për refuzimin e një aplikimi. Në këto raste, nëpunësit e sektorit të informimit dhe asistencës i japin sqarime paraprake aplikantit lidhur me vendimin për refuzimin e aplikimit.

4. Nëse në vijim të diskutimit apo të sqarimit të shkaqeve të një vendimi për refuzimin e një aplikimi aplikanti nuk është dakord me vendimin e QKB-së, atëherë aplikanti ka të drejtë të paraqesë ankim administrativ, sipas nenit 11, të ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues.

5. Ushtrimi i së drejtës së aplikantit për të diskutuar apo sqaruar shkaqet e një vendimi nuk është kusht për paraqitjen e një ankimi administrativ. Aplikanti mund të paraqesë menjëherë një ankim administrativ, sipas nenit 11, të ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues, ndaj një vendimi të QKB-së.

VIII. AKSESI NË REGJISTRIN E PRONARIT PËRFITUES DHE TË DHËNAT E TIJ

1. Në Regjistrin e Pronarëve Përfitues janë publike dhe lirisht të aksesueshme të dhënat e regjistruara në regjistër, si më poshtë vijon:

a) emri dhe mbiemri i pronarit përfitues;

b) shtetësia;

c) viti dhe muaji i lindjes;

ç) data e përcaktimit të individit si pronar përfitues;

d) lloji dhe përqindja e pronësisë:

- direkte;
- indirekte.

2. Çdo person i interesuar ka të drejtë të marrë, pa pengesa, ekstrakte elektronike për të dhënat që janë publike për pronarët përfitues të një subjekti raportues të caktuar.

3. Nëse personi i interesuar dëshiron të marrë ekstrakte në format shkresor, duhet të paraqesë një kërkesë me shkrim, sipas formatit të miratuar nga ministri përgjegjës në fushën e ekonomisë, shoqëruar me mandatpagesën e tarifës përkatëse. QKB-ja, pas vlerësimit të kërkesës, lëshon ekstraktin në format shkresor, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.

4. Ekstraktet lëshohen sipas formatit të miratuar nga ministri përgjegjës në fushën e ekonomisë, me propozimin e titullarit të QKB-së.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 1089, datë 24.12.2020

PËR KRIJIMIN DHE MËNYRËN E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME PËR ZGJIDHJEN ALTERNATIVE TË MOSMARRËVESHJEVE, SI DHE PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE SHTESË QË DUHET TË PËRMBUSHIN STRUKTURAT PËR ZGJIDHJEN ALTERNATIVE TË MOSMARRËVESHJEVE[1]

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 52/6, pika 3, e 56, pika 2, të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, "Për mbrojtjen e konsumatorëve", të ndryshuar; me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Miratimin e krijimit dhe mënyrës së organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve (DPZAM) për mosmarrëveshjet e përgjithshme konsumatore dhe përcaktimin e kritereve shtesë që duhet të përmbushin strukturat për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve.

2. Entet dhe autoritetet rregullatore janë të pavarura për të organizuar, në përputhje me legjislacionet e tyre të posaçme, formën, strukturën, përbërjen e njësive apo komisioneve që do të kryejnë funksionet e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve (në vijim, ZAM).

II. STATUSI, ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I DPZAM-së

A. Statusi i Drejtorisë së Përgjithshme për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve

1. Drejtoria e Përgjithshme për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve (në vijim, DPZAM) është institucion qendror me statusin e personit juridik publik buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për tregtinë (në vijim, ministri), me seli në Tiranë.

2. DPZAM-ja financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të ligjshme.

3. Misioni i DPZAM-së është të garantojë mbrojtjen e interesave të konsumatorit në treg përmes zgjidhjeve të mosmarrëveshjeve ndërmjet konsumatorit e tregtarit, që janë në fushën e saj të përgjegjësisë.

4. DPZAM-ja e ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e vendit dhe ka fushë përgjegjësie zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve të tjera nga ato që lidhen me shërbimet për interes publik, të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e konsumatorit, e që rrjedhin nga kontratat e shitjes apo shërbimit ndërmjet konsumatorit dhe tregtarit.

B. Përgjegjësitë funksionale të DPZAM-së

5. DPZAM-ja ka përgjegjësi:

a) të organizojë punën për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në fushën e saj të përgjegjësisë, duke garantuar kështu aksesin e konsumatorit në mekanizma mbrojtës jashtëgjyqësorë me cilësi të lartë, transparentë, efektivë dhe të drejtë;

b) të organizojë punën për garantimin e nivelit të cilësisë së shërbimit të ofruar ndaj konsumatorëve;

c) të sigurojë organizimin e brendshëm administrativ, në mënyrë të tillë që të garantojë trajtimin e mosmarrëveshjeve nga persona përgjegjës, në përputhje me kërkesat e parashikuara në legjislacionin e posaçëm;

ç) të organizojë punën për të garantuar mundësinë dhe mjetet e nevojshme që konsumatori të paraqesë ankesën *online*, me postë apo sipas rastit, në mënyrë të drejtpërdrejtë;

[1] Ky vendim është përafruar pjesërisht me direktivën 2013/11/BE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 21.5.2013, "Për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve të konsumatorëve", e cila ndryshon Rregulloren (KE) nr. 2006/2004 dhe direktivën 2009/22/KE", (Direktiva për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve (ZAM) konsumatore); numri CELEX: 32013L0011, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 165, datë 18.6.2013, f. 63–79.

d) të organizojë punën që të krijojë mjetet e nevojshme që u ofrojnë lehtësisht palëve informacionin e nevojshëm për procedurën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

C. Organizimi dhe funksionimi i DPZAM-së

6. DPZAM-ja e ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ajo organizohet në nivel qendror, në formën e drejtorisë së përgjithshme.

7. Struktura dhe organika e DPZAM-së miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për organizimin e funksionimin e administratës shtetërore.

8. DPZAM-ja drejtohet dhe përfaqësohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili organizon dhe drejton veprimtarinë e DPZAM-së e përgjigjet përpara ministrit.

9. DPZAM-ja kryen këto detyra:

a) shqyrton dhe zgjidh mosmarrëveshjet në fushën e saj të përgjegjësisë, në zbatim të procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e konsumatorëve;

b) vendos, sipas rastit, dhe në përputhje me preferencat dhe vullnetin e shfaqur të konsumatorit, nëse do të propozojë apo detyrojë një zgjidhje, ose i takon palët me njëra-tjetrën, me qëllim që të mundësojë gjetjen e një zgjidhjeje, duke respektuar kërkesat e parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e konsumatorit;

c) realizon, nëse është rasti, takimin e palëve me njëra-tjetrën, duke siguruar, përmes ndërmjetësimit, gjetjen e një zgjidhjeje;

ç) krijon mekanizmat e nevojshëm për të siguruar që konsumatori të paraqesë një ankesë *online* në faqen *web*, me postë apo, sipas rastit, në mënyrë të drejtpërdrejtë;

d) krijon dhe përditëson faqen e internetit, me qëllim që t'u ofrojë palëve informacionin e nevojshëm për procedurën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, si dhe dhënien e këtij informacioni, me kërkesën e palëve, nëpërmjet një mjeti komunikimi të qëndrueshëm;

dh) mban regjistrin me qëllim regjistrimin e trajtimin e mosmarrëveshjeve;

e) bashkërendon punën me strukturat e tjera ZAM, që lidhen me shërbimet me interes publik;

ë) mbledh e përpunon të dhënat statistikore që i shërbejnë për përgatitjen e raporteve vjetore;

f) përgatit raportin vjetor të aktivitetit, si dhe raporton, sa herë i kërkohet, tek autoriteti kompetent dhe te ministri përgjegjës;

g) bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse në fushën e tregtisë dhe Komisionin e Mbrojtjes së Konsumatorëve, si autoriteti kompetent për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nga struktura ZAM;

gj) ndihmon, sipas rastit, strukturën përgjegjëse administrative, në ministrinë përgjegjëse për tregtinë, në funksionin e Sekretariatit të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve.

10. Marrëdhëniet e punës së drejtorit të Përgjithshëm dhe të nëpunësve të DPZAM-së rregullohen në bazë të legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

11. Ministri, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të DPZAM-së, miraton rregulloren që përcakton metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të DPZAM-së.

12. DPZAM-ja ka stemën, logon dhe vulën zyrtare. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet "Republika e Shqipërisë, Ministria... (emri i ministrisë nga varet DPZAM-ja), Drejtoria e Përgjithshme për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve të Përgjithshme Konsumatore", në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

13. Vula e DPZAM-së ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, të administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III. KRITERET SHTESË QË DUHET TË PËRMBUSHIN STRUKTURAT PËR ZGJIDHJEN ALTERNATIVE TË MOS-MARRËVESHJEVE (ZAM)

A. Fusha e zbatimit

1. Ky kre përcakton kriteret shtesë për mekanizmat dhe procedurat e funksionimit të strukturave përgjegjëse për zgjidhjen jashtë-gjyqësore/alternative të mosmarrëveshjeve kombëtare ose ndërkufitare në lidhje me detyrimet kontraktuale që rrjedhin prej kontratave të shitjes ose shërbimeve ndërmjet konsumatorëve dhe tregtarëve me seli në Shqipëri, sipas parashikimeve të neneve 52–52/6, të ligjit nr. 9902, datë

17.4.2008, "Për mbrojtjen e konsumatorëve", të ndryshuar, dhe të këtij vendimi.

2. Dispozitat e këtij kreu dhe ato të krerëve IV, V e VI, të këtij vendimi, zbatohen nga:

a) strukturat përgjegjëse ZAM për shërbimet me interes publik, sipas përcaktimit në nenin 52/2, të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, "Për mbrojtjen e konsumatorëve", të ndryshuar;

b) Drejtoria e Përgjithshme për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve (DPZAM), sipas përcaktimeve të kreut II, të këtij vendimi.

3. Dispozitat e këtij kreu nuk zbatohen për:

a) procedurat e ndjekura nga strukturat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, në të cilat, personat fizikë, të ngarkuar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, janë të punësuar ose shpërblehen ekskluzivisht nga një tregtar i veçantë;

b) procedurat e ndjekura nga sistemet e ankesave të konsumatorëve, të përdorura nga tregtari;

c) shërbimet joekonomike të interesit të përgjithshëm;

ç) mosmarrëveshjet ndërmjet tregtarëve;

d) negociatat e drejtpërdrejta ndërmjet konsumatorit e tregtarit;

dh) përpjekjet e bëra nga gjykata për të zgjidhur një mosmarrëveshje gjatë një procesi gjyqësor lidhur me atë mosmarrëveshje;

e) procedurat për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje të nisura nga një tregtar përkundrejt një konsumatori;

ë) shërbimet shëndetësore të ofruara nga profesionistët e shëndetësisë për pacientët, për të vlerësuar, ruajtur apo rikthyer gjendjen e tyre shëndetësore, përfshirë lëshimin e recetave, shpërndarjen dhe ofrimin e produkteve mjekësore dhe pajisjeve mjekësore;

f) ofruesit publikë të arsimit të lartë ose formimit të vazhduar.

B. Lidhja me akte të tjera juridike

4. Parashikimet e këtij vendimi, për informacionin që tregtari duhet t'i ofrojë konsumatorit lidhur me strukturën ZAM, zbatohen pa cenuar dispozita të tjera të vendosura në ligje të posaçme, të cilat zbatohen në mënyrë kumulative ndaj parashikimeve të këtij vendimi.

C. Aksesi te një strukturë ZAM

5. Përveçse sa parashikohet në pikat 1 e 3, të nenit 52/3, të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, "Për mbrojtjen e konsumatorëve", të ndryshuar, struktura ZAM, për fillimin e shqyrtimit të mosmarrëveshjes/ankesës së konsumatorit, nëpërmjet procedurave ZAM, siguron që:

a) ankesa nga konsumatori paraqitet:

i. nëpërmjet formularit, që gjendet *online* në faqen e internetit të strukturës ZAM;

ii. me postë; ose

iii. në mënyrë të drejtpërdrejtë;

b) elementet që duhet të përmbajë ankesa e paraqitur nga konsumatori dhe afatet procedurale për plotësimin e saj përcaktohen në rregulloret përkatëse të strukturës ZAM.

Ç. Profesionalizmi, pavarësia dhe paanësia

6. Struktura ZAM, përveç sa është parashikuar në nenet 52/3, pika 2, dhe 52/4, pika 3, të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, "Për mbrojtjen e konsumatorëve", të ndryshuar, për personat që duhet të kryejnë procedurat ZAM, duhet të sigurojë edhe trajnime për personat e emëruar në këtë detyrë. Në rastet kur ofrohet një trajnim i tillë, struktura ZAM njofton autoritetin kompetent për skemat e trajnimit, sipas informacionit që ky i fundit duhet të marrë nga strukturat ZAM, sipas pikës 9, të nenit 52, të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, "Për mbrojtjen e konsumatorëve", të ndryshuar.

D. Transparenca

7. Përveç informacionit që duhet të japë struktura ZAM, sipas pikës 3, të nenit 52/3, të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, "Për mbrojtjen e konsumatorëve", të ndryshuar, ajo jep edhe informacionin për:

a) llojet e rregullave dhe normave juridike që do të zbatojë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, të tilla si: normat juridike në mbrojtje të konsumatorëve, normat e kodeve të sjelljes, të cilat tregtari i ka pranuar, normat e zakoneve të mira tregtare dhe të atyre të mirëbesimit;

b) faktin nëse është anëtare e ndonjë rrjeti rajonal ose evropian të strukturave ZAM për të lehtësuar zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkufitare, sipas rastit;

c) gjuhën në të cilën mund të dorëzohet ankesa dhe në të cilën realizohet procedura;

ç) faktin nëse është listuar nga autoriteti kompetent sipas pikës 9, të nenit 52, të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, "Për mbrojtjen e konsumatorëve", të ndryshuar.

8. Në raportin vjetor që duhet të publikohet, sipas kërkesave të pikës 11, të nenit 52, të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, "Për mbrojtjen e

konsumatorëve", të ndryshuar, struktura ZAM, përveç sa kërkohet në pikën 10, të nenit 52, të ligjit sa më sipër, jep, sipas rastit, edhe informacionin nëse bashkëpunon brenda rrjeteve të strukturave ZAM, të cilat lehtësojnë zgjidhjen ndërkufitare të mosmarrëveshjeve.

DH. Efektiviteti i procedurës ZAM

9. Përveçse sa parashikohet për efektivitetin e procedurës ZAM në nenin 52/5, pika 1, shkronjat "a" deri "d", të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, "Për mbrojtjen e konsumatorëve", të ndryshuar, struktura ZAM, gjatë zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, zbaton këto kërkesa:

a) procedurat e ZAM-së t'i bëjë të disponueshme dhe të gjenden me lehtësi në rrugë elektronike, si dhe me kopje të shtypura për të dyja palët;

b) përdorimi i procedurës nga palët, pa qenë të detyruar të përfaqësohen nga një avokat ose një këshilltar ligjor, por procedura nuk duhet t'i privojë palët nga e drejta e tyre për të marrë këshilla të pavarura, ose për t'u përfaqësuar ose ndihmuar nga një palë e tretë në çdo fazë të procedurës;

c) procedura e ZAM-së për konsumatorët është pa pagesë.

10. Struktura ZAM fillon procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, në datën kur ka marrë ankesën të plotësuar dhe njofton palët për fillimin e kësaj procedure.

E. Drejtësia e procedurës ZAM

11. Përtej sa parashikohet në shkronjat "dh" e "e", të pikës 1, të nenit 52/5, të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, "Për mbrojtjen e konsumatorëve", të ndryshuar, struktura ZAM njofton palët:

a) që, brenda një periudhe prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh kalendarike pas marrjes së njoftimit për fillimin e procedurës ZAM, kanë të drejtë të shprehin pretendimin e tyre, si dhe t'u vihen në dispozicion nga struktura ZAM argumentet, dëshmitë, dokumentet dhe faktet të paraqitura nga pala tjetër, çdo deklaratë dhe opinion që mund të jetë dhënë nga ekspertët, për të cilat kanë të drejtë të paraqesin prapësime;

b) që nuk janë të detyruara të përfaqësohen nga një avokat apo këshilltar ligjor, por mund të kërkojnë këshillim të pavarur ose të përfaqësohen ose të ndihmohen nga një palë e tretë në çdo fazë të procedurës;

c) për rezultatin e procedurës ZAM me shkrim ose me anë të një mjeti të qëndrueshëm komunikimi dhe u jep atyre një vendim të arsyetuar me shkaqet, në të cilat është bazuar rezultati.

Ë. Propozimi i një zgjidhjeje - respektimi i parimit të drejtësisë

12. Në rastin kur procedura ZAM parashikon për propozimin e një zgjidhjeje, atëherë struktura ZAM njofton palët se:

a) kanë të drejtë për t'u tërhequr nga procedura në çdo fazë, nëse janë të pakënaqur me ecurinë ose funksionimin e procedurës. Ato informohen për këtë të drejtë përpara se të nisë procedura. Kur rregullat e posaçme parashikojnë pjesëmarrjen e detyrueshme të tregtarit në procedurat e ZAM, kjo pikë do të zbatohet vetëm për konsumatorin;

b) palët, përpara se të bien dakord ose të ndjekin një zgjidhje të propozuar, informohen se:

i. mund të zgjedhin të pranojnë ose jo zgjidhjen e propozuar;

ii. pjesëmarrja në procedurë nuk përjashton mundësinë për të kërkuar zgjidhje përmes proceseve gjyqësore;

iii. zgjidhja e propozuar mund të jetë e ndryshme nga ajo që mund të vijë si rezultat i një vendimi gjykate;

c) palët, përpara se të bien dakord për një zgjidhje të propozuar ose pasi të kenë ndjekur një zgjidhje të tillë, informohen për pasojat juridike të pranimit ose të ndjekjes së një zgjidhjeje të tillë të propozuar;

ç) palëve u lihet një periudhë prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh kalendarike për të vendosur, përpara se të shprehin pëlqimin e tyre, për një zgjidhje të propozuar ose një marrëveshje miqësore.

13. Në rast se procedurat e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve parashikojnë që rezultati i tyre është detyrues për tregtarin, pasi konsumatori e ka pranuar zgjidhjen e propozuar, përcaktimet e pikës së mësipërme janë të zbatueshme vetëm për konsumatorin.

F. Detyrimi i një zgjidhjeje - respektimi i parimeve të lirisë dhe ligjshmërisë

14. Përveç sa parashikohet në pikat 2 e 3, të nenit 52/5, të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, "Për mbrojtjen e konsumatorëve", të ndryshuar, për respektimin e lirisë kontraktuale të konsumatorit, zbatohen edhe parashikimet e mëposhtme.

15. Palët, përpara se të bien dakord për këtë mënyrë të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, njoftohen se:

a) zgjidhja është e detyrueshme;

b) ato nuk kanë zgjedhje për të rënë dakord apo për të zbatuar vendimin e dhënë në përfundim të procedurës ZAM;

c) asnjëra prej palëve nuk mund të tërhiqet nga procedura;

ç) pjesëmarrja në procedurë nuk pengon mundësinë për të kërkuar mbrojtje në gjykatë;

d) kjo zgjidhje mund të jetë e ndryshme nga ajo që mund të japë gjykata duke zbatuar normat juridike;

dh) pasojat juridike të kësaj zgjidhjeje.

16. Strukturat ZAM duhet të sigurohen se palët kanë shfaqur në mënyrë të vërtetë e serioze pëlqimin lidhur me natyrën detyruese të zgjidhjes.

17. Pranimi i posaçëm nga ana e tregtarit nuk do të kërkohet, nëse parashikohen rregulla të posaçme, që zgjidhjet të jenë detyruese për tregtarët.

18. Zgjidhja e detyruar nuk mund të privojë konsumatorin nga mbrojtja që i ofrohet nga normat urdhëruese të ligjit të vendit, ku konsumatori dhe tregtari kanë vendqëndrimin e zakonshëm të përbashkët, të cilat nuk mund të shmangen me marrëveshje të palëve, në ato raste kur nuk ka zbatim të normave të së drejtës ndërkombëtare private.

19. Sa më sipër për konsumatorin, zbatohet edhe në rastet kur gjen zbatim legjislacioni në fuqi për të drejtën ndërkombëtare private. Në këto raste vendqëndrimi i zakonshëm përcaktohet po sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për të drejtën ndërkombëtare private.

G. Përfundimi i procedurës ZAM

20. Palët lidhin marrëveshje kur pranojnë zgjidhjen e propozuar, në rastin e zgjidhjes së detyrueshme, struktura ZAM lëshon një vendim të arsyetuar, ndërsa kur palët nuk e pranojnë zgjidhjen e propozuar, struktura ZAM lëshon një raport, i cili përmban identitetin e palëve, një përshkrim të fakteve, zgjidhjen e propozuar dhe vendimin e palëve.

21. Kur tregtari nuk e pranon zgjidhjen e propozuar, struktura ZAM njofton konsumatorin, sipas një raporti, për procedurat rishikuese ose ankuese administrative dhe gjyqësore që ai mund të ndërmarrë për të zgjidhur mosmarrëveshjen.

22. Vendimi ose, respektivisht raporti, u njoftohet palëve, me shkrim ose në një mjet të qëndrueshëm, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike pas shpalljes dhe sjell pasoja për palët nga data e njoftimit. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e njoftimit.

GJ. Efektet e procedurës ZAM për parashkrimin

23. Fillimi i procedurës ZAM përbën shkak për pezullimin e afatit të parashkrimit të padisë. Gjatë zhvillimit të procedurës ZAM, afati i parashkrimit të padisë nuk fillon të ecë ose, nëse ka filluar, ai pezullohet.

24. Sa më sipër nuk cenon dispozitat për parashkrimin apo prekluzivitetin të parashikuar në marrëveshjet ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

25. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve, Enti Rregullator i Energjisë, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Enti Rregullator i Ujit, Autoriteti i Aviacionit Civil, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Banka e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

26. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr.1091, datë 24.12.2020

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.220, DATË 12.3.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORISË SË TATIMPAGUESVE DHE TË KRITEREVE TË PËRDORIMIT TË PROCEDURËS SË THJESHTËZUAR TË FISKALIZIMIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 22, pika 1, dhe 27, pika 1, të ligjit nr.87/2019, "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.220, datë 12.3.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në fjalinë e parë, pas fjalëve "... nëse përmbushin ..." shtohet fjala "... njëkohësisht ...";

b) Shkronja "b" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"b) Kanë përgjegjësi tatimore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël;";

c) Pas shkronjës "c" shtohet shkronja "d", me këtë përmbajtje:

"d) Kanë statusin ligjor "Person fizik" dhe kategorinë e punësimit "I vetëpunësuar i vetëm.".

2. Në pikën 2 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në fjalinë e parë, pas fjalëve "... nëse përmbushin ..." shtohet fjala "... njëkohësisht ...";

b) Shkronja "a" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"a) Kanë përgjegjësi tatimore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël;";

c) Pas shkronjës "b" shtohet shkronja "c", me këtë përmbajtje:

"c) Kanë statusin ligjor "Person fizik" dhe kategorinë e punësimit "I vetëpunësuar i vetëm.".

3. Pas pikës 2 shtohen pikat 2.1 dhe 2.2, me këtë përmbajtje:

"2.1. Tatimpaguesit që kryejnë transaksione pa para në dorë me organet publike mund të lëshojnë dhe fiskalizojnë fatura elektronike për këto transaksione nëpërmjet platformës qendrore të faturave, deri në datën 30 qershor 2021.

2.2. Organet publike qendrore dhe vendore mund të lëshojnë fatura dhe fatura elektronike dhe të kryejnë procedurën e fiskalizimit për transaksionet që kryejnë, përmes përdorimit të platformës qendrore të faturave.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 1092, datë 24.12.2020

PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES TË ENERGJISË ELEKTRIKE EOLIKE DHE VEPRAVE NDIHMËSE NË ZONËN E SEMANIT, NJËSIA ADMINISTRATIVE TOPOJË, BASHKIA FIER, QARKU FIER, NGA SHOQËRIA "GREENTECH" SHPK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr.43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.7/2017, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike eolike dhe veprave ndihmëse në zonën e Semanit, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria "Greentech" sh.p.k., me elementet, si më poshtë vijon:

a) Emri i aplikuesit: "Greentech" sh.p.k.;

b) Numri i identifikimit personal të zyrës së taksave NIPT/NUIS: L92924402E;

c) Tipi i centralit: eolik;

ç) Kapaciteti i instaluar: 3 mw;

d) Numri i njësive gjeneruese të burimit gjenerues të energjisë dhe kapaciteti i tyre në mw: 1 (një) turbinë me kapacitet 3 mw;

dh) Afati i pritshëm i vënies në punë: Koha për ndërtimin dhe vënien në operim të parkut eolik do të jetë brenda 24 (njëzet e katër) muajve nga marrja e lejes së ndërtimit;

e) Vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: zona e Semanit, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier;

ë) Afati i miratimit të ndërtimit: 48 (dyzet e tetë) muaj nga hyrja në fuqi e këtij miratimi;

f) Koordinatat e tokës, sipas aneksit 1 bashkëlidhur këtij vendimi;

g) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe institucione të tjera të autorizuara prej saj kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore gjatë realizimit dhe vënies në punë, me synimin që të verifikojnë se ecuria e punimeve,

cilësia dhe konformiteti të jenë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit e të dokumentacionit të projektit;

gj) Shoqëria "Greentech" sh.p.k., ka detyrimin:

i. që të paraqesë periodikisht (çdo 3 (tre) muaj), pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, informacion për ecurinë e ndërtimit të centralit eolik;

ii. që të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;

iii. e dorëzimit të sigurimit të kontratës, në masën jo më pak se 5 (pesë) % të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës ndërmjet shoqërisë "Greentech" sh.p.k., dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat e detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera, që lidhen me zbatimin e saj;

iv. që t'i japë falas, në formë royalty, ministrisë përgjegjëse për energjinë, sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 (dy) % të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare, "Greentech" sh.p.k., duhet t'i derdhë tërësisht në buxhetin e shtetit;

v. që të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t'i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

ANEKSI 1

Koordinatat e tokës

Shoqëria "*Greentech*" sh.p.k., është pajisur me kontratë "Për dhënien me qira të tokës ranishte" nr.1617 Rep., nr. 596 Kol, datë 23.12.2019, ndërmjet Bashkisë Fier dhe "*Greentech*" sh.p.k. Objekt i kësaj kontrate është marrja me qira e një pasurie shtetërore të paluajtshme e llojit tokë pa frut (ranishte), me sipërfaqe 37,300 m^2, e ndodhur në Fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, me numër pasurie 286/6, zona kadastrale 3358, volum 10, faqe 86, e regjistruar në ZVRPP Fier me certifikatë pronësie, lëshuar më 6.2.2019.

X	Y
363446.53	4517253.923
363926.088	4517253.923
363446.53	4516857.048
363926.088	4516857.048

VENDIM
Nr. 1093, datë 24.12.2020

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA PROJEKTI "NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR 'HIDROCENTRALI I BANJËS – GRAMSH DHE URA E TRASHOVICËS'" (SHTESAT)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga projekti: "Ndërtimi i segmentit rrugor 'Hidrocentrali i Banjës – Gramsh dhe Ura e Trashovicës'" (shtesat).

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë e llojit tokë "arë", me vlerë 87 000 (tetëdhjetë e shtatë mijë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 87 000 (tetëdhjetë e shtatë mijë) lekësh, të përballohet nga shoqëria "Devoll Hydropower" sh.a.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga shoqëria "Devoll Hydropower" sh.a.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë 3 (tre) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, i pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit, pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Shoqëria "Devoll Hydropower" sh.a., të kryejë likuidimin e detyrimeve, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5 dhe 7, menjëherë pas miratimit të këtij vendimi.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara në projekt.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Gramsh, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar dhe shoqërinë "Devoll Hydropower" sh.a., brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë në favor të shtetit.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Gramsh, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar, deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, shoqëria "Devoll Hydropower" sh.a., Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Zyra Vendore Gramsh, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

TABELA E SHPRONËSIMIT TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT: NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "HIDROCENTRALI I BANJËS – GRAMSH DHE URA E TRASHOVICËS" (SHTESAT)

Çmimi për pasurinë tokë "arë" sipas VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Zona kadastrale	N/pasurisë	Lloji i pronës	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera	Konfirmimi nga ZVRPP-ja
1	Asllan Ramazan Çarçiu	1556	40	Tokë "arë"	m²	500	174	87,000	Konfirmuar nga ASHK-ja.
Shuma totale e shpronësimit						500		87,000	

VENDIM
Nr. 1094, datë 24.12.2020

PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË KOMBËTARE TË LLOGARITJES SË PERFORMANCËS SË ENERGJISË NË NDËRTESA[2]

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 116/2016, "Për performancën e energjisë së ndërtesave", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Metodologjisë Kombëtare të Llogaritjes së Performancës së Energjisë në Ndërtesa, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Të dhënat mbi rrezatimin diellor sipas ndarjeve administrative dhe për gjerësinë gjeografike të Shqipërisë sigurohen nga institucionet shtetërore që monitorojnë klimën dhe miratohen nga ministri përgjegjës për energjinë brenda 1 (një) muaji nga hyrja në fuqi e kësaj metodologjie.

3. Të dhënat klimatike që përfshijnë temperaturat minimale dhe maksimale javore por edhe rrezatimin direkt ditor/mujor në w/m^2, së bashku me lagështinë relative, sigurohen nga institucionet shtetërore që monitorojnë klimën dhe miratohen nga ministri përgjegjës për energjinë brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi kësaj metodologjie.

4. Të dhënat mbi rrezatimin diellor ato klimatike të referuara në pikat 2 dhe 3, të këtij vendimi, përditësohen çdo tre vjet.

5. Ndryshimet dhe përmirësimet e vazhdueshme në këtë metodologji bëhen me urdhër të ministrit përgjegjës për energjinë, me propozim të agjencisë përgjegjëse për eficiencën e energjisë.

6. Programi kompjuterik i miratuar është pronë e agjencisë përgjegjëse për eficiencën e energjisë dhe miratohet nga ministria përgjegjëse për energjinë dhe ministria përgjegjëse për çështjet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

7. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe agjencia përgjegjëse për eficiencën e energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

[2] *Ky vendim përafron pjesërisht direktivën 2010/31/EU të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 19 tetor 2010, "Për performancën e energjisë së ndërtesave" të ndryshuar.

METODOLOGJIA KOMBËTARE E LLOGARITJES SË PERFORMANCËS SË ENERGJISË NË NDËRTESA
Gusht 2020

Tabela e Përmbajtjes

1. Përmbledhje e metodologjisë

1.1 Objektivi

1.2 Qëllimi

1.3 Fushëveprimi

1.4 Standardet

1.5 Programi kompjuterik

1.6 Përmbledhje e llogaritjeve

1.7 Të dhenat dhe burimet e informacionit

1.8 Metodologjia e detajuar

1.9 Të dhënat

2. Algoritmi i llogaritjeve

2.1 Metoda e përzgjedhur e llogaritjeve

2.2 Kërkesa për ventilim

2.3 Kërkesa për ujë të ngrohtë

2.4 Vlerësimi i nevojave energjetike për ndriçim

2.5 Llogaritja e konsumit (përdorimit) të energjisë për ngrohje

2.6 Llogaritja e nevojave të energjisë për ftohje

2.7 Konsumi i energjisë në sistemet teknike mbështetëse

2.8 Nevoja energjetike për ujë të ngrohtë

2.9 Sistemet Termike të Energjisë Diellore

2.10 Fotovoltaikët

2.11 Gjeneratorët e erës

2.12 Gjeneratorët/Sistemet e prodhimit të kombinuar të Energjisë Elektrike dhe Energjisë Termike

3. Referenca për algoritmet e llogaritjes

4. Të dhëna hyrëse standarde

4.1 Hyrja

4.2 Përcaktimi i fitimeve të brendshme të energjisë dhe kushteve mjedisore

4.3 Ana Ndërtimore

4.4 Burimet primare energjetike të konsumuara dhe sistemet me emetime të ulta dhe zero të CO_2

4.5 Të dhënat Klimatike

4.6 Faktorët e emetimit të lëndëve djegese si dhe fatorët e energjisë primare

4.7 Ndriçimi

4.8 Matjet dhe konventat/metodat e tjera

4.9 Sistemet alternative të energjisë

5. Protokolli i llogaritjeve

5.1 Hyrja

5.2 Ndërtesa Referente

5.3 Ndërtesa Aktuale

6. Metoda e llogaritjes për parametrin e performancës termike Gvt

6.1 Koeficienti i humbjes volumetrike të nxehtësisë, G_{vt}

6.2 Metodologjia ekzistuese për llogaritjen e G_V sipas Ligjit Shqiptar për Energjinë në Ndërtesa dhe VKM. 38, 16/01/2003

6.3 Zonat klimatike të Shqipërisë dhe vlerat e lejuara(limit) te Gv

A1 Zonimi i mjediseve te brendeshme

A1.1 Rregullat për ndarjen e zonave

A2 Baza e të dhënave të veprimtarisë MKLL

A2.1 Hyrje

A2.2 Llojet e ndërtesave

A2.3 Aktivitetet

A2.4 Oraret e aktiviteteve

A3 Faktorët e eficencës sezonale të sistemit

A3.1 Ngrohje

A3.2 Ftohja

Tabelat dhe figurat

Tabelat

Tabela 1 Përmbledhja e standardeve CEN për llogaritjen

Tabela 2 Faktorët e korrigjimit të hijëzimit të pjesshëm për mbrojtjet e tejzgjatura nga dielli (grilat dhe perdet), Fo.

Tabela 3. Faktorët e korrigjimit të hijëzimit të pjesshëm për mbrojtjen vertikale nga dielli, Ff.

Tabela 4. Faktori i korrigjimit FW për vlerën g të xhamave jo të tejdukshëm

Tabela 5 Të dhënat për pajisjet tipike për mbrojtjen diellore[2]

Tabela 6. Vlerat e parametrit numerike a0,H dhe konstantja e kohës të referencës 0,H për ngrohjen për metodën e llogaritjes mujore

Tabela 7. Vlerat e parametrit numerik a0,H dhe konstantja e kohës të referencës 0,H për ftohjen për metodën e llogaritjes mujore

Tabela 8. Trashësia maksimale për tu konsideruar për kapacitetin e brendshëm të ngrohjes

Tabela 9. Eficencat përkatëse të sistemeve të rikuperimit të nxehtësisë

Tabela 10. Vlerat e përdorura për temperaturën e ajrit të furnizuar për llogaritjen e humbjeve mujore të ventilimit për kerkesën për ftohje

Tabela 11. Vlerat për koeficientin e kontrollit të kërkesës

Tabela 12. Eficenca e ndriçimit për tu përdorur kur llogaritet lloji i llambës për tu zgjedhur

Tabela 13. Shembulli i të dhënave për intensitetin e ndriçimit të jashtëm në kilo-luxe

Tabela 14. Vlerat Foc.

Tabela 15. Përcaktimi i fuqisë së pompës për sistemet NVKA

Tabela 16 Densiteti i energjisë së pompës

Tabela 17 Përcaktimi i ekuacioneve të fuqisë së ventilatorëve për sistemet NVKA

Tabela 18 Orientimet dhe prirjet për të cilat duhet të llogaritet rrezatimi diellor

Tabela 19 Prirjet për të cilat duhet të llogaritet rrezatimi diellor

Tabela 20 Parametrat e kolektorit të parazgjedhur

Tabela 21 Faktorët e korrelacionit - E përshtatur nga EN 15316-4-4:2007

Tabela 22. Koeficienti i parazgjedhur i fuqisë maksimale, K_{pk}*

Tabela 23. Faktori i hijëzimit, $f_{shading}$

Tabela 24. Faktori i performancës së sistemit, f performance., f_{per}

Tabela 25. Përkufizimet e strategjisë të ventilimit të elementëve të PV

Tabela 26. Kategoritë e terreneve dhe parametrat e lidhura me to (CIBSE, 2002)

. Tabela 27. Eficencat e turbinës të sistemve gjeneruese të erës

Tabela 28. Emetimi i lëndëve djegëse CO2 dhe faktorët primar të energjisë

Tabela 29. Matjet dhe ndërhyrjet e tjera

Tabela 30. Vlerat U për Ndertesën Referente

Tabela 31. Kapaciteti termik i elementëve të ndërtimit në Ndërtesën Referente

Tabela 32. Transmetimet e dritës dhe energjisë diellore për xhamat në Ndertesën Referente

Tabela 33. Përqindja e zonave të hapura në ndërtimin Referente

Tabela 34. Vlerat e parazgjedhura Psi për ndërtesën Aktuale (W/mK)

Tabela 35. Koeficienti Gv i humbjes maksimale të lejueshme të nxehtësisë globale për një ndërtesë të re në ndërtim, për zona të ndryshme klimatike (W/m3.K) dhe lëndë djegëse/burime energjetike që përdoret për ngrohje

Tabela 1 Përshkrimi dhe shembujt e parametrave kyç që shoqërojnë çdo aktivitet

Tabela 37 Ngrohja: Vlerat standarde të eficencës sezonale të sistemit dhe faktorët korrigjues

Tabela 2 Sistemet e rrjedhjes

Tabela 3 AHU – axhustimi i rrjedhjeve

Tabela 4 Ngrohja/ftohja: Vlerat standarde të eficencës të sistemit dhe fuqia specifike

Tabela 5 Ftohja: Vlerat standarde të eficencës sezonale të sistemit dhe faktorët korrigjues

Figurat

Figura 1 Grilat dhe perdet vertikale: a) pamja vertikale b) pamja horizontale

Figura 2. Pozicioni karakteristik i pajisjes së jashtme për mbrojtjen diellore

Figura 3. Pozicionet tipike të perdeve/hijëzuesve për mbrojtjen e brendshme diellore

Figura 4. Shembulli i ngrohjes pothuajse-të- vazhdueshme

Figura 5. Përshtatjet për para ngrohjen diellore *

Republika e Shqipërise – Metodologjia Kombëtare për Llogaritjen e Performancës së Energjisë në Ndërtesa.

1. Përmbledhje e metodologjisë

1.1 Objektivi

Metodologjia Kombëtare e Llogaritjes së Performancës së Energjisë në Ndërtesa (më tej Metodologjia PEN) është një kërkesë e Nenit 5 të ligjit 116 dt 10.11.2016 "Për Performancën e Energjisë në Ndërtesa" dhe ka këto objektiva:

1. Të llogatitë me hollësi të gjitha konsumet finale të energjisë në një ndërtesë dhe në elementët e ndërtesës (për ngrohje, për ftohje, për ventilim dhe sistemet mbështetëse, për ndriçim dhe për sigurimin e ujit të ngrohtë), duke rezultuar në një vlerë të përgjithshme për shfrytëzimin total vjetor të energjise primare për ndërtesën dhe elementët e ndërtesës, sipas kushteve standarde të përdorimit, për metër katror të sipërfaqes së dobishme të dyshemesë[1]. Kjo metodë llogaritëse aplikohet për ndërtesat e reja dhe për ndërtesat ekzistuese që i nënshtrohen një rinovimi të rëndësishëm sipas përcaktimeve të ligjit 116/2016 "Për performancën e Energjisë në Ndërtesa".

2. Të konsiderojë të gjithë elementët që janë përfshirë në VKM. nr. 537, datë 08.07.2020 "*Për Miratimin e Kërkesave Minimale të Performancës së Energjisë së Ndërtesave dhe të Elementëve të Ndërtesave*".

1.2 Qëllimi

Metodologjia Kombëtare e Llogaritjes së Performancës së Energjisë në Ndërtesa, ka për qëllim të përcaktojë të gjitha detajet e llogaritjes që do të përdoren për vlerësimin numerik të performancës së energjisë në ndërtesate e reja dhe atyre ekzistuese me njesitë e tyre në Republikën e Shqipërisë. Metodologjia e PEN përdoret për llogaritjen e nivelit të konsumit të energjisë në përputhje me kërkesat minimale të performancës së energjisë së ndërtesave, njësive dhe elementeve të ndërtesave, me qëllim vlerësimin dhe gjenerimin e certifikatave të performancës së energjisë.

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë detajet e metodologjisë së llogaritjes që do të përdoret për vlerësimin e performancës së energjisë në ndërtesat individuale në Republikën e Shqipërisë. Metodologjia është në përputhje me kërkesat e Nenit 5 të Ligjit 116/2016 për Performancën e Energjisë në Ndërtesa dhe me Nenin 3 të Direktivës së Performancës së Energjisë në Ndërtesa (2010/31 / BE) dhe do të përdoret për të:

[1] Sipërfaqja në përdorim, që përdoret për tu ngrohur dhe ftohur, përjashtuar muret ndarëse.

1.1. Demonstruar përputhshmërinë e një ndertese në projektim, (faza tw tjera) ndwrtim dhe tw pwrfunduar, me Standardet Minimale të Pwrformancës së Energjisë të percaktuara në VKM Nr. 537, datë 08.07.2020 "*Për Miratimin e Kërkesave Minimale të Performancës së Energjisë së Ndërtesave dhe të Elementëve të Ndërtesave*".

1.2. Gjeneruar Certifikatat e Performancës së Energjisë për ndërtesat e reja dhe ekzistuese, në perputhje me vendimin *"Për Miratimin e Proçedurave dhe Kushteve të Certifikimit të Performancës së Energjisë së Ndërtesave dhe Modeli, Përmbajtja, Kushtet e Rregjistrimit të "Certifikatës për Performancën e Energjisë së Ndërtesave"*.

1.3 Fushëveprimi

1. PEN vlerësohet në përputhje me këtë Metodologji nëpërmjet krahasimit të bërë ndërmjet ndërtesës Aktuale dhe Ndërtesës Referente lidhur me vetitë e tyre termofizike të mbështjelljes dhe performancës së sistemeve teknike. Në këtë kontekst Metodologjia është metoda e vetme krahasuese dhe përjashton të gjitha modelet operative që mund mund të jenë të ngjashme. Kjo Metodologji shtrin fushëveprimin tek llogaritjet e Performancës së Energjisë në Ndërtesën Aktuale dhe atë Referente duke përdorur algoritmet (formulat e llogaritjes) dhe bazën e të dhënave të domosdoshme për identifikimin Treguesit të Performancës së Energjise për këto dy modele të ngjashme të së njëjtës ndërtesë të marrë në shqyrtim.
   Në kuptimin e kësaj Metodologjie, "PEN – Performanca e Energjisë në një Ndërtesë" është sasia e llogaritur ose e matur e energjisë, e nevojshme për të plotësuar kërkesat për energji përgjatë një viti, e shoqëruar me një përdorim tipik të ndërtesës, e cila përfshin, ndër të tjera, energjinë e përdorur për ngrohje, ftohje, ventilim, ujë të ngrohtë dhe ndriçim. Ky përcaktim ligjor i referohet vlerësimit të sasisë së energjisë që nevojitet për "përdorimin e standard/tipik" të ndërtesës dhe llogaritet/pjestohet për çdo metër katror të sipërfaqes së banueshme të ndërtesës.

2. Metodologjia do të aplikohet për të gjitha llojet e ndërtesave, duke përfshirë banesat, ndërtesat komerciale, publike dhe industriale (ndërtesat e përdorura në lidhje me prodhimin ose proceset e tjera industriale).

3. Aspektet e mëposhtme të performancës së energjisë së një ndërtese modelohen[2], në mënyre që të llogaritet nevojat/kerkesat vjetore të energjisë së parashikuar brenda ndërtesës:

[2] Modelohen, nënkupton krijimin e një skice në 3 dimensione e ngjashme nga përmasat fundore (gabaritet), modeli përfaqësues i së cilës është ndërtesa aktuale që merret në shqyrtim në programin kompjuterik të miratuar dhe bazohet në treguesit që shërbejnë për llogaritjen e perfromancës së energjisë në ndërtesa.

a. Kërkesa për energji për plotësimin e nevojave për **ngrohjen** e hapësirave

b. Kërkesa për energji për plotësimin e nevojave për **ftohjen** e hapësirave

c. Kërkesa për energji për plotësimin e nevojave për **ventilimin** e hapësirave dhe për sistemet mbështetëse

d. Kërkesa për energji për plotësimin e nevojave për **ujë të ngrohtë sanitar**

e. Kërkesa për energji për plotësimin e nevojave energjetike për **ndriçim**

f. Konsumi vjetor të energjisë për ngrohje

g. Konsumi vjetor të energjisë për ftohje

h. Konsumi vjetor të energjisë për ujë të ngrohtë

i. Konsumi i energjisë për ventilim dhe për sistemet mbështetëse

j. Konsumi i energjise për ndriçimin

k. Sasia e energjisë së prodhuar për llogari të vetëplotësimit të nevojave për energji të ndërtesës nga Sistemet diellore termike dhe fotovoltaike dhe eloike.

l. Sasia e energjisë së prodhuar dhe/ose të furnizuar nga Sistemet e Kombinuara të prodhimit të njëkohshëm të Nxehtësisë dhe të Energjisë elektrike (CHP – Combined Heat and Power).

4. Metodologjia gjithashtu përfshin llogaritjen e një matjeje të performancës termike në një ndërtesë, duke perdorur koeficientin termik volumetrik G_{vt}. Ky proces është përshkruar në Seksionin 6 të dhënë në këtë raport.

1.4 Standardet

Metodologjia është në përputhje me standardet përkatëse të CEN, të miratuara nga Republika e Shqipërisë. Standardet dhe referencat më të rëndësishme janë renditur në Seksionin 3 të kësaj Metodologjie

1.5 Programi kompjuterik

1. Për të kryer llogaritjet e energjisë duke përdorur këtë Metodologji ligji 116/2016 parashikon një program kompjuterik të miratuar (Software). Në kuptimin e kësaj

Metodologjie dhe në përputhje me nenin 3, pika 20 "Programi kompjuterik i miratuar" është pronë e Agjencisë përgjegjëse për Efiçencën e Energjisë dhe miratohet nga Ministria përgjegjëse për Energjinë dhe Ministria përgjegjëse për Çështjet e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

2. Ky program është mjeti i cili llogarit performancën e energjisë bazuar në një metodë llogaritjeje mujore pothuajse-të qëndrueshme, siç përcaktohet në standardet përkatese CEN/ISO të përmendura në pikën 1.3 më sipër. Ky software duhet të përputhet me:

   a. Metodologjinë e përshkruar në këtë dokument

   b. Metodat e përcaktuara në standardet CEN / ISO.

1.6 Përmbledhje e llogaritjeve

1. Programi Kompjuterik i Miratuar (PKM) është motorri që kryen llogaritje në përputhje me algoritmet/formulat dhe bazën e të dhënave që gjenden në këtë Metodologji. Të dhënat hyrëse nga përdoruesi i software dhe baza e të dhënave që janë brënda kësaj Metodologjie administrohen në serverin e AKSHI-t dhe janë në perputhje me kërkesat e kësaj Metodologjie dhe VKM Nr. 537, datë 08.07.2020 për kërkesat minimale. Llogaritjet e kryera mbi algoritmet/formulat dhe baza e të dhënave, duhet të prodhojnë një rezultat në terma të energjisë vjetore që konsumohet nga ndërtesa dhe banorët e saj sipas një përdorimi tipik të ndërtesës. Disa nga inputet duhet të standardizohen për të lejuar krahasime të qëndrueshme ndërmjet ndërtesave.

2. PKM do të llogarisë kërkesat e energjisë për çdo hapësirë/zonë në ndërtesë sipas veprimtarisë që ndodh brenda saj. Aktivitetet e ndryshme mund të kenë temperatura, periudha operative dhe/ose nivele ndriçimi të ndryshme. Programi do të llogarisë kërkesat e energjisë për ngrohje dhe ftohje duke kryer një bilanc të energjisë bazuar në kushtet mesatare mujore të motit. Kjo do të kombinohet me informacionin rreth eficencës së sistemit në mënyrë që të përcaktohet konsumi i energjisë. Do të llogaritet edhe energjia e përdorur për ndriçim, ventilim dhe ujë të ngrohtë.

1.7 Të dhenat dhe burimet e informacionit

1. PKM do të sigurojë një modul të dhënash që do të shërbejnë si ndërmjetës për përdoruesin. Përdoruesi do të zgjedhë opsione nga të dhëna të disponueshme dhe do të vendosë gjithashtu vlera në mënyrë manuale.

2. Hapat e përfshira në procesin e futjes së të dhënave janë si në vijim:

   2.1. Përcakto konfiguracionin gjeometrik të zonave të ndryshme të ndërtesës (gjeometrikisht)

   2.2. Përcakto aktivitetet që zhvillohen në çdo zonë të ndërtesës në mënyrë që kushtet për secilën nga këto aktivitete në bazë të të dhënave në tabelen 2 të shtojcës 1 të VKM Nr. 537, datë 08.07.2020 *"Për Miratimin e Kërkesave Minimale të*

Performancës së Energjisë së Ndërtesave dhe të Elementëve të Ndërtesave". Kohëzgjatja e aktiviteteve do të vendoset në baze të vlerave të marra nga burimi zyrtar i të dhënave. Detaje lidhur me Sistemin e të dhënave për çdo aktivitet për Shqipërinë janë dhënë në Shtojcën A2.

2.3. Vendos zonat dhe komponentët ndërtimorë të ndërtesës, për çdo zonë të aktivitetit. Zonat duhet të përfshijnë informacion lidhur me komponentët e mbështjelljes së jashtme dhe me ndarjet e brëndshme të zonës në shqyrtim.

2.4. Përzgjdh nga një burim standart të dhënash një sërë të dhënash për kushtet klimaterike sipas vendodhjes së ndërtesës të dhëna në Aneksin 5.

2.5. Përkufizo dhe identifiko sistemin teknik tw NVKA (Ngrohjes, Ventilimit dhe Kondicionimit të Ajrit), sistemin e ngrohjes së ujit dhe të ndriçimit dhe sistemeve të tyre të kontrollit dhe përcakto cilës zonë të aktivitetit i shërbejnë ato.

2.6. Nëse është e mundur përcakto gjithashtu nëse ka ndonjë sistem të energjisë së rinovueshme në ndërtesë, siç janë sistemet fotovoltaike, sistemet diellore për ngrohjen e ujit, sistemet e kombinuara të prodhimit të energjisë termike dhe elektrike (CHP), etj.

3. Duke ndërvepruar me programin, përdoruesi do të ketë mundësinë që të ketë akses në të dhënat për detaje të standartizuara të ndertimeve dhe për të dhënat e performancës së pranueshme të ngrohjes, ventilimit dhe sistemit të kondicionimit. Këto të dhëna duhet të jenë të aksesueshme në mënyrë që përdoruesit të kenë mundësi që të ndryshojë disa parametra, duke vendosur të dhënat e tyre.

4. Përdoruesi do të ketë mundësinë që të pajisë programin me vlerën U dhe kapacitetin termik për elementët e ndërtesës, eficencat e sistemit NVKA, UNS dhe të dhënat për ndriçimin dhe kontrollet ose duke vendosur maunualisht vlerat e njohura ose duke përzgjedhur vlerat më të përshtatshme nga të dhënat në dispozicion.

5. Programi gjithashtu do të bëjë të mundur tërheqjen e informacionit nga disa të dhëna të kyçura të parametrave të aktivitetit dhe kushtet klimaterike. Këto të dhëna përkufizohen si "të pa ndryshueshme", sepse përdoruesi nuk eshte i aftë t'i ndryshojë këto të dhena, pasi duhet të jenë të njëjta për ndërtesa të ngjashme për të lejuar një krahasim të drejtë dhe korrekt.

1.8 Metodologjia e detajuar

Metodologjia e detajuar për të bërë llogaritë e performancës së energjisë është përshkruar më poshtë në Seksionin 2.

1.9 Të dhënat

Detaje të të dhënave që do të vendosen në përllogaritjet e përshkruara në Seksionin 4 si më poshtë.

2. Algoritmi i llogaritjeve

Standaradi i CEN PG N37 ofron një përshkrim të procedurës së llogaritjes për vlerësimin e performancës së energjisë së ndërtesës. Ai përmban një listë të standardeve europiane të cilat suportojnë procedurën e llogaritjes të përfshirë në këtë dokument (shiko pjesën 3). Disa pjesë të rëndësishme të përllogaritjes nuk janë trajtuar në mënyrë të plota nga këto standarde të CEN, si rrjedhojë kjo metodologji përcakton gjithashtu dhe metodologji të tjera të llogaritjes për:

- Sistem ndriçimi i rregulluar me sisteme kontrolli me nivel të ndryshme
- Prodhimin e ujit të ngrohtë

Metodologjia e llogaritjes për kërkesën për energji në sistemet e ngrohje-ftohjes, zbaton metodën e balances së ngrohjes mujore për zonat e ndertesës të përcaktuara në EN13790.

Struktura e procedurës kryesore së llogaritjes është permbledhur në tabelën 1.

Tabela 1 përmbledhje e standardeve të CEN për llogaritjet

1	Përcakton zonat e kondicionuara dhe të pakondicionuara (psh e ngrohur /e ftohtë ose jo) dhe ndan vendet në zona duke u bazuar te aktivitetet të cilat zhvillohen në to dhe sipas kushteve te nevojshme për secilën aktivitet.
2	Llogarit energjinë për ngrohjen dhe ftohjen për çdo kohë dhe çdo zonë të nevojshme për të mbajtur nivelet e predispozuara të komfortit në përputhje me Tabelën 2 të shtojcës 1 të VKM 537, datë 08.07.2020 dhe të kohëzgjatjes për periudhën e ngrohje/ ftohjes.
3	Kombinon rezultatet për kohëzgjatje dhe për zona të ndryshme, të cilat perdorin të njëjtin sistem ngrohje dhe ftohjeje dhe përllogarit energjinë e dërguar për çdo sistem përmes shpërndarjes së tyre brenda në ndërtesë.
4	Përllogarit për çdo zone energjinë e nevojshme për ventilim, ndriçim dhe për ujë të ngrohtë.
5	Kombinon rezultatet të të gjithë zonave dhe sistemeve në menyrë që të llogaritet totali për energjinë në të gjithë ndërtesën.

Pjesët në vijm përshkruajne këtë metodë më në detaje.

2.1 Metoda e përzgjedhur e llogaritjeve

Kjo metodologji është bazuar në një metodë të mire provuar, në të cilën llogaritja bazohet duke përdorur balancën e ngrohjes dhe të ftohjes në një cikël mujor. Në këtë metodë temperaturat e jashtme dhe të brendshme të ajrit supozohet të qëndrojnë konstante dhe regjimet dinamike të ndryshimeve afatshkurtra janë marë në konsideratë nga përdorimi i faktorëve të shfrytëzimit:

Për ngrohjen: Faktori i shfrytëzimit për burimet e brendshme dhe energjinë diellore merr në konsideratë faktin që vetëm një pjesë e burimeve të brendshme dhe një pjesë e energjisë diellore përdoren për të ulur kërkesat e energjisë dhe pjesa tjetër e nxehtësisë së mbetur rezulton në një rritje të padëshiruar të temperaturës së brendshme përtej temperaturës së përcaktuar (si nivel i komfortit) në perputhje me Tabelën 2 të shtojcës 1 të VKM 537/2020 për ngrohjen e hapësirave. Në këtë situate balanca e nxehtësisë, humbjet e burimeve të papërdorura të nxehtësisë kundra-balancohen nga fakti që ato neglizhohen edhe nëpërmjet transmetimit të rritur të nxehtësisë të pajisjeve të të ventilimit nga hapësira që do të rezultonte në një temperaturë të brendshme më të lartë (shiko Seksionin 2.1.12 për më shumë detaje).

Efekti i inercisë termike në rastin e furnizimit të vazhduar të nxehtësisë ose jo të vazhduar mund të konsiderohet duke rregulluar temperaturën në pikën e duhur ose korrigjimin e kërkesës së përllogaritur të nxehtësisë.

Për ftohjen: e kundërta me metodën e përdorur për ngrohje, faktori i shfrytëzimit për transmetimin e nxehtësisë me përcjellshmëri dhe transmetimin e nxehtësisë me ventilimin merr në konsideratë faktin që vetëm një pjesë e kësaj nxehtësie të transmetuar është përdorur për të zvogëluar nevojat e ftohjes. Pjesa më e madhe e "papërdorur" e nxehtësisë dhe transmetimi i nxehtësisë nëpërmjet ventilimit ndodhin gjatë periudhave të caktuara (psh gjatë natës) kur nuk ka efekt në kërkesën e ftohjes gjatë periudhave të tjera (psh gjatë ditës). Në këtë këndvështrim, balanca e nxehtësisë injoron transmetimin e nxehtësisë nëpërmjet ventilimit. Kjo është kompensuar nga fakti që ajo gjithashtu injoron faktin që në një pikë të caktuar ftohja nuk është arritur gjatë gjjithë kohës. Ky formulim tregon qartë se si transmetimi i energjisë kontribon në zvoglimin e energjisë së ftohjes të nevojshme në një ndërtesë (Shiko seksionin 3.1.13 për me shumë detaje)

Efekti i inercisë termike në rastin e furnizimit të vazhduar ose të një sistemi jo të vazhduar mund të konsiderohet duke rregulluar temperarturën në pikën e caktuar specifike, ose duke rregulluar kërkesën e përllogaritur të energjisë të ftohjes/ngrohjes.

2.1.1 Procedura e llogaritjes së kërkesave të energjisë për ngrohjen dhe ftohjen e hapësirave

Procedura e llogaritjes për kërkesat e energjisë për nevojat vjetore të ngrohjes dhe ftohjes të një ndërtese ose të një zone të ndërtesës është përmbledhur më poshtë për çdo zonë të ndërtesës dhe për çdo periudhë të llogaritjes: Procedurat llogaritëse për madhësinë e kërkuar të energjisë:

- Llogaritjet e humbjeve të nxehtësisë përmes transmetimit (Q_{tr})
- Llogaritjet e humbjeve të nxehtësisë përmes ventilimit (Q_v)
- Llogaritjet e fitimeve të nxehtësisë nga burime e brendëshme të nxehtësisë dhe rrezatimit diellor
- Llogaritjet e parametrave dinamik (faktorëve të shfrytëzimit për ngrohje dhe ftohje) të cilat janë të llogaritura në paragrafin 2.1.2 dhe 2.1.3 më poshtë.

2.1.2 Energjia e nevojshme për ngrohje

Energjia e nevojshme për ngrohjen e secilës zonë të ndërtesës dhe për çdo periudhë llogaritëse (mujore) është llogaritur si vijon:

$$Q_{NG} = (Q_{tr} + Q_V) - \eta_{SH} Q_{SH} = Q_{T,Ng} - \eta_{SH} Q_{SH}$$

Ku: $Q_{NG} \geq 0$ dhe per çdo zonë të ndërtesës dhe për çdo muaj:

Q_{NG} - nevoja për enegjinë për ngrohje për një zonë të ndërtesës në (kWh);

$Q_{T,Ng}$ - është totali i humbjeve të nxehtësisë sipas mënyrës së operimit të sistemit përkatës në (kWh);

Q_{SH} - janë burimet totale të nxehtësisë (fitimet) (kWh);

η_{SH} - është faktori i shfrytëzimit të nxehtësisë së përftuar. Ky është një parametër pa njësi dhe shprehet nëpërmjet raportit të fitimeve të nxehtësisë dhe humbjeve të saj dhe inercisë së nxehtësisë dhe përfaqëson pjesën e dobishme të fitimeve të nxehtësisë.

Nëse është e aplikueshme përdoren edhe korrigimet e ditëve që janë pushim dhe nuk përdoren për ndërtesa të cilat janë aplikuar bazuar në programin e përdorimit të përshkruar në bazën e të dhënave sipas aktiviteteve në ndërtesa (për detaje shiko Aneksin A2).

2.1.3 Energjia e nevojshme për ftohje

Energjia e nevojshme për ftohjen e çdo zone të ndërtesës dhe për çdo periudhë të llogaritjes (mujore) llogariten si vijon:

$$Q_{FT} = Q_{SHf} - \eta_{SHf} Q_{T,Ft} = Q_{SHf} - \eta_{SHf} (Q_{tr} + Q_V)$$

Ku $Q_{FT} \geq 0$, (për çdo zonë të ndërtesës dhe për çdo muaj)

Q_{FT} - kërkesa energjetike për ftohjen në një zonë të ndërtesës në (kWh);

$Q_{T,Ft}$ - është totali i transmetimit të nxehtesise (humbjet) për operimin e sistemit përkatës për të garantuar ftohjen të shprehur në (kWh);

Q_{SHf} - janë burimet totale të nxehtësisë (përfitimet) për operimin e sistemit përkatës për të garantuar ftohjen të shprehur në (kWh);

η_{SHf} - është faktori i shfrytezimit të nxehtësisë së përftuar. Ky është një parametër pa njësi dhe shprehet nëpermjet raportit të perfitimeve te nxehtesise dhe humbjeve te saj dhe inercise se nxehtësisë dhe përfaqeson pjesën e dobishme të fitimeve të nxehtësisë

Nëse është e aplikueshme përdoren edhe korrigimet e ditëve që janë pushim dhe nuk përdoren për ndërtesa të cilat janë aplikuar bazuar në programin e përdorimit të pershkruar në Të dhënat e Aktivitetit.

2.1.4 Totali i nxehtësisë të transmetuar (humbjet me transmetim) dhe i burimeve të brendshme të nxehtësisë (fitimeve)

Totali i energjisë të trasmetuar është përcaktuar si vijon:

$$Q_{ToT} = Q_{tr} + Q_V$$

Ku për çdo zonë të ndërtesës dhe për çdo muaj

Q_{ToT} - është totali i nxehtësisë të transmetuar në (kWh);

Q_{tr} - është totali i nxehtësisë të transmetuar me transmetim (kWh);

Q_V - eshte totali i nxehtesise te transmetuar permes ventilimit ne (kWh);

Burimet totale të nxehtësisë, Q_{SH}, për një zonë të ndërtesës në një periudhë të caktuar jepen si vijon:

$$Q_{SH} = \left(Q_{SHn} + Q_{SHf}\right)_{br} + Q_D = (Q_{SH})_{br} + (Q_D)_j$$

Ku për çdo zonë të ndërtesës dhe për çdo periudhë të llogaritjes:

Q_{SH} - janë burimet totale të nxehtësisë në (kWh);

$Q_{SH,br}$ - është shuma e fitimeve të brendshme të nxehtësisë / humbjet në një periudhë të caktuar kohore në (kWh);

$Q_{D,j}$ - është shuma e nxehtësisë së përftuar nga energjia diellore në një periudhë të caktuar kohe në (kWh).

Madhësia totale e nxehtësisë transmetuar përmes ventilimit Q_V përllogaritet për çdo muaj dhe për çdo zonë z të përshkruar në seksionin 2.2

2.1.5 Humbjet totale të nxehtësisë me transmetim

Humbjet totale të nxehtësisë me transmetim llogariten për çdo muaj dhe për çdo zonë, z, si:

$$Q_{tr} = \sum_k \left\{K_{m,i} * (t_{br} - t_{m,j})\right\} * \tau * f$$

Kur (për çdo zonë të ndërtesës, k, dhe për çdo muaj)

Q_{tr} - humbjet totale të nxehtësisë me transmetim (kWh);

$K_{m,i}$ - është koefiçenti i humbjeve të nxehtësisë me transmetim, i murit "m" në mjedisin ngjitur "j", nga pjesa e brendshme e zonës ose zonave me temperaturë $t_{m,i}$, në W/K;

t_{br} - është temperatura e brendshme e zonës së ndërtesës në grade Celcius; marrë nga baza e të dhënave sipas aktiviteteve në ndërtesa në hyrje (Vlerë e përcaktuar);

$t_{m,j}$ - është temperatura e jashtme (temperatura mesatare e muajit marrë nga të dhënat klimatike orare për vëndndodhjen e konsideruar) e murit *m*, në gradë Celcius; marrë nga databaza me të dhënat klimatike të jashtme;

τ - është periudha llogaritëse, dmth numri i oreve në muaj;

f - është faktori i konvertimit nga (Wh) në (kWh).

Në fund merret shuma për të gjitha pjesët e ndërtesës që ndan mjedisin e brendshëm nga mjedisi i jashtëm. Humbjet e nxehtësisë ose një pjesë e humbjeve të nxehtësisë mund të jenë me shenjë negative gjatë një periudhe të caktuar kohe.

2.1.6 Koeficientet e humbjeve të nxehtësisë me transmetim

Vlerat për koeficentët e humbjeve të nxehtësisë me transmetim, $K_{m,i}$, për një element ***m*** llogaritet sipas standardit EN ISO 13789:2005, duke konsideruar standardin për elementë specifik si dritaret (EN ISO 10077-1:2004), muret dhe çatitë (EN ISO 6946:2005), dhe dyshemetë (EN ISO 13370:2005). Vlera e temperaturës $t_{m,j}$ është temperatura e mjedisit të jashtëm për elementin *k*, për rastet e mëposhtme:

- Transmetimin e nxehtësisë drejt mjedisit të jashtëm
- Transmetimin e nxehtësisë drejt mjediseve ngjitur të pakondicionuara
- Transmetimin e nxehtësisë drejt tokës.

Koefiçentët e transmetimit të nxehtësisë të elementëve të ndërtesës të cilët ndajnë mjedisin që kondicionohet me mjedisin e jashtëm llogariten si: $K_{ToT} = \sum_i F_i K_i * \sum_k l_k \psi_k$

ku

K_{ToT} - është koefiçenti i humbjeve të nxehtësisë me transmetim i mureve të jashtme, në W/K ;

F_i - është sipërfaqja e elementit *i* e mureve të jashtme të ndërtesës në m^2, (dimensionet e dritareve dhe dyerve llogariten si dimensione të hapjeve në mur);

K_i - është koefiçenti i transmetimit të nxehtësisë (Vlera-U[3]) i elementit *i*, i mureve të jashtme të ndërtesës në $W/(m^2 \cdot K)$;

---

[3] Vlera – K (Vlera - U) për dyshementë e katit përdhe duhet të adaptohet në mënyrë të tillë për zarfin e ndërtesës që paraqet humbje nxehtësie kur është në kontakt me tokën (si funksion i perimetrit të raportuar për sipërfaqen e dyshemesë dhe rezistencës termike të dyshemesë) sipas instruksioneve të përcaktuara në seksionin 3.5. 2 të "Direktives CIBSE - Vol. A - 2007" (dhe standardit ISO 13370: 2007 – mbi performancën termike të ndërtesave – transmetimi i nxehtësisë nëpërmjet tokës - metoda llogaritëse).

l_k - është gjatësia lineare e urës termike k, n; m;

Ψ_k - është koefiçenti linear i transmetimit të nxehtësisë i urës termike k, në W/(m·K).

2.1.7 Fitimet e Nxehtësisë

Fitimet e nxehtësisë vijnë nga burimet e brendshme të nxehtësisë në ndërtesë Q_{SHbr} që mund të jenë banorët, ndriçimi, pajisjet, si dhe energjia diellore që vjen nëpërmjet sipërfaqeve transparente, $Q_{Diell,t}$ dhe nëpërmjet strukturave opake (të errëta) $Q_{Diell,jt}$.

Përfitimet e nxehtësisë llogariten si:

$Q_{SH} = Q_{br} + Q_{Diell,t} + Q_{Diell,jt}$

Ku:

Q_{SH} - janë fitimet e nxehtësisë mujore, në (kWh);

Q_{br} - janë fitimet e nxehtësisë nga burimet e brendshme, në (kWh);

$Q_{Diell,t}$ - fitimet e nxehtësisë diellore nga sip. transparente dhe muret e jashtme ,në (kWh);

$Q_{Diell,jt}$ - janë fitimet e nxehtësisë diellore nga strukturat opake, në (kWh).

2.1.8 Burimet e brendshme të nxehtësisë

Burimet e brendshme të nxehtësisë përbëhen nga të gjitha llojet e energjise/nxehtësisë të gjeneruar në mjedisin e kondicionuar që ndikojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë në energjinë e nevojshme për ngrohjen apo ftohjen e një zonë të caktuar, përveç energjisë së përdorur në mënyrë direkte për ngrohje, freskim dhe përgatitjen e ujit të ngrohtë.

Përfitimet e nxehtësisë **nga burimet e brendshme** llogariten si :

$Q_{br} = Q_{br,nj} + Q_{br,paisj.} + Q_{br,ndrç}$

Ku:

Q_{br} - është shuma e fitimeve të nxehtësisë të gjeneruar nga burimet e brendshme të nxehtësisë, në (kWh);

$Q_{br,nj}$ - është përfitimi i nxehtësisë i gjeneruar nga banorët, në (kWh); i përcaktuar nga tabela 2 e shtojcës 1 të VKM 537 datë 08.07.2020, sipas llojit të ndërtesës dhe tipit të aktivitetit për zonën e konsideruar.

$Q_{br,paisj}$ - është përfitimi i nxehtësisë i gjeneruar nga pajisjet, në (kWh); i përcaktuar nga baza e të dhënave sipas aktiviteteve në ndërtesa sipas llojit të ndërtesës dhe tipit të aktivitetit për zonën e konsideruar.

$Q_{br,ndrç}$ - është përfitimi i nxehtësisë i gjeneruar nga ndriçimi, në (kWh).

Nxehtësia e gjeneruar nga ndriçimi përcaktohet përmes llogaritjes së energjisë së konsumuar për ndriçim, për zonën e konsideruar.

Vlera e nxehtësisë së gjeneruar nga ndriçimi, $Q_{br,ndrç}$, llogaritet si:

$Q_{br,ndrç} = W_{ndrç} * F * f_{ndrç,SH}$

Ku:

$Q_{br,ndrç}$ - është përfitimi i nxehtësisë së gjeneruar nga ndriçimi, në (kWh);

$W_{ndrç}$ - është konsumi i energjisë nga ndriçimi, në kWh/m^2, siç përcaktohet në Seksionin 2.4;

F - është sipërfaqja e zonës, në m^2;

$f_{ndrç,SH}$ - është një faktor i cili varet nëse mjedisi ka nxjerrës ajri të inkorporuar në ndriçuesit fiks (me ventilator) në këtë zonë. Ai ka një vlerë 0.9 nëse ndriçimi është i shoqëruar me nxjerrës ajri dhe 1 nëse nuk është i shoqëruar me nxjerrës ajri në këtë zone.

2.1.9 Fitimet e nxehtësisë diellore përmes strukturave transparente

Fitimet e nxehtësisë diellore mujore përmes strukturave transparente të ndërtesës në muret e jashtme përcaktohet si:

$$Q_{Diell,t} = \sum_{j} \left(q_{diell,muaj} * f_{hije,j} * f_{diellzim,j} * g_j * \left(1.0 - f_f\right) * F_j\right)$$

Ku:

$Q_{Diell,t}$ janë përfitimet e nxehtësisë diellore nëpërmjet strukturave transparente, në (kWh);

$q_{diell,muaj}$ është sasia e rrezatimit diellor mujor në sipërfaqe horizontale në (kWh/m2, për kohën lokale të konsideruar dhe orientimin e j dritareve;

$f_{hije,j}$ është faktori i korrigjimit të hijëzimit diellor për dritaren j;

$f_{dielezim}$ është faktori i reduktimit për ekspozimin ndaj diellit në lëvizje për dritaren j, siç llogaritet në Seksionin 2.1.10 (llogaritja e faktorit të reduktimit për ekspozimin diellor);

g_j - është energjia diellore totale e gjeneruar për dritaren j;

F_j - është sipërfaqja e dritares j, në m^2, përfshirë kornizën;

f_f - është vlera e llogaritur e faktorit kornizë (pjesa e sipërfaqes së dritares të zënë nga korniza), dmth, (1.0 - f_f) = pjesën e sipërfaqes së xhamit të dritares

Faktori i jashtëm i korrigjimit të mbrojtjes nga dielli varion nga 0 në 1 dhe përfaqëson zvogëlimin e sasisë së rrezatimit diellor për shkak të mbrojtjes së përhershme nga dielli i zonës së konsideruar, si rezultat i shtrirjes së ndërtesës dhe tendave vertikale.

Faktori korrigjues i hijëzimit të dritës llogaritet si :

$$F_{hijej} = F_o \, x \, F_f$$

ku

F_o është faktori i korrigjimit të pjesshëm të mbrojtjes së diellit për hijezues horizontal;

F_f është faktori i korrigjimit të pjesshëm të mbrojtjes së diellit për hijëzues vertikal

Mbrojtja nga hijëzuesit horizontale (kanopet) dhe vertikale varet nga këndi, orientimi, gjerësia gjeografike dhe klima lokale. Faktorët e korrigjimit sezonal për gjerësitë gjeografike tipike janë dhënë në Tabelën 2 dhe në Tabelën 3.

Figura 1 Grilat dhe perdet vertikale: a) pamja vertikale b) dhe pamja horiontale



Shënim: Për qellime të kesaj llogaritje, kendet α dhe β, të treguara me vija me pika janë treguar në Figuren 1 dhe tregohen midis planit të dritares dhe grilave dhe perdeve vertikale.

Tabela 6 Faktorët pjesor të korrigjimit për mbrojtëset nga Dielli (grilat), Fo

Kendi i hapjes	45° N. lat			55° N. lat			65° N. lat		
	S	E/W	N	S	E/W	N	S	E/W	N
0°	1,00	1,00	1,00	1,00	1,00	1,00	1,00	1,00	1,00
30°	0,90	0,89	0,91	0,93	0,91	0,91	0,95	0,92	0,90
45°	0,74	0,76	0,80	0,80	0,79	0,80	0,85	0,81	0,80
65°	0,50	0,58	0,66	0,60	0,61	0,65	0,66	0,65	0,66

Tabela 7 Faktorët pjesor të korrigjimit për mbrojtëset nga Dielli (perdet vertikale), Ff

Kendi i hapjes	45° N. lat			55° N. lat			65° N. lat		
	S	E/W	N	S	E/W	N	S	E/W	N
0°	1,00	1,00	1,00	1,00	1,00	1,00	1,00	1,00	1,00
30°	0,94	0,92	1,00	0,94	0,91	0,99	0,94	0,90	0,98
45°	0,84	0,84	1,00	0,86	0,79	0,99	0,85	0,82	0,98
65°	0,72	0,75	1,00	0,74	0,61	0,99	0,73	0,73	0,98

Nëse hijëzuesi i projektuar për mbrojtje nga drita është në fakt një 'brise soleil' atëherë faktori zbatohet për llogaritjen vetëm për muajt e verës (maj deri në shtator). Për qëllime llogaritjeje, një "brise soleil" përfshin shirita, grila, vrima, etj, në vend të një hijezimi solid.

Transmetueshmëria totale e energjisë diellore, g, është raporti kohor mesatar i energjisë që kalon përmes elementëve jo të hijezuara dhe rrezatimit total të rënë në të. Për dritaret dhe elementët e tjerë të lustruara me ilustrim jo-shpërndarës, ISO 9050 ose EN 410 ofrojnë një metodë për marrjen e transmetimit të rrezatimit diellor në kënd 90 gradë me sipërfaqen e lëmuar. Kjo vlerë e gjenerimit pingul, $g_{\perp}$, është pak më e lartë se transmetimi mesatar i kohës dhe është përdorur faktori i korrigjimit, F_w:

$$g = F_w g_{\perp}$$

Ky faktor F_w është marrë nga Tabela 4 si një vlerë që korrespondon me orientimin e sipërfaqes së xhamit transparent dhe pjerrësinë e saj nga vija horizontale.

Tabela 8 Faktori korrektues F_W per vlerat g per siperfaqet e qelqta jo te tejdukshme

Kendi i pjerresise	Orientimi								
	S	SE	E	NE	N	NW	W	SW	H
0º	0.87	0.87	0.87	0.87	0.87	0.87	0.87	0.87	0.87
10º	0.87	0.87	0.87	0.87	0.87	0.87	0.87	0.87	0.87
15º	1.28	1.27	1.35	1.52	1.68	1.52	1.36	1.29	0.87
20º	1.28	1.27	1.35	1.52	1.68	1.52	1.36	1.29	0.87
25º	1.28	1.27	1.34	1.50	1.64	1.49	1.35	1.29	0.87
30º	1.28	1.27	1.32	1.45	1.55	1.44	1.33	1.28	0.87
35º	1.29	1.26	1.31	1.40	1.46	1.39	1.31	1.28	0.87
40º	1.29	1.26	1.29	1.35	1.38	1.34	1.29	1.27	0.87
45º	1.29	1.26	1.27	1.30	1.29	1.29	1.27	1.27	0.87
50º	1.26	1.23	1.24	1.25	1.24	1.25	1.23	1.24	0.87
55º	1.23	1.20	1.20	1.21	1.19	1.20	1.20	1.21	0.87

Kendi i pjerresise	Orientimi								
	S	SE	E	NE	N	NW	W	SW	H
60º	1.20	1.17	1.17	1.16	1.14	1.16	1.16	1.18	0.87
65º	1.17	1.14	1.14	1.11	1.09	1.11	1.13	1.15	0.87
70º	1.12	1.11	1.10	1.07	1.04	1.07	1.09	1.10	0.87
90º	0.89	0.91	0.91	0.89	0.88	0.88	0.90	0.90	0.87

2.1.10 Llogaritja e faktorit reduktues te diellit nga hijezimi

Duke përdorur metodologjinë e përshkruar në EN 13363-1:2003+A1:2007 dhe EN ISO 13790:2008, faktori i reduktimit për përfitimin diellor për shkak të hijezimit të lëvizshëm, $f_{xham;j}$, për dritaren j është marrë duke përdorur ekuacionin e mëposhtëm:

$$f_{diellezim} = \frac{\left[\left(1 - f_{exp}\right) * g_{xham} + \left(f_{exp} * g_{xham+hije}\right)\right]}{g_{xham}}$$

Ku:

g_{xham} - është depërtimi i rrezatimit diellor kur mbrojtja nga rrezatimi diellor nuk është aktive (dmth. eshte vetëm xhami);

$g_{xham+hije}$ - është depërtimi i përgjithshëm i rrezatimit diellor përmes dritares, kur është në përdorim mbrojtja nga rrezatimi diellor (që do të thotë xhami plus hijezimi për mbrojtje nga dielli);

f_{exp} - është koha gjatë së cilës hijëzimi është në përdorim p.sh. si një funksion i intensitetit të rrezatimit diellor.

2.1.11 Llogaritja e fraksionit të ponderuar të kohës së ponderimit të hijëzimit për mbrojtjen nga dielli

Fraksioni kohor i ponderuar gjatë të cilit pajisja hijëzuese punon ose nuk punon, varet nga klima, stina dhe muaji. Për qëllimet e kësaj përllogaritjeje, për secilën klimë, duhet të prodhohet një tabelë në përputhje me ISO 13790, me të dhëna për $f_{sh,with}$ për orientime të ndryshme të dritareve. Vlerat duhet të jepen si shumë e orëve me rrezatim diellor për të gjithë muajin, e orëve me intesitet më të lartë se 300 W/m^2, $I_{sol>300}$, pjestuar me shumën e orëve me rrezatim diellor për të gjithë muajin respektiv, I_{sol}, dmth., $f_{sh,with} = \frac{I_{sol>300}}{I_{sol}}$

2.1.12 Llogaritja e transmetimit total të energjisë diellore përmes dritares kur hijëzimi ose perdja mbrojtëse janë aktive

Kjo metodë zbatohet për të gjitha llojet e pajisjeve të mbrojtjes diellore paralelisht me sipërfaqen transparente, të tilla si grila, veneciane ose rulon. Pozicionimi i pajisjes mbrojtëse diellore mund të jetë në anën e brendshme ose të jashtme. Supozohet se për pajisjet e jashtme të mbrojtjes diellore, hapësira ndërmjet pajisjeve mbrojtëse diellore dhe xhamit është jo e ventiluar dhe për pajisjet e brendshme të mbrojtjes diellore kjo hapësirë është e ventiluar. Grilat ose grilat veneciane janë supozuar të përshtaten në mënyrë që të mos ketë depërtim të drejtpërdrejtë të rrezatimit diellor.
Kjo metodë bazohet në rastin e një rrezatimi rënës normal dhe është e zbatueshme kur transmetimi total i energjisë diellore i sipërfaqes transparente është ndërmjet 0.15 dhe 0.85 dhe transmetimi diellor i pajisjeve të mbrojtjes diellore është ndërmjet 0 dhe 0.5 dhe reflektimi diellor i pajisjeve të mbrojtjes diellore është ndërmjet 0.1 dhe 0.8.
Transmetueshmëria totale rezultante e energjisë diellore përdoret vetëm për llogaritjen e faktorit të reduktimit të mbrojtjes nga dielli për hijezuesit e lëvizshmëm të mbrojtjes diellore, f_{sun}. Si e tillë, ajo nuk është menduar të përdoret për llogaritjen e përfitimeve diellore ose të kritereve të konfortit termik.

Pajisjet e jashtme të mbrojtjes diellore

Transmetueshmëria totale e energjisë diellore për sipërfaqet transparente dhe një pajisje hijëzimi të jashtme për mbrojtje diellore, g_{gl+sh} jepet si:

$$g_{gl+sh} = \left(\tau_{e,B} \times g_{gl}\right) + \left(\alpha_{e,B} \times \frac{G}{G_2}\right) + \left(\tau_{e,B} \times (1 - g_{gl}) \times \frac{G}{G_1}\right)$$

ku:

$\tau_{e,B}$ - është faktori i transmetueshmerisë diellore për pajisjen e mbrojtjes nga dielli vlerat e të cilit janë dhënë në Tabela 9;

g_{gl} - është transmetueshmëria diellore e dritares kur grilat nuk janë përdorur (dmth., do të kemi vetëm xhamat drejtpërdrejt);

$\alpha_{e,B}$ - është absorbimi i pajisjes së mbrojtjes diellore e cila llogaritet si: $\alpha_{e,B} = 1 - \tau_{e,B} - \rho_{e,B}$

ku $\rho_{e,B}$ - është reflektueshmëria diellore e pajisjes së mbrojtjes diellore, e cila merret në Tabela 9 për pajisjet tipike të mbrojtjes diellore;

$G_1 = 5$ W/m^{2}K;

$G_2 = 10$ W/m^{2}K;

$$G = \frac{1}{\left(\frac{1}{U_g} + \frac{1}{G_1} + \frac{1}{G_2}\right)}$$

ku U_g është koeficenti i transmetimit të nxehtësisë për dritaren në W/m^{2}K.

Figura 2 Karakteristikat e e pozicionit të pajisjes të mbrojtjes diellore[4]



1-ana e jashtme
2-mbrojtja diellore
3-hapesire e pa ventiluar
4-xhamat
5-hapësira e brendëshme

Tabela 9 Të dhënat për pajisjen e mbrojtjes nga dielli

Transmetueshmërise diellore $\tau_{h,p}$		Reflektueshmëria diellore $\rho_{h,p}$			
		bardhë	**pastel**	**errët**	**zezë**
Opake	0.0	0.7	0.5	0.3	0.1
Transmetueshmëri mesatare	0.2	0.6	0.4	0.2	0.1
Transmetueshmëri e lartë	0.4	0.4	0.3	0.2	0.1

Pajisjet e brendshme të mbrojtjes diellore

Transmetueshmëria totale e energjisë diellore për sipërfaqet transparente dhe një pajisje hijëzimi të brendshme për mbrojtje diellore, g_{gl+sh} jepet si:

$$g_{gl+sh} = g_{gl} \times \left(1 - (g_{gl} \times \rho_{e,B}) - \left(\alpha_{e,B} \times \frac{G}{G_3}\right)\right)$$

[4] Pjese e marre nga EN 13363-1:2003+A1:2007 – Pajisje e mbrojtjes diellore *kombinuar me xhamat - Llogaritja e percjellshmerise dhe ndricimit diellor - Pjesa 1: Metodat e thjeshte.*

ku:

g_{gl} është transmetimi total i energjisë diellore nëpërmjet dritares kur hijezuesi diellor nuk është në përdorim (dmth. vetëm sipërfaqe xhami);

$\rho_{e,B}$ është reflektimi diellor i pajisjes mbrojtëse diellore, e cila është marrë nga Tabela 5 për pajisjet tipike të mbrojtjes diellore;;

$\alpha_{e,B}$ është thithja e pajisjes mbrojtëse diellore e cila llogaritet si $\alpha_{e,B} = 1 - \tau_{e,B} - \rho_{e,B}$

ku $\tau_{e,B}$ është transmetimi diellor i pajisjes mbrojtëse diellore, i cili është marrë nga Tabela 5 për pajisjet tipike të mbrojtjes diellore;

$G_3 = 30$ W/m^{2}K;

$$G = \frac{1}{\left(\frac{1}{U_g} + \frac{1}{G_3}\right)}$$

ku U_g është koeficienti i transmetimit termik të dritares, në W/m^{2}K.



Figura 3 Pozicionet tipike të pajisjeve hijëzuese të mbrojtjes diellore

1- ana e jashtme
2- xhamat
3- hapesirë me ventilim
4- mbrojtja diellore
5- hapësira e brendëshme

Fitimet e nxehtësisë diellore përmes konstruksioneve opake

Fitimet mujore të nxehtësisë diellore përmes konstruksioneve opake të mureve të jashtme përcaktohet si:

$$Q_{sun,nt} = \sum_j \left(f_{ab} \times q_{sun,j} \times U_{c,j} \times A_{c,j} \right)$$

ku:

$Q_{sun,nt}$ janë përfitimet e nxehtësisë diellore përmes konstruksioneve opake, në MJ;

f_{ab} është faktori 0.045, i cili përbëhet nga një vlerë e supozuar prej 0,9 për koeficientin absorbues pa dimension për rrezatimin diellor në konstruksionet opake shumëzuar me rezistencën sipërfaqsore të jashtme e cila merret 0.05 m^2K/W.

$q_{sun,j}$ është sasia e rrezatimit diellor në muaj në sipërfaqe horizontale në MJ/m2, për kushtet klimatike në vendndodhjen e konsideruar dhe orientimin e pjesës së ndërtimit *j*;

$U_{c,j}$ është koefiçenti i transmetimi termik i pjesës së ndërtimit *j*; në W/m^2K;

$A_{c,j}$ është sipërfaqja e pjesës së ndërtimit *j*, në m^2.

2.1.13 Faktori i shfrytëzimit të përfitimit të nxehtësisë

Faktori i shfrytëzimit të përfitimit të nxehtësisë tregon aftësinë e ndërtesës për të shfrytëzuar nxehtësinë diellore dhe ngrohjen e brendshme në mënyrë të tillë që kjo të çojë në një reduktim të kërkesës për ngrohje që pa këto burime do të duhej të furnizoheshin nga instalimi i ngrohjes. Faktori i shfrytëzimit të përfitimit të nxehtësisë për ngrohje, η_H është një funksion i raportit të përfitim/humbje, γ_H, dhe një parametri numerik, a_H, që varet nga inercia e ndërtimit, sipas ekuacionit të mëposhtëm:

Nëse $\gamma_N > 0$ dhe $\gamma_N \neq 1$ $$\eta_{GH} = \frac{1-\gamma_N^{a_N}}{1-\gamma_N^{a_N+1}}$$

Nëse $\gamma_N = 1$ $$\eta_{GH} = \frac{\alpha_N}{\alpha_N+1}$$

Nëse $\gamma_N < 1$ $$\eta_{GH} = \frac{1}{\gamma_N}$$

me

$$\gamma_H = \frac{Q_{G,H}}{Q_{L,H}}$$

ku (për çdo muaj dhe për çdo zonë të ndërtesës në shqyrtim)

η_{GH} eshte faktori i përdorimit tew energjiswe nga pwerfitimet e brendshme për ngrohje;

γ_H është raporti humbje/fitim jo-dimensional për moden e ngrohjes;

$Q_{L,H}$ janë humbjet totale të nxehtësisë për menyrën e ngrohjes, në MJ;

$Q_{G,H}$ janë fitimet totale të nxehtësisë për menyrën e ngrohjes në MJ;

a_H është një parameter numerik pa dimensione, në varësi të kohës konstante, τ_H, përkufizuar nga:

$$a_H = a_{0,H} + \frac{\tau_H}{\tau_{0,H}}$$

Ku:

$a_{0,H}$ është një parametër numerik referent pa njësi/dimension, i përcaktuar si;

τ_H është konstante kohore për ngrohjen e zonës së ndërtimit në orë e përcaktuar sipas Seksionit 3.1.14;

$\tau_{0,H}$ është një konstante kohore referente dhe jepet në Tabela 6 në orë.

Tabela 10 Vlerat e parametrit numerik $a_{0,H}$ dhe konstantes kohore referente per ngrohje sipas metodës mujore të llogaritjes

$a_{0,H}$	$\tau_{0,H}$
1.0	15

Faktori i shfrytëzimit të përfitimit të nxehtësisë është përcaktuar në mënyrë të pavarur nga karakteristikat e sistemit të ngrohjes duke marrë kontroll të përsosur të temperaturës dhe fleksibilitet të lartë. Një sistem ngrohje që reagon ngadalë dhe një sistem kontrolli jo fort i mirë mund të ndikojë ndjeshëm në përdorimin e fitimeve të nxehtësisë.

2.1.14 Faktori i shfrytëzimit të humbjeve në ftohje

Faktori i shfrytëzimit të humbjeve në ftohje, η_C, është funksion i raportit humbje/përfitim, λ_C, dhe një parametri numerik, a_C, që varet nga inercia termike e ndërtesës, sipas ekuacionit të mëposhtëm:

if $\lambda_C > 0$ and $\lambda_C \neq 1$: $$\eta_{L,C} = \frac{1-\lambda_C^{a_C}}{1-\lambda_C^{a_C+1}}$$

if $\lambda_C = 1$: $$\eta_{L,C} = \frac{a_C}{a_C+1}$$

if $\lambda_C < 0$: $$\eta_{L,C} = 1$$

me

$$\lambda_C = \frac{Q_{L,C}}{Q_{G,C}}$$

ku

$\eta_{L,C}$ është faktori i shfrytëzimit pa dimension për humbjet e nxehtësisë;

λ_C është raporti humbje/fitim pa dimension, në ftohje ;

$Q_{L,C}$ janë humbjet totale të nxehtësisë në ftohje, në MJ;

QG,C janë fitimet totale të nxehtësisë në ftohje, në MJ;

a_C është një parametër numerik konstant pa njësi, në varësi të kohës, τ_C, përkufizuar nga:

$$a_C = a_{0,C} + \frac{\tau_C}{\tau_{0,C}}$$

ku:

$a_{0,C}$ është një parameter referent numerik pa dimension, i përcaktuar sipas Tabela 11;

τ_C është konstantja kohore për ftohjen e zonës së ndërtesës, në orë; të përcaktuara sipas Seksionit 0.

$\tau_{0,C}$ është një konstante kohore referente, nga Tabela 11, në orë.

Tabela 11 Vlerat parametër parametrit numerik $a_{0,H}$ dhe konstante kohore $\tau_{0,H}$ per nevojat ftohëse për metodën mujore të llogaritjes të nevojave energjetike

$a_{0,C}$	$\tau_{0,C}$
1.0	15

Faktori i shfrytëzimit të humbjeve përcaktohet në mënyrë të pavarur nga karakteristikat e sistemit të ftohjes duke konsideruar një kontroll të përsosur të temperaturës dhe fleksibilitet të lartë. Një sistem ftohje që reagon ngadalë dhe një sistem kontrolli jo fort i mirë mund të ndikojë ndjeshëm në përdorimin e humbjeve.

2.1.15 Konstantja kohore e ndërtesës në funksion të mënyres së ngrohjes dhe të ftohjes

Konstantja kohore e ndërtesës për ngrohje, τ_H, karakterizon inercinë termike të brendshme të hapësirës së ngrohur gjatë periudhës së ngrohjes. Ajo llogaritet si:

$$\tau_H = \frac{C_m / 3{,}6}{H_{L,H}}$$

ku

τ_H është konstantja kohore e zonës së ndërtesës për ngrohje, në orë;

C_m është kapaciteti termik efektiv i zonës së ndërtesës, në kJ/K, i përcaktuar sipas përkufizimit më poshtë (Kapaciteti termik efektiv i zonës së ndërtesës);

$H_{L,H}$ është koefiçenti i humbjeve të nxehtësisë për zonën e ndërtesës për ngrohje, në W/K.

Faktori 3.6 konverton kapacitetin termik efektiv nga kJ në Wh.

Në mënyrë të ngjashme, konstantja kohore e ndërtesës për ftohje, τ_C, karakterizon inercinë termike të brendshme të hapësirës së ftohur gjatë periudhës së ftohjes. Ajo llogaritet si:

$$\tau_C = \frac{C_m / 3{,}6}{H_C}$$

ku

τ_C është konstantja kohore e ndërtesës ose zonës së ndërtesës për ftohje, në orë;

C_m është kapaciteti termik efektiv i zonës së ndërtesës, në kJ/K, i përcaktuar sipas përkufizimit më poshtë (Kapaciteti termik efektiv i zonës së ndërtesës);

H_C është koefiçenti i humbjeve të nxehtësisë për zonën e ndërtesës për ftohje, në W/K;

Faktori 3.6 konverton kapacitetin termik efektiv nga kJ ne Wh.

2.1.16 Kapaciteti termik efektiv i zonës së ndërtesës

Kapaciteti termik efektiv i zonës së ndërtesës, C_m, llogaritet duke mbledhur kapacitetet termike të të gjithë elementëve të ndërtesës në kontakt termik direkt me ajrin e brendshëm të zonës së konsideruar:

$$C_m = \sum \chi_j A_j = \sum_j \sum_i \rho_{ij} c_{ij} d_{ij} A_j$$

ku:

C_m është kapaciteti termik efektiv, në kJ/K;

χ_j është kapaciteti termik i brendshëm për sipërfaqe të elementit të ndërtesës j, në kJ/(m^2·K);

A_j është sipërfaqja e elementit j, në m^2;

ρ_{ij} është densiteti i materialit në shtresën i të elementit j, në kg/m^3;

c_{ij} është kapaciteti specifik i nxehtësisë së materialit të shtresës i në elementin j, në kJ/(kg·K);

d_{ij} është trashësia e shtresës i në elementin j, në m.

Shuma bëhet për shtresat sekuenciale të secilit element, duke filluar nga sipërfaqja e brendshme dhe duke u ndalur në shtresën e parë izoluese, trashësia maksimale e dhënë në Tabelën 8 ose në mes të elementit të ndërtimit, cilado që vjen së pari.

Tabela 12: Trashesia maksimale qe duhet marre parasysh nga perfitimet e brendshem te nxehtesise

Zbatimi	Trashesia maksimale, m
Percaktimi i fitimit apo humbjes se faktorit te perdorimit (periudha e variacioneve): 1 d)	0.10

2.1.17 Metoda për regjim konstant ngrohje dhe ftohje dhe pothuajse të vazhdueshëm, bazuar në metodën mujore të llogaritjes

Ngrohja dhe/ ose ftohja e vazhduar

Për ngrohje të vazhduar përgjatë gjithë sezonit të ngrohjes, $\theta_{set,H}$, temperatura e përcaktuar për ngrohje (ºC) merret nga tabela 2 e Shtojcës I të VKM 537/2020 të Kerkesave Minimale të Performancës dhe duhet të përdoret si temperaturë e brendshme e zonës së ndërtesës.

Për ftohje të vazhduar përgjatë gjithë sezonit të ftohjes, $\theta_{set,C}$, temperatura e përcaktuar për ftohje (ºC) merret nga tabela 2 e Shtojcës I të VKM 537/2020 të Kerkesave Minimale të Performancës dhe duhet të përdoret si temperaturë e brendshme e zonës së ndërtesës.

Për metodën mujore, temperatura aktuale mesatare e brendshme mund të jetë më e lartë në ngrohje për shkak të mbinxehjes së menjëhershme. Megjithatë, kjo merret parasysh nga faktori i shfrytëzimit të përfitimit të nxehtësisë. Në mënyrë të ngjashme, për proçesin e ftohjes, temperatura mesatare e brendshme mund të jetë më e ulët për shkak të humbjeve të larta të nxehtësisë.

Ngrohja pothuajse e vazhdueshme

Ngrohja pothuajse e vazhdueshme konsiderohet si ngrohje e vazhdueshme me temperatura të përcaktuara të pershtatura në rast përdorimi sipas Modalitetit A ose Modalitetit B:

Modaliteti A:

- Nese ndryshimet e temperaturës së caktuar ndërmjet ngrohjes normale dhe periudhave të reduktuara të ngrohjes janë më pak se 3ºC dhe / ose
- Nëse konstantja kohore e zonës së ndërtesës është më pak se 0.2 herë kohëzgjatja e periudhës më të shkurtër të ngrohjes (për ngrohje),

atëherë temperatura e përcaktuar për llogaritjen e ngrohjes është mesatarja kohore e temperaturës së caktuar. Shih ilustrimin në a) dhe b) të Figura 4.

Modaliteti B:

- Nëse konstantja kohore e zonës së ndërtesës është më e madhe se 3 herë e kohëzgjatjes së periudhës së ngrohjes më të gjatë të reduktuar atëherë temperatura e caktuar për llogaritjen e ngrohjes është temperatura e caktuar për rregullimin normal të ngrohjes. Shih ilustrimin në c) të Figura 4.

Figura 4 Shembull I furnizimit pothuajse ne menyre te pothuajse te vazhduar



Key

The cases a, b and c represent different situations as described in the text.

$\theta_{set,inp}$	set-point temperature provided as input
$\theta_{set,calc}$	set-point temperature for the calculation
t	time
t_c	representative part of the calculation period

2.1.18 Korrigjimet për ngrohje/ ftohje me ndërprerje, metoda mujore

Ngrohje

Në rast ngrohje me ndërprerje kur nuk përmbushet kushti në seksionin 0 (Ngrohja pothuajse e vazhdueshme), kërkesa për energji për ngrohje, $Q_{H,interm}$, në MJ, llogaritet duke përdorur ekuacionin e mëposhtëm:

$$Q_{H,interm} = a_{H,red} Q_{H,cont}$$

ku:

$Q_{H,cont}$ është kërkesa për energji për ngrohje të vazhdueshme, në MJ, llogaritur në përputhje me seksionin 2.1.2.

$a_{H,red}$ është faktori reduktues pa-dimension për ngrohje me ndërprerje, i përcaktuar sipas ekuacionit të mëposhtëm:

$$a_{H,red} = 1 - \left[b_{H,red} \left(\frac{\tau_{0,H}}{\tau_H} \right) \gamma_H \left(1 - f_{H,hr}\right) \right]$$

me vlerë minimale: $a_{H,red} = f_{H,hr}$ dhe vlerë maksimale: $a_{H,red} = 1$

dhe ku:

$f_{H,hr}$ është fraksioni i numrit të orëve në muaj me një nivel të vendosur normale të ngrohjes(pa ne një nivel të vendosur të reduktuar ose fikje);

$b_{H,red}$ është një faktor korrelacioni empirik me vlerë= 3;

τ_H është konstantja kohore e zonës së ndërtimit për ngrohje, shprehur ne orë;

$\tau_{0,H}$ është konstantja kohore reference për mënyrën e ngrohjes, shprehur në orë;

γ_H është raporti humbje/fitim jo-dimensional për mënyren e ngrohjes.

me vlerë minimale: $a_{C,red} = f_{C,day}$ dhe vlerë maksimale: $a_{C,red} = 1$

Ftohje

Për shkak të modelit diellor të motit dhe efektit të inercisë termike të ndërtesës, një ndërprerje ose fikje e termostatit në mbrëmje/natë ka në përgjithësi një efekt shumë më të vogël në kërkesën e energjisë për ftohje sesa një ndërprerje ose fikje e termostatit, në kërkesën për energji për ngrohje. Kjo nënkupton që një ndërprerje ose fikje e termostatit gjatë mbrëmjes/natës do të rezultojë në një ulje të vogël ose asnjë reduktim në kërkesën për energji

për ftohje, përveç gjatë muajve të ngrohtë ose në rastin e fitimeve të larta të brendshme, në kombinim me humbjet të vogla të nxehtësisë. Prandaj, fraksioni kohor në regjimin e ftohjes me ndërprerje, $f_{C,day}$ (shih më poshtë), mund të bazohet në numrin e ditëve në muajt me ftohje, sesa në numrin e orëve në muaj si në rastin e regjimit të ngrohjes, $f_{H,hr}$ (në seksionin 2.1.18 (Ngrohja)).

Në rastin e ftohjes pothuajse të vazhdueshme, energjia e nevojshme për ftohje $Q_{C,interm}$, në MJ, llogaritet duke përdorur ekuacionin e mëposhtëm:

$$Q_{C,interm} = a_{C,red} Q_{C,cont}$$

ku:

$Q_{C,cont}$ kërkesa për energji për ftohje të vazhdueshme, në MJ, llogaritur në përputhje me seksionin 2.1.3.

$a_{C,red}$ është faktori reduktues pa dimension për ftohje me ndërprerje, i përcaktuar sipas ekuacionit të mëposhtëm:

$$a_{C,red} = 1 - \left[b_{C,red} \left(\frac{\tau_{0,C}}{\tau_C} \right) \frac{1}{\lambda_C} \left(1 - f_{C,day} \right) \right]$$

dhe me vlerë minimale: $a_{C,red} = f_{C,day}$ dhe vlerë maksimale: $a_{C,red} = 1$

$f_{C,day}$ është fraksioni i numrit të diteve në muaj me të paktën gjatë ditës në një nivel të vendosur normal ftohjeje (pa një nivel të vendosur të reduktuar ose fikje);

$b_{C,red}$ është nje faktor korrelacioni empirik me vlerë = 3;

τ_C është konstantja kohore e zonës së ndertimit për ftohje, shprehur në orë;

$\tau_{0,C}$ është konstantja kohore reference për menyrën e ftohjes, shprehur në orë;

λ_C është raporti humbje/fitim jo-dimensional për mënyrën e ftohjes.

2.1.19 Energjia e nevojshme vjetore për ngrohje dhe ftohje për një zonë të ndërtesës

Energjia e nevojshme vjetore për ngrohje dhe ftohje për një zonë të caktuar të ndërtesës llogaritet duke mbledhur kërkesën e llogaritur për energji për çdo periudhë kohore, duke marrë parasysh peshën e mundshme për regjime të ndryshme të ngrohjes ose ftohjes:

$$Q_{NH,yr} = \sum_i Q_{NH,i} \text{ and } Q_{NC,yr} = \sum_j Q_{NC,j}$$

ku:

$Q_{NH,yr}$ energjia e nevojshme vjetore për ngrohje për zonën e konsideruar, në MJ;
$Q_{NH,i}$ energjia e nevojshme mujore për ngrohje për zonën e konsideruar, në MJ;
$Q_{NC,yr}$ energjia e nevojshme vjetore për ftohje për zonën e konsideruar, në MJ;
$Q_{NC,j}$ energjia e nevojshme mujore për ftohje për zonën e konsideruar, në MJ.

2.1.20 Energjia e nevojshme vjetore për ngrohje ose ftohje, per kombinime të sistemeve

Në rastin e një përllogaritjeje me shumë zona (me ose pa ndërveprim termik mes zonave), energjia vjetore e nevojshme për ngrohje dhe ftohje për një kombinim të caktuar të sistemeve të ngrohjes, ftohjes dhe ventilimit që shërbejnë në zona të ndryshme është shuma e energjisë së nevojshmë për kondicionimin e zonave, *zs*, që shërbehen nga i njëjti kombinim sistemesh:

$$Q_{NH,yr,zs} = \sum_z Q_{NH,yr,z} \text{ and } Q_{NC,yr,zs} = \sum_z Q_{NC,yr,z}$$

ku:

$Q_{NH,yr,zs}$ energjia e nevojshme vjetore për ngrohje për të gjitha zonat e konsideruara, *zs*, që shërbehet nga i njëjti kombinim sistemesh, në MJ;

$Q_{NH,yr,z}$ energjia e nevojshme vjetore për ngrohje për zonën e konsideruar, *z*, që shërbehet nga i njëjti kombinim sistemesh, në MJ;

$Q_{NC,yr,zs}$ energjia e nevojshme vjetore për ftohje për të gjitha zonat e konsideruara, *zs*, që shërbehet nga i njëjti kombinim sistemesh, në MJ;

$Q_{NC,yr,z}$ energjia e nevojshme vjetore për ftohje për zonën e konsideruar, *z*, që shërbehet nga i njëjti kombinim sistemesh, në MJ .

--

2.2 Kërkesa për ventilim

2.2.1 Transferimi i nxehtësisë nëpërmjet ventilimit, në regjimin e ngrohjes

Për çdo muaj, tranferimi i nxehtësisë nëpërmjet ventilimit, $Q_{V\text{-}ng}$, llogaritet si:

$$Q_{V\text{-}ng} = H_{V\text{-}ng}\,(t_{br} - t_j)\,*n\,*0.0864$$

ku

$Q_{V\text{-}ng}$ - është nxehtësia e transferuar nëpërmjet ventilimit, në (kWh)

$H_{V\text{-}ng}$ - është koefiçenti i humbjeve të nxehtësisë gjatë ventilimit, në W/K

t_{br} - është temperatura e brendshme (brenda ndërtesës) (temperatura e përcaktuar për rregullimin e ngrohjes e marrë nga databaza e aktiviteteve për zonën e aktivitetit)

t_j - është temperatura e jashtme (temperatura mesatare mujore e marrë nga të dhënat klimatike për një orë të caktuar dhe një vendndodhje të caktuar), në K

n - është numri i ditëve në muaj

0.0864 - është faktori i konvertimit nga (W ditë) në (kWh).

2.2.2 Koefiçenti i humbjeve të nxehtësisë me ventilim në regjimin e ngrohjes

$$H_{V-heat} = \rho_a \bullet c_a \bullet u_{v-heat} \bullet A$$

ku:

$H_{V\text{-}heat}$ është koefiçenti i humbjeve të nxehtësisë me ventilim, në W/K

$\rho_a \bullet c_a$ është kapaciteti termik në volum i ajrit ~ 1.2 kJ/m^{3}K (si prodhim i densitetit të ajrit, në kg/m^3, dhe kapacitetit termik specific të ajrit, në kJ/kgK).

u_{v-heat} është prurja e ajrit në hapsirën e kondicionuar, në l/s për m^2 sipërfaqe dyshemeje

A është sipërfaqja e dyshemesë, në m^2.

Prurja e ajrit ventilues

$$u_{v-heat} = u_{v-\inf} / 3.6 + (1 - \eta_{HR}) \bullet u_{v,m,heat} + u_{v,n,heat}$$

ku:

u_{v-heat} është prurja e ajrit ventilues në hapsirën e kondicionuar, në l/s për m^2 sipërfaqe dyshemeje

$u_{v-\inf}$ është prurja e ajrit ventilues në hapsirën e kondicionuar nëpërmjet infiltrimeve, e konvertuar duke e pjestuar me 3.6 nga m^3/h për m^2 në l/s për m^2 sipërfaqe dyshemeje

η_{HR} është efiçenca e sistemit të rekuperimit të nxehtësisë. Vlerat standarde jepen në **Error! Reference source not found.**, por vlera të ndryshme mund të përdoren nëse justifikohen nga provat në dispozicion.

$u_{v,m,heat}$ është prurja e ajrit në hapsirën e kondicionuar që vjen nga ventilimi mekanik gjatë kohës së përdorimit, në l/s për m^2 sipërfaqe dyshemeje. Kjo vlerë mund të merret duke përdorur kërkesat për ventilim siç përcaktohet në shtojcën I tabela 2 të VKM 537/2020 për çdo lloj aktiviteti.

$u_{v,n,heat}$ është prurja e ajrit në hapësirën e kondicionuar që vjen nga ventilimi natyral, në l/s për m^2 sipërfaqe dyshemeje. Kjo vlerë mund të merret duke përdorur kërkesat për ventilim siç përcaktohet në shtojcën I tabela 2 të VKM 537/2020 për çdo lloj aktiviteti.

Tabela 13 Efiçenca e parazgjedhur e sistemeve të rikuperimit të nxehtësisë

Sistemi i rikuperimit të nxehtësisë	Eficenca
Shkëmbyesi i nxehtësisë sipërfaqesor (Rekuperatori)	0.65
Tubacionet e shpërndarjes së nxehtësisë	0.60
Këmbyes nxehtësie	0.65
Këmbyes nxehtësie cilindrik	0.50

2.2.3 Transferimi i nxehtësisë nëpërmjet ventilimit, në regjimin e ftohjes

Për çdo muaj, transferimi i nxehtësisë nëpërmjet ventilimit, Q_{V-cool} llogaritet si:

$$Q_{v-cool} = H_{V-cool} \bullet (\theta_i - \theta'_e) \bullet n \bullet 0.0864$$

ku:

Q_{V-cool} - është transferimi i nxehtësisë nëpërmjet ventilimit, në MJ

H_{V-cool} - është koefiçenti i humbjeve të nxehtësisë me ventilim, në W/K

θ_i - është temperatura e brendshme (brenda ndërtesës) (temperature e përcaktuar për rregullimin e ftohjes e marrë nga nga databaza e aktiviteteve për zonën e aktivitetit)

θ'_e - është temperatura e modifikuar e ajrit të jashtëm siç tregohet në Tabela 14;

n - është numri i ditëve në muaj, në ditë

0.0864 - është faktori i konvertimit nga (W.ditë) në MJ.

Tabela 14 Vlerat e përdorura për temperature e ajrit të furnizuar për llogaritjen e humbjeve me ventilimin për kerkesat energjetike në ftohje

Muaji	θ'_e (°C)
Janar	16.0
Shkurt	16.0
Mars	16.0
Prill	16.0
Maj	16.0
Qershor	17.0
Korrik	18.5
Gusht	18.3
Shtator	16.0
Tetor	16.0
Nentor	16.0
Dhjetor	16.0

2.2.4 Koefiçienti i humbjeve të nxehtësisë gjatë ventilimit në regjimin e ftohjes

Koefiçenti i humbjeve të nxehtësisë me ventilim

$$H_{V-cool} = \rho_a \bullet c_a \bullet u_{v-cool} \bullet A$$

ku:

H_{V-heat} është koefiçenti i humbjeve të nxehtësisë me ventilim, në W/K.

$\rho_a \bullet c_a$ është kapacitetit termik në volum i ajrit ~ 1.2 kJ/m^{3}K (si prodhim i densitetit të ajrit, në kg/m^3, dhe kapacitetit termik specifik të ajrit, në kJ/kgK).

u_{v-cool} është prurja e ajrit në hapsirën e kondicionuar, në l/s për m^2 sipërfaqe dyshemeje.

A është sipërfaqja e dyshemesë, në m^2.

Prurja e ajrit ventilues

$$u_{v-cool} = u_{v-\inf} / 3.6 + (1 - \eta_{HR}) \bullet u_{v,m}$$

ku:

u_{v-cool} është prurja e ajrit ventilues në hapsirën e kondicionuar, në l/s për m^2 sipërfaqe dyshemeje.

$u_{v-\inf}$ është prurja e ajrit ventilues në hapsirën e kondicionuar nëpërmjet infiltrimeve, e konvertuar duke e pjestuar me 3.6 nga m^3/h për m^2 në l/s për m^2 sipërfaqe dyshemeje.

$u_{v,m}$ është prurja e ajrit në hapsirën e kondicionuar që vjen nga ventilimi mekanik gjatë kohës së përdorimit, në l/s për m^2 sipërfaqe dyshemeje. Kjo vlerë mund të merret duke përdorur kërkesat për ventilim siç përcaktohet në Databazën e Aktiviteteve për çdo lloj aktiviteti.

η_{HR} është efiçenca e sistemit të rekuperimit të nxehtësisë. Vlerat standard jepen në **Error! Reference source not found.**, por vlera të ndryshme mund të përdoren nëse justifikohen nga provat në dispozicion.
Ky parameter vendoset në 0 nëse rekuperimi i nxehtësisë mund të anashkalohet ose fiket gjatë verës (referuar si efiçencë variabël e rekuperimit të nxehtësisë).

2.2.5 Ventilim i kontrolluar sipas kërkesës

Kjo metodologji përfshin aftësinë për të modeluar ventilimin të kontrolluar nëpërmjet kërkesës për zonat me ventilim mekanik ndërsa për zona me ventilim natyral, ekziston mundësia e kontrollit të ventilimit të përmirësuar, i cili i referohet ventilimit natyror me kontrollin e Sistemit të Menaxhimit të Ndërtesës (BMS) (p.sh., modifikimin e prurjes së ventilimit të siguruar nga mjete natyrore në hapësirë bazuar në ndonjë formë kontrolli).
Detajet për zbatimin e ventilimit të kontrolluar nga kërkesa janë të përshkruara më poshtë.
Për ato zona në të cilat ventilimi është i përcaktuar si mekanik, opsionet janë:

1. Jo ventilim të kontrolluar sipas kërkesës (*opsion i parazgjedhur*)
2. Ventilim i kontrolluar sipas kërkesës në varësi të numrit të banorëve
3. Ventilim i kontrolluar sipas kërkesës në varësi të sensorëve të gazit.

Nëse zgjidhet opsioni 2 ose 3 si më sipër, atëherë metodologjia ofron opsionet e mëposhtme:

4. Kontroll me Dampera (*opsion i parazgjedhur*)
5. Kontroll me shpejtësinë

Për zonat në të cilat ventilimi është përcaktuar si natyral, opsionet janë:

6. Jo ventilim të kontrolluar sipas kërkesës (opsion i parazgjedhur)
7. Ventilim i avancuar.

Një prurje e modifikuar e ajrit të pastër në rastin e ventilimit të kontrolluar sipas kërkesës (FAR_{dc}) duhet të përcaktohet nga sasia e ajrit të pastër të përcaktuar në në shtojcën I tabela 2 e VKM 537/2020 për llojin e aktivitetit të zones (FAR_{max}) si më poshtë:

$$FAR_{dc} = C_{dc} \times FAR_{lower} + \left(\left(1 - C_{dc}\right) \times FAR_{\max}\right)$$

ku:

FAR_{max} është prurja e ajrit ventilues për person marrë nga Databaza e Aktiviteteve e shumëzuar me densitetin pik të përdoruesve gjatë periudhës së përdorimit (dmth, l/s për m²),

FAR_{lower} është më e madhja ndërmjet: FAR_{min} ose ($0.6 \times FAR_{max}$).

ku FAR_{min} është prurja e ajrit ventilues për person marrë nga Shtojca I, tabela 2 e VKM 537/2020, e shumëzuar me densitetin minimal të përdoruesve gjatë periudhës së përdorimit (dmth., kjo mund të jetë zero për disa aktivitete).

C_{dc} është një koefiçent për ventilim të kontrolluar sipas kërkesës i cili përcaktohet bazuar në të dhënat e Tabela 15 **Vlerat e koefiçentit për ventilim të kontrolluar sipas kërkesës**

.

Tabela 15 Vlerat e koefiçentit për ventilim të kontrolluar sipas kërkesës

Tipi i kontrollit sipas kërkesës	Koefiçenti i kontrollit sipas kërkesës (C_{dc})
Asnjë	0
Kontroll i bazuar në numrin e përdoruesve	0.85
Kontroll i bazuar në sensorin e gazit	0.95
Ventilim natyral i avancuar	0.5

2.3 Kërkesa për ujë të ngrohtë

<u>Kërkesa për ujë të ngrohtë në çdo zone duhet te llogaritet si ne vijim:</u>

Kerkesa per uje te ngrohte (MJ/muaj) = *Kërkesa në databaze * 4.18 /1000 * siperfaqja e zones * ΔT*

ku:

Kerkesa ne database është kërkesa për ujë të ngrohtë në *Shtojcën I tabela 2 e VKM 537/2020*, shprehur në l/m^2 për muaj.

ΔT është ndryshimi i temperaturës (gradë C për ngrohjen e ujit), merret si 50°C.

4.18 /1000 është kapaciteti specifik i ngrohjes së ujit në MJ/kgK

Sipërfaqja e zonës në m^2.

Llogaritja e humbjeve në shpërndarje për çdo zonë për çdo muaj (MJ/muaj):

Nëse gjatësia e totale në zonë (outlet tubacionit nga hyrja nga dalja) është më e madhe se 3m, atëherë humbjet në shpërndarje llogariten si:

*Humbjet ne shpërndarje = 0.17 * Kërkesa për ujë të ngrohtë*

ku

0.17 është humbja mujore e paracaktuar në shpërndarje per sistemin e ujit të ngrohtë (MJ/muaj) për energjinë mujore që nevojitet për të plotësuar kërkesën për ujë të ngrohtë (MJ/muaj).

Për çdo sistem të ujit të ngrohtë (UNS) duhet të:

- Kryhen llogaritjet për secilin sistem me energji diellore (SED) që i sherben UNS për të llogaritur kontributin e SED ne UNS, që perdoret për të reduktuar kërkesen për ujë të ngrohtë;
- Vlerësohet kërkesa për ujë të ngrohtë, në zonën e shërbyer dhe humbjet në shpërndarje për UNS duke përdorur:
    - Shumën e kërkesës mujore për të gjitha zonat e shërbyera nga UNS;
    - Shumën e humbjeve mujore në shpërndarje për të gjitha zonat e shërbyera nga UNS;
    - Shumën e të gjitha sipërfaqeve të të gjitha zonave të shërbyera nga UNS;
- Vlerësohet koha më e hershme e fillimit dhe kohën e përfundimit për çdo zonë të shërbyer nga UNS;
- Llogaritet kontributi nga sistemi me energji diellore, Seksioni **Error! Reference source not found.**, nëse është e zbatueshme;
- Llogaritet kontributi nga CHP, nëse është e zbatueshme.

2.3.1 Ruajtja e ujit të ngrohtë nëpërmjet akumulatorit të nxehtësisë

Nëse sistemi i ujit të ngrohtë përfshin ruajtjen dhe vëllimi i ruajtjes nuk është furnizuar veçmas si e dhënë hyrëse, atëherë vëllimi i ruajtjes duhet të llogaritet si:

Vellimi i ruajtjes (litra) se akumulatorit = *Kërkesa ditore* (MJ/dite) * *18*

ku:

Kërkesa ditore = Kërkesa mujore maksimale/Numri i ditëve në muaj

18 është nje vlerë llogaritëse – vëllimi i ruajtjes është 18 litra për MJ të kërkesës ditore.

Nese humbjet nga sistemi akumulues nuk vendosen nga audituesi, atëherë humbjet nga sistemi akumulues duhet të llogariten si:

Humbjet e ruajtjes (MJ/muaj) = *Humbjet e ruajtjes ditore (kWh/liter të ruajtur)*(Vëllimi i ruajtur5)$^{1/3}$ *(365/12)*(Vëllimi i ruajtur)$^{2/3}$ * 3.6*

ku:

Humbjet e ruajtjes në ditë është humbja nga sistemi akumulues në ditë për kWh për litër të ruajtur dhe llogaritet si më poshtë:

- Për një enë ruajtjeje të paizoluar: *0.1425* kWh/ditë për litër të ruajtur
- Për një enë me izolim humbjet në pjesën periferike me trashësi *t* mm: *0.005 + 1.76/(t+12.8)*
- për një enë me një izolim me trashësi *t* mm: *0.005 + 0.55/(t + 4)*

Vëllimi i ruajtjes (akumulatorit) 5 është volumi i ruajtur në litra, nëse kërkesa vjetore për ujë të ngrohtë ishte 5 MJ/m^2, dmth, llogaritet si = *(5/365)*18*Sipërfaqen e shërbyer*

365/12 është shumëzimi me numrin e ditëve dhe pjesëtimi me numrin e muajve për të marë humbjet mujore të ruajtjeve.

Vëllimi i ruajtjes është vëllimi i ruajtjes së ujit të ngrohtë ne litra, siç është llogaritur më sipër ose siç furnizohet si e dhënë hyrëse.

3.6 është një faktor për të kthyer humbjet e ruajtjes nga kWh në MJ

2.3.2 Qarku dytësor

Nëse UNS përfshin një qarkullim dytësor atëherë nëse nuk furnizohet si e dhëna hyrëse, gjatësia e tubacionit të qarkullimit dytësor llogaritet si:

Gjatësia e tubacionit = rrënjë katrore (Sipërfaqja e shërbyer) 4.0*

ku:

Sipërfaqja e shërbyer është sipërfaqja totale që shërbehet nga UNS, ne m^2.

4.0 është një vlerë llogaritëse.

Humbjet e qarkullimit dytësor llogariten si:

Humbjet e qarkullimit dytesor (MJ/month) = *Humbjet për metër* (W/m) * *Gjatësia e tubacionit* (m) * *Orët e operimit* * *Numri i ditëve në muaj* * *3.6/1000*

ku:

Humbjet për metër Janë humbjet e qarkullimit dytësor për metër, të marra si 15 W/m të gjatësisë së qarkut dytësor nëse nuk sigurohet si e dhënë hyrëse;

Gjatësia e tubacionit është gjatësia e qarkullimit dytësor në m;

Orët e operimit është numri i orëve të operimit ditor të UNS;

3.6/1000 konverton W në kWh dhe më pas kWh në MJ;

Energjia e pompës qarkulluese të qarkut, nese nuk furnizohet si e dhënë hyrëse, duhet të llogaritet si:

Energjia e pompe së qarkulluese (kW) = (*0.25* * *Gjatësia e tubacionit* + *42*) / *500*

ku:

Gjatësia e e tubacionit është gjatësia e qarkullimit dytësor në m;

0.25, 42, and *500* janë vlera llogaritëse të nxjerra nga hulumtimi.

Energjia e pompës së qarkullimit dytësor më pas llogaritet duke shumëzuar energjinë e pompës me orët e operimit të UNS.

2.4 Vlerësimi i nevojave energjetike për ndriçim

Nevojat energjetike për ndriçim do të duhet të llogariten bazuar në metodikën sipas CEN EN 15193-1.

Të dhënat për këto llogaritje përfshin energjinë për ndriçim, kohëzgjatjen e ndriçimit duke përfshire edhe impaktin në lidhje me praninë e njerëzve (aktivitetin njerëzor) dhe të gjitha termat në lidhje me ndikimin e ndriçimit natyral dhe sistemeve të ndryshme të kontrollit të nivelit të ndriçimit.

Ekuacioni llogaritës për ndriçimin

$$W_{light} = \frac{\sum_{j=1}^{12}\left[N_j \times \left(\sum_{i=1}^{24}\left[P_j\left(F_{Dji} \times F_{Oji}\right)\right] + \sum_{i=1}^{24}\left(P_{dj} \times F_{Od}\right) + \left(24 \times P_P\right)\right)\right]}{1000} \; kWh/m^2 year$$

Me:

$N_j =$ [31, 28, 31, 30, 31, 30, 31, 31, 30, 31, 30, 31]. Number of days in each month

P_j = Fuqia e shprehur në W/m^2 për secilën orë të muajit *j*

P_p = Fuqia për pajisjet shtesë in W/m^2 orë

P_{dj} = Fuqia në raport me siperfaqen in W/m^2 për secilën orë të muajit *j*

F_{Dji} = Faktori i korrektimit të ndriçimit natyral (faktori i përdorimit) për orën *i* të muajit *j*

F_{Oji} = Oçupancy correction factor for hour *i* of month *j*

F_{Od} = Faktrori i korrektimit të okupancisë gjatë gjithë vitit.

2.4.1 Llogaritja e energjisë për ndriçim në ndërtesë, Pj

Dendësia e energjisë së ndriçimit për një ndërtesë të caktuar vlerësohet duke përdorur një nga opsionet e mëposhtme:

Përdoruesi i metodologjisë përcakton energjinë që kërkohet për ndriçimin e përgjithshëm (në W) për të arritur intensitetin e ndriçimit në secilën zonë me kusht që intensiteti i ndriçimit të kërkuar, i cili duhet të jetë i barabartë ose më i madh se niveli i aktivitetit të ndriçimit në databazën e ndriçimit dhe dendësia e energjisë së tij (W/m2) llogaritet duke e ndarë energjinë e kërkuar me sipërfaqen e zonës. Kur intensiteti i parashikuar i ndriçimit është më i vogël se niveli i kërkuar i ndriçimit të parashikuar në shtojcën I, Tabela 2 për aktivitetin e ndriçimit në zonën e shqyrtuar, densiteti i përgjithshem i energjisë duhet që automatikisht të jetë në proporcion me nivelin e aktivitetit të ndriçimit.

Përdoruesi përcakton eficencën e llambës në lumen për Watt-Qark dhe prodhimin e ndriçimit për të përcaktuar eficencën e sistemit të ndriçimit në aspektin e ndriçimit të Watt-Qark . Kjo mund të llogaritet duke marrë parasysh kurbën e ndriçimit (e cila është e bazuar në 60 lumen ndriçimi për vat-qark) të marra nga ekuacioni i mëposhtëm, për të nxjerrë densitetin e energjisë për ndriçimin e përgjithshëm. Përdoruesi mund të përdorë gjithashtu intensitetin e dritës në zonë, nëse dihet dhe pas kësaj densiteti i energjisë do të llogaritet në përputhje me paragrafin e mëposhtem.

Tabela 16 Eficenca e ndriçimit, që do të përdoret kur të perzgjidhet lloji i llambës

Lloji i llambes	Ndricimi ne lumens per qark watt	
	Aktivitete me ndricim anesor dhe pa ndricim natyral	**Aktivitete me ndricim te larte**
LED	50.0	50.0
Tungsten dhe Halogjen	7.5	9.0

Lloji i llambes	Ndricimi ne lumens per qark watt	
	Aktivitete me ndricim anesor dhe pa ndricim natyral	Aktivitete me ndricim te larte
- kompakt	22.5	27.0
T12 Fluoreshent - halofosfat –ballast me frekuence te ulet	25.0	30.0
T8 Fluoreshent - halofosfat - ballast me frekuence te ulet	27.5	33.0
T8 Fluoreshent - halofosfat - ballast me frekuence te larte	32.5	39.0
T8 Fluoreshent - ballast fosforeshente me frekuence te larte	36.3	43.5
Halogjen metalik	25.0	39.0
Merkur me presion te larte	22.5	27.0
Natrium me presion te larte	35.0	42.0
T5 Fluoreshent - ballast fosforeshente te rrethuar me frekuence te larte	37.5	45.0
Fluoreshent (pa detaje)	22.5	27.0

Densiteti i energjisë (W/m²) do të ndryshojë sipas funksionit të gjeometrisë për çdo zonë të modeluar dhe do të përcaktohet duke përdorur ekuacionin e mëposhtëm:

Dendësia e energjisë për 100 lux = (1.93 + 0.007×R + 0.063×R²)/MF

Ku R është raporti i sipërfaqes së përgjithshme të mureve me sipërfaqen totale të dyshemesë dhe vlera maksimale për R është 8, dhe MF është faktori i mirëmbajtjes që është llogaritur të jetë 0.8. Më pas dendësia e energjisë për 100 lux shumëzohet me nivelin e intensitetit të dritës për llojin e aktivitetit të përcaktuar nga databaza e aktiviteteve dhe pjesëtohet me 100. Përdoruesi përcakton një llambë ndriçimi për çdo zonë bazuar në **Error! Reference source not found.** ku eficenca e ndriçimit mund të llogaritet kundrejt kurbës së ndriçimit sipas paragrafit të mësipërm për të nxjerrë dendësinë e energjisë për ndriçimin e përgjithshëm. Përdoruesi mund të përdor gjithashtu intensitetin e dritës në zonë nëse dihet dhe densiteti i energjisë më pas do të llogaritet siç është përshkruar më sipër.

2.4.2 Llogaritja e energjisë për ndriçimin e kërkuar, Pdj

Ndriçimi mesatar i kërkuar do të përkufizohet në termat e eficencës së llambës për secilën zonë, i cili do të vlerësohet kundrejt nje efiçence prej 15 lumen për llambë për Watt-qark për

të rregulluar vlerën që lidhet me aktivitetin specifik në bazën e të dhënave sipas aktiviteteve në ndërtesa.

2.4.3 Llogaritja e energjisë të nevojshme (kontrolluese), P_p

Nëse nuk jepen të dhëna aktuale, ngarkesa e energjisë së nevojshme për kontrollet e ndriçimit, P_p është supozuar të jetë:

- Komandimi manual: 0 W/m^2
- Kontrolli i fotoqelizave:
  paracaktuar për sistemet e adresueshme digjitale = 0.57 W/m^2,
  paracaktuar për sensorë të pavarur = 0.3 W/m^2,
- Ndjeshmëria e banimit: paracaktuar = 0.3 W/m^2

2.4.4Llogaritja e faktorit të korrigjimit të dritës natyrale, F_{Dji}

Faktori i ndikimit të dritës natyrale (faktori i përdorimit), F_D, është ndriçimi që përdoret në një hapësirë e shprehur si një pjesë e asaj që sigurohet nga ndriçimi natyral.

Depërtimi i dritës së diellit

Kjo shprehet në terma të faktorit mesatar të dritës natyrale (*DF*). Mund të përdoret gjithashtu edhe me dritare çatie (dritare të hapura në çatinë e ndërtesës). Supozohet që faktori mesatar i dritës natyrale të jetë:

- Për dritare anësore: $DF = DF_1 = 45\ W_{win}/A$
- Për hapësira me ndriçues horizontal ose me ndriçues çatie (të tipit me dritare): $DF = DF_2 = 90\ W_{roof}/A$
- Të dyja së bashku, me dritare anësore dhe ndriçues çatie: $DF = DF_1 + DF_2$

Ku W_{win} është sipërfaqja totale e dritareve përfshirë kornizën, W_{roof} është sipërfaqja totale e dritareve në çati përfshirë kornizën dhe A është sipërfaqja e të gjithë faqeve të dhomës (tavan, dysheme, mure dhe dritare).

Këto shifra janë për xhama dysh të qartë me simbolin low-e. Nëse përdoren xhama të ngjyrosur, shumëzoni me faktorin e tejdukshmërisë të dhënë nga fabrika përkatëse dhe më pas e pjestoni me 0.76.

<u>Llogarisni faktorin e dritës natyrale për pjesën e përparme, të mesme dhe të pasme të dhomës:</u>

DF_F është faktori mesatar i dritës natyrale në pjesën ballore të dhomës brenda 3 m të parë (%)

$DF_F = (1.75 * DF_1) + DF_2$

DF_M është faktori mesatar i dritës natyrale në pjesën e mesme të dhomës brenda 3 m të dytë (%)

$DF_M = (0.25 * DF_1) + DF_2$

DF_B është faktori mesatar i dritës natyrale në pjesën e pasme të dhomës përtej 6 m (%)

$DF_B = DF_2$.

Kontrolli fotoelektrik

Llogaritja e faktorit të përdorimit:

Për zonat që ndriçohen nga dritaret në vetëm një orientim, faktori i përdorimit duhet të marrë parasysh diferencën në kontroll midis pjesës së parme dhe të pasme të zonës si më poshtë:

Nëse foto sensori është vetëm në pjesën e përparme, atëherë:

$$F_D = (\text{area daylit by side windows}) * \frac{(F_{D,F} + 1)}{2} + (1 - \text{area daylit by side windows}) * 1$$

Nëse foto sensori është në pjesën e përparme dhe të pasme, atëherë:

$$F_D = (\text{area daylit by side windows}) * \frac{(F_{D,F} + F_{D,M})}{2} + (1 - \text{area daylit by side windows}) * F_{D,B}$$

Metodologjia e ndjekur për të llogaritur energjinë elektrike të prodhuar nga turbinat e erës duhet të bazohet në Metodën e Densitetit të Energjisë Mesatare sipas të cilës energjia elektrike e prodhuar nga turbina e erës është siguruar duke vlerësuar densitetin e fuqisë mesatare të erës gjatë një viti duke përdorur të dhënat e motit për orë të caktuar dhe me anë të aplikimit të eficencës të transformimit të energjisë së erës në energji mekanike të turbinës dhe më pas në energji elektrike të gjeneratorit elektrik. Korrigjimi i shpejtësisë të burimit të erës për shkak të nivelit të lartësisë të vendosjes të turbines dhe llojit të terrenit gjithashtu duhet të konsiderohet.

2.11.1 Kërkesat për të dhëna

- Lloji i terrenit: Specifikon llojin e terrenit ku gjeneratori i erës është instaluar nga terrenet pa pengesa, tokë bujqësore me kufizues në kufijtë e saj dhe zonë industrial ose zonat ndër-urbane deri në një lartësi mesatare të ndërtesës më të madhe se 15 m.
- Diametri: specifikon diametrin e rrotorit të turbinës të erës, në m.
- Lartësia e aksit të turbinës: specifikon lartesinë të aksit të turbinës të erës, në m
- Fuqia: specifikon fuqinë e vlerësuar të turbinës të erës (fuqia elektrike e instaluar në funksion shpejtësinë e erës të vlerësuar), në kW – ky informacion është përdorur për të vlerësuar eficencën e transformimit të energjisë së erës në energji

mekanike të turbinës dhe më pas në energji elektrike të gjeneratorit elektrik. Për qëllimet e llogaritjes, kjo efiçencë është konsideruar të ndryshojë me shpejtësinë e erës mujore dhe fuqinë e vlerësuar të turbinës sipas Tabelës 27.

Tabela 26. Kategoritë e terrenit dhe parametrat e lidhur me ato (CIBSE, 2002).

Lloji I terrenit.	K_R Faktori I	z_O (m) gjatesia roughness
Zone e hapur	0.17	0.01
Toke e Ferme me kufizime ne perimetrin e saj, struktura te fermes te vogla te kufizuara ne shtepi ose peme.	0.19	0.05
Zonat industriale, nenurbane dhe pyjet e perhershme suburbane,	0.22	0.3
Zonat urbane ne te cilat te pakten 15% e siperfaqes eshte mbuluar me ndertesa me lartesi mesatare qe tejkalon 15 m.	0.24	1

Tabela 27. Eficenca e turbinës të erës

Prodhimi I shpejtesise mujore msatare (m/) dhe koeficienti Cr(z)	Turbinat e vogla (< 80 kW)	Turbinat e mesme (> 80 kW)
[0,3]	0 %	0 %
[3,4]	20%	36%
[4,5]	20%	35%
[5,6]	19%	33%
[6,7]	16%	29%
[7,8]	15%	26%
[8,9]	14%	23%
>9	14%	23%

2.11.2 Algoritmet e përcaktuara

Prodhimi i energjisë elektrike nga turbina e erës është llogaritur si në vijim:

$$Q_{WT} = 0.5 \bullet \rho \bullet \left(C_R(z) \bullet V_o\right)^3 \bullet A \bullet EPF \bullet K_{WT} \bullet 24 \bullet N / 1000 \quad \text{[kWh]}$$

Ku:

Q_{WT} është energjia elektrike mujore e prodhur nga turbina e erës, në kWh.

ρ është densiteti i ajrit – 1.225 kg/m3.

$C_R(z)$ është koeficienti i ashpërsisë në lartësinë z të llogaritur si:

$$C_R(z) = K_R \bullet \ln(z / z_0)$$

Ku:

K_R është faktori i terrenit (Tabela 26).

z_o është niveli ashpërsisë (Tabela 26).

z është larteseia aksit e turbinës të erës, në m.

V_o është shpejtësia e erës mujore mesatare nga të dhënat e motit lokal për çdo vendndodhje, në m/s.

A është sipërfaqes së lopatave të turbinës, në m2, e llogaritur si:

$$A = \pi \bullet D^2 / 4$$

Ku:

D është diametri i turbinës së erës, në m.

EPF është faktori formës së energjisë i llogaritur duke përdorur të dhënat e shpejtësisë për orë të erës që sigurohen nga Zyra Meteorologjike e Shqipërisë:

$$EPF = \frac{APD}{0.5 \bullet \rho \bullet V^3{}_o}$$

Ku:

APD: është densiteti i fuqisë mesatare, në W/m2, e llogaritur si:

$$APD = \frac{\sum_{i=1}^{8760} 0.5 \bullet \rho \bullet V^3{}_i}{8760}$$

Ku:

V_i është shpejtësia e erës për orë që jepet nga të dhënat e motit, në m/s

8760 janë numri i orevë në një vit.

K_{WT}: është eficenca e turbinës të erës që jepet në Tabelën 27.

N është numri i ditëve në muaj.

Shënim për turbinat e erës me aks vertikal.

Për të percaktuar turbinën e erës me aksin vertikal, diametri i turbinës i barabartë dhe do të duhet të përcaktohet:

$$A_{VAWT} = \frac{\pi \bullet D_e^{\ 2}}{4}$$

Ku

A_{VAWT} është sipërfaqja e lopatave të turbinës të erës me aksin vertikal, në m2.

De - është diametri i barabartë i turbinës të erës në aksin vertikal e përdorur për llogaritjet.

2.12 Gjeneratorët/Sistemet e prodhimit të kombinuar të Energjisë Elektrike dhe Energjisë Termike

2.12.1 Kërkesat për të dhëna

- Lloji i lendës djegëse: specifikon llojin e lendës djegëse të përdorur për prodhuesin e CHP.
- Eficenca sezonale e nxehtësisë është nxehtësia e dobishme totale e furnizuar nga centrali CHP e pjestuar me të dhënat e energjisë të lendës djegëse totale (duke përdorur vlerën fuqinë kalorifike të lëndës djegëse në masën e lartë të punës).
- Eficenca sezonale e energjisë është energjia totale e prodhuar nga centrali CHP e pjesëtuar me të dhënat e energjisë të lëndës djegëse totale (duke përdorur vlerën fuqinë kalorifike të lëndës djegëse në masën e lartë të punës).
- Ngrohja e hapësirës e furnizuar për ndërtesën: specifikon përqindjen e kërkesës energjetike për ngrohje të hapësirës të ndërtesës të furnizuar nga prodhuesi i CHP.
- Uji i ngrohtë i furnizuar për ndërtesën: specifikon përqindjen e kërkesës energjetike për ujë të ngrohtë të furnizuar nga prodhuesi i CHP.
- Ftohja e hapësirës e furnizuar për ndërtesën: specifikon përqindjen e kërkesës energjetike për ftohje të hapësirës të ndërtesës të furnizuar nga centrali me prodhim të trefishtë.
- Raporti i eficencës të energjise sezonale të ftohësit është eficenca sezonale e ftohësit të furnizuar nga chilleri (tipikisht ftohës me absorption), i llogaritur si raporti i prodhimit të ftohjes si energji e dobishme përkundrejt energjisë të furnizuar gjatë sezonit të ftohjes.

2.12.2 Përcaktimet e algoritmeve

Sasia e lëndës djegëse të përdorur nga centrali CHP:

$$F = \frac{H_{SH} \bullet p_{SH} + H_{HW} \bullet p_{HW} + \frac{H_{SC} \bullet p_{SC}}{SEER}}{\eta_{TH}}$$

Ku:

F janë kërkesat e lëndës djegëse nga centrali CHP, në kWh.

H_{SH} është kërkesa energjetike e ngrohjes të hapësirës gjatë muajve të ndërtesës, në kWh.

p_{SH} është raporti i kërkesës energjetike për ngrohje të hapësirës e furnizuar nga centrali CHP.

H_{HW} është kërkesa energjetike për ujë të ngrohtë çdo muaj të ndërtesës, në kWh.

p_{HW} është raporti i kërkesës energjetike për ujë të ngrohtë e furnizuar nga centrali i CHP.

H_{SC} është kërkesa energjetike e ftohjes të hapësirës çdo muaj të ndërtesës, në kWh

p_{SC} është raporti i kërkesës raporti të ftohjes të hapësirës e furnizuar nga ftohësit e ndezur me nxehtësi.

$SËR$ është raporti sezonal i eficencës të energjisë të furnizuar nga ftohësi

η_{TH} është eficenca e nxehtësisë sezonale të centralit të CHP e përcaktuar si nxehtësia e dobishme mujore totale e furnizuar e pjestuar nga input i energjisë të lëndës djegëse mujore totale (duke përdorur vlerën fuqinë kalorifike të lëndës djegëse në masën e lartë të punës).

Energjia elektrike e prodhuar nga centrali CHP:

$$E = F \bullet \eta_E$$

Ku:

E është fuqia (energjia elektrike) e prodhuar nga centrali CHP, në kWh.

η_E është eficenca e energjisë sezonale të centralit të CHP.

3. Referenca për algoritmet e llogaritjes

Ky seksion jep detaje për dokumentet më të rëndësishme të referuara në seksionet e mëparshme për përshkrimin e metodologjisë së përdorur për llogaritjen, të permbledhura këtu për të lehtësuar punën në drejtim të listimit së tyre.

NEN 2916:1998 Performanca e energjisë në ndërtesat jo-rezidenciale. Metoda e përkufizimit. ICS 91.120.10 Nëntor 1999

Performanca e energjisë në ndërtesa — llogaritja e nevojave të energjisë për ngrohjen dhe ftohjen e hapësirave – BS EN ISO 13790:2008.

PG-N37 Standardet që mbështesin Direktivën e Performancës së Energjisë në Ndërtesa (DPED)

Ventilimi i ndërtesave - metodat llogaritëse të përdorura për përcaktimin e shkallës së qarkullimit të ajrit brenda ndërtesave, përfshirë infiltrimin e ajrit. CEN/TC 156. 2006. EN 15242

Ventilimi i ndërtesave – llogaritja e temperaturës së dhomës si dhe ngarkesa dhe energjia për ato ndërtesa që kanë sistem ajri të kondicionuar nëpere dhoma. EN 15243

Performanca e energjisë në ndërtesa - kërkesat energjetike për ndriçim - CEN/TC 169 2006 EN 15193

Udhëzuesi CIBSE J. Moti, energjia diellore dhe ndriçimi, Janar 2002. Instituti Kryesor për Shërbimet në Ndërtesa në Londër

Paul Gipe. Fuqia e erës. 2004. James & James (Publikues Shkencor) Ltd. Londer. UK (Paul Gipe. Fuqia e erës. 2004.)

Sistemi i kombinuar i ngrohjes dhe energjisë për ndertesat. Udhëzues i praktikave më të mira GPG388. 2004

Sistemi e vogle të kombinuara (CHP) për prodhimin e njëkohshem të nxehtësisë dhe energjisë elektrike në ndertesa. Manualet e Aplikacioneve CIBSE AM12: 1999

Manual jo-shtëpiak për ngrohje, ftohje dhe ventilim. Departamenti për Komunitete dhe Qeverisje Vendore. Maj 2010.

BS EN 15316-4-3:2007 – sistemet e ngrohjes në ndërtesa — Metoda e llogaritjes së kërkesës për energji për sistemin dhe eficenca e sistemit— Pjesa 4-3: sistemet e prodhimit të ngrohjes, termike

Metodat e shprehjes së performancës se energjisë EN 15217

Rishikimi i standardeve në lidhje me llogaritjen e transmetimit të nxehtësisë në ndërtesa – performanca termike e pjesëve të ndryshme të ndërtesës – Karakteristikat termike dinamike – metodat e llogaritjes. EN ISO 13786:2005

Shqyrtimi i standardeve për llogaritjen e transmetimit të nxehtësisë në ndërtesa – në lidhje me performancen termike të pjesëve të ndryshme të ndërtesës – koeficientët e transmetimit dhe ventilimit të nxehtësisë – metodat e llogaritjes. EN ISO 13789

Sistemet e ngrohjes në ndërtesa – Metodat e llogaritjes së kërkesës së sistemit për energji dhe eficenca e sistemit – Pjesa 3, sistemet shtëpiake të ujit të ngrohtë. EN 15316-3.

4. Të dhëna hyrëse standarde

4.1 Hyrja

Në mënyrë që llogaritja të realizohet, përdoruesi i metodologjisë duhet të fusë një grup gjithëpërfshirës të dhënash për të përcaktuar ndërtesën në shqyrtim. Këto të dhëna kanë të bëjnë me:

- Informacione të përgjithshme
  - Detaje të projektit
  - Moti në vendndodhje
  - Detajet e vlerësuesit
- Përkufizimet e ndërtimit
  - Muret
  - Çatitë
  - Dyshemetë
  - Dyert
  - Sipërfaqet transparente – Dritaret me Xhama
- Gjeometria dhe kushtet e brendshme
  - Aktiviteti në çdo zonë (shiko më poshtë)
  - Përmasat e zonës dhe përmasat e secilit element të mbështjellses që rrethon zonën
  - Orientimi i çdo elementi të mbështjellses
  - Ndërtimi i çdo elementi të mbështjellses
  - Urat termike
- Kushtet e jashtme dhe mundësia e infiltrimit të ajrit
- Sistemet NVKA, sistemet e ngrohjes së ujit dhe sistemet e ndriçimit bashkë me kontrollet e tyre
  - Sistemet e Ngrohjes dhe të Ftohjes
  - Gjeneruesit e nxehtësisë për prodhimin e ujit të ngrohtë sanitar (UNS) përfshirë ndihmën e energjisë diellore termike.
  - Sistemet fotovoltaike në se aplikohen

- Gjeneruesit eloikë të energjisë
- Sistemet e kombinuara të energjisë termike dhe energjsë elektrike (CHP)
- Ndriçimi dhe kontrolli i ndriçimit
- Sistemet e ventilimit
- Çështje të përgjithshme në lidhje me matjen, korrigjimin e faktorit të fuqisë, etj.
- Shpërndarja e sistemeve në çdo zone

Ky seksion i metodologjisë përshkruan përqasjet përgjithësisht të zbatueshme për strategjitë e futjes së të dhënave dhe modelimit dhe zbatohet në mënyrë të barabartë si për përputhjen me Kërkesat Minimale të Performancës së Energjisë (KMP) të miratuara me V.K.M. Nr. 537, datë 08.07.2020 "Për Miratimin e Kërkesave Minimale të Performancës së Energjisë së Ndërtesave dhe të Elementëve të Ndërtesave" ashtu dhe per Certifikatën e Përformancës së Energjisë (CPE) dhe për modelimin e ndërtesave Aktuale dhe Referente (shiko Seksionet 5.2 dhe 5.3 për përkufizime).

4.2 Përcaktimi i fitimeve të brendshme të energjisë dhe kushteve mjedisore

Për të kryer një vlerësim të performancës së energjisë në një bazë të qendrueshme, një pjesë e rëndësishme e kësaj metodologjie është baza e të dhënave sipas aktiviteteve në ndërtesa që përkufizon aktivitete të ndryshme brenda hapësirave të ndërtesës. Një nga këto aktivitete standarde duhet të caktohet në çdo zonë të ndërtesës[8] në përputhje me tabelën 2 të shtojcës 1 tek V.K.M. Nr. 537, datë 08.07.2020 "Për Miratimin e Kërkesave Minimale të Performancës së Energjisë së Ndërtesave dhe të Elementëve të Ndërtesave".

Baza e të dhënave sipas aktiviteteve në ndërtesa (Shiko Annex **Error! Reference source not found.** për më shumë detaje) përcakton përdorimin standard, nivelet e temperaturës të vendosur në ngrohje dhe në ftohje në [°C], normat e ajrit të jashtëm që duhet të futet në ndërtesë në [lit/m^2/person], dhe profilet e fitimeve të brendshme të energjisë për çdo lloj aktiviteti në ndërtesë, në mënyrë që ndërtesat me të njëjtën miks aktivitetesh të ndryshojnë vetëm në aspektin e gjeometrisë, elementëve konstruktiv, shërbimeve dhe motit sipas vendndodhjes. Kështu që, është e mundur që CPE dhe KMP të krahasojnë ndërtesat bazuar në potencialin e tyre të brendshëm të performancës, pavarësisht mënyrës se si ato në të vërtetë mund të përdoren në praktikë. Fushat e informacionit në databaze janë si më poshtë:

1. Kohët dhe dendësia e pranisë së personave (aktivitetit njerëzor); norma totale metabolike dhe fitimeve të brendshme të energjisë duke përfshirë edhe nxehtwsinw latente të avujve të ujit)

[8] Në shkolla, këto aktivitete mund të ndodhin në klasa, laboratorë, palestra, zona ku hahet, zona ku përgatitet ushqimi, zyrat e personelit si dhe hapësira të tjera të perbashketa, si tualetet. Vlerat e parametrave ndryshojnë në varësi të llojit të ndërtesës p.sh. zyrat në shkolla nuk janë njesoj si zyrat qe ndodhen ne ndërtesa të dedikuara vetëm për punë zyre.

2. Temperatura dhe lagështia e taruar në ngrohje dhe ftohje;

3. Kushtet e rikthimit për periudhat kur hapësirat janë të pabanueshme;

4. Fitimet e brendshme të energjisë nga burime të tjera;

5. Kërkesa për ajër të freskët/jashtëm;

6. Niveli i ndriçimit për ndriçimin e përgjithshëm dhe densiteti i energjisë për ndriçimin;

7. Kërkesa për ujë të ngrohtë;

8. Një tregues që tregon nëse aktiviteti kërkon filtrim më eficencë të lartë, duke justifikuar kështu një shtim të Energjisë Specifike të Ventilatorit për atë hapësirë për të llogaritur rritjen e rënies së presionit.

Skedulat e vazhdueshme dhe të auditueshme të aktiviteteve janë një element i rëndësishëm i proceseve të përputhshmërisë dhe certifikimit dhe kështu që vetëm përkufizimet e miratuara të aktiviteteve mund të përdoren për këto qëllime[9]. Nese në ndertesën Aktuale ndodhet një hapësirë me përdorim të veçantë dhe në bazën e të dhënave nuk ka aktivitete të përshtatshme për të, eksperti që kryen analizën duhet të zgjedhë aktivitetin më të përafërt nga aktivitetet e miratuara në databazën ekzistuese. Për shkak se përputhshmëria dhe certifikimi bazohen në performancën e ndërtesës Aktuale në krahasim me performancën e ndërtesës Referente, ndikimi i këtij përafrimi duhet të minimizohet.

4.3 Ana Ndërtimore

Performaca termike e elementëve ndërtimore duhet të marrë në konsideratë fenominin e urave termike:

- urat termike përsëritëse duhet të përfshihet në llogaritjen e koeficentit të transmetimit të nxehtësisë U siç edhe përshkruhet në mënyrë të detajuar në BR443[10]. Modelet simuluese që kane futur konceptin e analizës shtresë pas shtrese do të duhet të axhustohen nëpërmjet shtresave izoluese për të arritur vleren e U që merr në konsideratë ripërsëritjen e urave termike.

- urat termike jo-përsëritëse duhet të merren në konsideratë duke shtuar një vlerë prej 10% të vlerës mesatare të ponderuar të U, duke qenë në harmoni me EN ISO 14683 dhe mund të aplikohet në mënyrë konstante si për ndërtesën Aktuale ashtu edhe për Ndërtesën Referente.

---

[9] Është e qartë se projektuesit mund të dëshirojnë të përdorin orare alternative të përshtatshme për vlerësime të vecanta të projektit, por ato ekzistojnë jashtë kornizes së perputhshmerise/certifikimit.

[10] konvencionet per llogaritjen e vlerave te U-se, BRE, 2006.

4.4 Burimet primare energjetike të konsumuara dhe sistemet me emetime të ulta dhe zero të CO_2

Vlera totale e burimeve energjetike të konsumuara nga ndërtesa Aktuale mund të llogaritet bazuar bazuar në konsumin final të energjisë për çdo lëndë/burim energjetik dhe koeficentët e konvertimit nga konsum final në burime primare të përcaktuar në Tabela 30 dhe do të duhet të përdoren për të bërë vlerësimin final të certifikimit.

Metoda e dhënë në vijim duhet të ndiqet kur bëhet e mundur të llogaritet impakti i autoprodhimit të energjisë elektrike si në CPE ashtu edhe KMP dhe aplikohet për të gjitha llojet e ndërtesave:

1. Llogarisni konsumin vjetor të enegjisë elektrike pa marrë parasysh se çfare lloj sistemi autogjenerimi i energjisë elektrike përdoret. Shumëzoni energjinë e konsumuar me faktorin e transformimit të energjisë primare të sistemit elektroenergjetik shqiptar.

2. Llogarisni energjinë elektrike të prodhuar nga sistemi gjeneruar (në rolin e autoprodhuesit) dhe shumëzojeni me faktorin e transformimit të energjisë primare të lëndës djegëse që përdor sistemi autoprodhues (nëse është e ndryshme nga vlera e sistemit elektroenergjetik shqiptar) duke mos marrë në konsideratë sa pjesë e energjisë elektrike është konsumuar në ndërtesë dhe sa është eksportuar.

3. Vlera e energjisë elektrike e cila do të transformohet në energji primare dhe do të përdoret për llogaritjen e nivelit të (NEA) dhe është vlera neto që jepet si diferencë e vlera të llogaritura në pikën ‘1” minus ate në pikën “2” të dhëna më sipër.

4. Çdo lëndë djegëse që përdoret për prodhimin e energjisë elektrike (psh., në një central CHP) shtohet (me koeficentin primar të transformimit) së bashku me lëndët e tjera djegëse të përdorura në ndërtesë (së bashku me koeficentin primar specifik të transformimit) për të bërë të mundur për të llogaritur vlerën totale të burimeve primare energjetike (d.m.th, the NEA).

4.5 Të dhënat Klimatike

Me qëllim që të llogarisim sjelljen e ndërtesës përkundrejt ngarkesave të ndryshueshme termike që vijnë si pasojë e mjedisit të jashtëm, aplikimi i kësaj metode kërkon të dhëna klimatike të paraqitura në Aneksin 5. Për cdo përditësim standard të tyre, të dhënat duhet së pari të aprovohen nga Ministri përgjegjës për Energjinë.

Të dhenat klimatike ne shumicën e rasteve duhet të zgjidhen nga lista e të dhenave të aprovuara për zonën më të afërt me ndërtesën aktuale. Nëqoftese kemi disa të dhëna mikro klimatike specifike që duhet të merren në konsideratë, të dhëna alternative klimatike mund të përdoren nëqoftëse ato janë më të pranueshme.

4.6 Faktorët e emetimit të lëndëve djegese si dhe fatorët e energjisë primare

Faktorët e emetimit CO_2 dhe fatorët primar të energjisë janë dhënë në Tabela 30.

Tabela 30 Faktorët e emetimit CO_2 dhe fatorët primar të energjisë

Lloji I lendes djegese	Faktori i konvertimit ne burim primar kWh/kWh	Faktori i emetimit te CO_2 kgCO2/kWh
Gaz natyror	1.220	0.201
LPG	1.235	0.262
Biogas	1.250	0.098
Diesel	1.282	0.261
Benzine	1.245	0.261
Linjit	1.538	0.333
Qymer i murrme	1.470	0.298
Antracit	1.333	0.372
me dy lende djegese (qymyr/dru)	1.429	0.076
Energji Elektrike	1.136	0.380
Nxehtesia si burim sekondar energjie	1.351	0.058
Biomase – dru zjarri	1.818	0.010
Biomase (peleta druri)	1.250	0.008
Biomase peleta (nga bersite e ullirit dhe mbetjet e tjera te industries ushqimore)	1.250	0.011
Biomase birketa (nga bersite e ullirit dhe mbetjet e tjera te industries ushqimore)	1.316	0.013
Sisteme te vogla te ngrohjes se perqendruar (bazuar ne solar)	1.543	0.389
Sisteme te vogla te ngrohjes se perqendruar (bazuar ne pelleta druri)	1.583	0.013
Sisteme te vogla te ngrohjes se perqendruar (bazuar ne biomase peleta (nga bersite e ullirit dhe mbetjet e tjera te industries ushqimore)	1.624	0.021
Sisteme te vogla te ngrohjes se perqendruar (bazuar ne gaz natyror)	1.452	0.292
Energji diellore	1.818	0

--

Burimi: Komunikimi i Trete Kombetar i Shqiperise nën Konventën e Kombeve të Bashkuara të Ndryshimeve Klimatike, Qershor 2016.

4.7 Ndriçimi

Llogaritjet e ndriçimit për rastin "Sipas Projektit" në perputhje me kërkesat e ndriçimit të parshikuara në tabelën 2 të shtojcës 1 tek V.K.M. Nr. 537, datë 08.07.2020 "Për Miratimin e Kërkesave Minimale të Performancës së Energjisë së Ndërtesave dhe të Elementëve të Ndërtesave", dhe duhet të marrin parasysh një faktor mirëmbajtje në lidhje me hapesirën 0.8, i cili i korrespondon një hapësirë të pastër që mirëmbahet çdo 3 vjet *(EN 12464)*.

4.8 Matjet dhe konventat/metodat e tjera

Në mënyre që të sigurojmë qëndrueshmëri të aplikimit, duhet të përdoren konventa/metoda standard të matjeve. Këto konventa/metoda janë të specifikuara në Tabelën 29, si në vijim:

Tabela 31 Matjet dhe kontratat e tjera

Parametrat	Perkufizimi
Sipërfaqja e zonës	Hapësira e katit e llogaritur duke përdorur dimensonet e brendshme horizontale të zonave të jashtme të mureve dhe rreth gjysmës së trashësisë së mureve të brendshme të zonave. Kjo teknikë përdoret për të shumëfishuar parametra që janë të lidhura me zonën data base respektive Shënim: Nëse zona ka ndonjë kufi virtual psh: jo mure në orientime të caktuara, hapësira rreth zonës është jo e limituar nga 'vija të theksuara ndarëse' të cilat përcaktojne kufijte virtual.
zarfi mbeshtjellës i ndërtesës	Sipërfaqja e mureve vertikale në zarfin mbështjellës (walls) = h × w, ku : h = lartësia e katit, duke përfshirë hapësirën bosh të katit në vendin bosh ku vendosen telat dhe kabllot dhe përcaktohet si lartësi nga dyshemeja e njërit kat në katin tjeter duke përfshire betonin e dyshemesë shtrasat e ndryshme të tavanit. Per katet e mësiperme, h është lartësia nga dyshemeja deri ne fund të shtresave të tavanit. w = përmasat horizontale të murit. Limitet për përmasat horizontale janë të përcaktuara nga muret ngjitur. Nëse muri ngjitur është i jashtëm, limiti do të jetë pjesa e brendshme e murit fqinj. Nëse muri ngjitur është i brendshëm, limiti do të jetë sa gjysma e trashësisë së tij. Shënim: Zonat e dyshemesë, tavanit dhe çatitë e sheshta llogariten në të njëjtën mënyrë si zonat respektive. Zonat për një çati të pjerrët të ekspozuar (psh pa një tavan të brendshëm horizontal) do të jetë sipërfaqja e brendshme e përthyer e zonës së çatisë.
Sipërfaqja e dritareve	Sipërfaqja e hapur strukturore në mur /çati; sipërfaqja, përfshin sipërfaqen e xhamit dhe sipërfaqen e kornizës të dritares.

Parametrat	Perkufizimi
Gjatesia e tubacieneve të ujit të ngrohtë për ngrohje dhe ujë të ngrohtë	Gjatësia e tubave të rrjedhjes së fluidit nga fillimit deri te dalja në sipërfaqe (e aplikueshme vetëm për sipërfaqet nga te cilat merret uji). Ky parametër është përdorur për të përcaktuar sasinë shtesë të ujit që duhet të futet në sistemin e ujit të ngrohtë, sepse uji i ftohtë në tubacione që nuk përmbajne lëngje apo gaze, duhet të hiqet para se të përftohet uji i ngrohtë. Kjo gjithashtu supozon se riqarkullimi i UNS mban ujë të nxehtë deri në kufirin e zonës, ose që tubi rrjedh nga qarkullimi ose depozita brenda zonës.
Çatia e sheshte	Çati me një pjerrësi prej 10º ose më pak. Nëse është me një kënd më të madh se 10º, çatia konsiderohet një çati e pjerrët.
Çatia e pjerrët	Çatitë me një pjerrësi më të madhe se 10º më pak ose të barabartë me 70º. Nëse pjerrësia është më e madhe se 70º, duhet të kondsiderohet si mur.
Dyert prej xhami	Nëse dyert kanë më shumë se 50% xham, atëherë karakteristikat e shtesave të dritës së diellit duhet të përfshihen në përllogaritje. Kjo përftohet duke përcaktuar këto dyer si dritare dhe duke marrë në konsideratë pjesën jo transparente në parametrin e faktorit të kornizës.
Muret rrethuese	Sistemet e mureve të jashtme prej xhami duhet të jenë të modeluara si qelq, ku zona e harqeve (pra zonat jo të dukshme) është marrë në llogari në faktorin e kornizës.

4.9 Sistemet alternative të energjisë

Në mënyrë që të përputhet me ligjin 116/2016, programi kompjuterik i miratuar që zbaton këtë Metodologji duhet të përfshijë pyetje plotësuese që konfirmojnë që projektuesit kanë marrë në konsideratë, në një projekt të ri ndërtimi, fizibilitetin teknik, mjedisor dhe ekonomik të " sistemeve alternative me efiçencë të lartë" të energjisë që sipas ligjit të mësipërm duhet të përfshijnë:

a) sistemet e decentralizuara të furnizimit me energji që shfrytëzojnë burime të rinovueshme të energjisë;
b) sistemet koogjeneruese, që realizojnë prodhimin e kombinuar të energjisë termike dhe të energjisë elektrike ose mekanike;
c) sistemet me pompa nxehtësie, të cilat ndryshojnë dhe transferojnë rrjedhën natyrale të energjisë termike, nga mjedisi i jashtëm te ndërtesat ose njësitë e ndërtesave dhe anasjelltas, nëse kërkohet një gjë e tillë;
ç) sistemet e ngrohjes dhe ftohjes së përqendruar, veçanërisht ato që shfrytëzojnë burime të rinovueshme energjie për ndërtesa ose blloqe ndërtesash.

dhe për të konfirmuar se ka dëshmi të dokumentuara të vlerësimit të fizibilitetit. Ata gjithashtu duhet të pyeten nëse kanë përfshirë ndonjë sistem të tillë në zgjidhjen e propozuar të projektimit. Përgjigjet për këto pyetje duhet të raportohen në certifikatë.

5. Protokolli i llogaritjeve

5.1 Hyrja

Ky seksion i Metodologjisë përkufizon protokollet specifike të cilët duhen përdorur për të llogaritur konsumimin final të energjisë së një ndërtese (dhe rrjedhimisht konsumin primar të energjisë) me qëllim:

- Për të leshuar një Certifikatë të Performancës së Energjisë (CPE) dhe
- Për të përputhur këtë Metodologji me V.K.M. Nr. 537, datë 08.07.2020 "Për Miratimin e Kërkesave Minimale të Performancës së Energjisë së Ndërtesave dhe të Elementëve të Ndërtesave" (KMP).

Qëllimi i metodologjisë së llogaritjes është të krijojë një model virtual ose imagjinar, të Ndërtesës Referente, e cila është në të njëjtën madhësi, formë, strukturë dhe orientim si ndërtesa e marrë në konsideratë (ndërtesa Aktuale). Kjo ndërtesë virtuale duhet të permbajë të njëjtat kombinime të aktiviteteve dhe të jetë subjekt i kushteve të njëjta të motit dhe parametrave të kërkuar.

Sidoqoftë, detajet e sistemeve të ndërtimit dhe të shërbimit të kësaj ndërtese Refernete duhet të specifikohen në një set të detajuar "recetë", e cila përbën standartin me të cilin duhet të krahasohen të gjitha ndërtesat e tjera. Performanca e energjisë e kësaj ndërtese imagjinare pastaj llogaritet duke përdorur metodologjinë aktuale të llogaritjes dhe përdorimi i energjisë që rezulton, përcakton objektivin kundrejt të cilit krahasohet performanca e ndërtesës aktuale.

Kjo metodologji është përdorur për të llogaritur konsumimin e energjisë për sistemin e ngrohjes, ftohjes, ventilimit, ndriçimit dhe atë të përgatitjes së ujit të ngrohtë në një ndertese të caktuar. Këto llogaritje gjenerohen për ndërtesën Aktuale dhe gjithashtu dhe për ndërtesën Referente siç është përcaktuar më poshtë. Kjo metodologji llogarit:

- Shkallën e efiçencës se energjise primare e cila përcaktohet si shumëzim i numrit pa permase 50 me raportin e Nevojës për Energji nga ndërtesa Aktuale (NEA) e marrë në shqyrtim, mbi normën e synuar te Nevojes për Energji të ndërtesës Referente (NER).
- Nevojën për Energji të ndërtesës Aktuale (NEA) – realizon shumën e energjisë së furnizuar sipas burimeve dhe e konverton atë në konsumin e energjisë primare ekuivalente për m^2 të sipërfaqes së banimit.
- Nevojën për Energji të ndërtesës Referente (NER) - që rrjedh nga konsumi primar i energjisë në ndërtesën Referente për m^2 sipas specifikimeve në Seksionin 5.2.

Ky seksion i udhëzuesit përshkruan metodën për të përkufizuar ndërtesën Referente, ndërtesat Aktuale, Klasifikimin e Ndërtesës (si vlerësim bazuar në NEA dhe NER), CPE – Certifikatën e Performancës së Energjisë dhe KMP – Kërkesat Minimale të Performancës në zbatim të V.K.M. Nr. 537, datë 08.07.2020 "Për Miratimin e Kërkesave Minimale të Performancës së Energjisë së Ndërtesave dhe të Elementëve të Ndërtesave".

5.1.1 Vlerësimi dhe shkalla e vlerësimit

Metoda për të përcaktuar performancën e energjisë është përdorimi i një raporti të performancës së ndërtesës aktuale kundrejt performancës së ndërtesës së standardizuar të referencës, ku ndërtesa Referente ka të njëjtën formë dhe madhësi dhe parametrat e aktivitetit si ndërtesa aktuale, por efikasitetet dhe vlerat e performancës te standardizuara. Detaje për përcaktimin e të dyja këtyre specifikime të ndërtimesave janë përfshirë në Seksionet 5.2 dhe 5.3.

5.1.2 Certifikata e performances së energjisë (CPE).

Në bazë të procedures të përcaktuar në VKM që përcakton Certifikatën e Performancës së Energjisë, programi kompjuterik i miratuar që implementon Metodologjinë përdor rezultatet e llogaritjeve për të gjeneruar CPE përmes procesit të mëposhem:

- Llogaritja e vlerësimit të aseteve të ndërtesës aktuale si raport i NEA ndaj NER
- Konverton këtë në një nivel relativ të konsumit specifik të energjisë nga shkalla A-G, (shiko më poshtë)
- Jep rekomandimet për përmiresime me kosto efektive të performancës së energjisë të ndërtesës aktuale.

5.1.3 Kërkesat minimale për Performancën e Energjisë në Ndërtesa (KMP)

Standardet minimale të perfomancës energjetike, si për ndërtesat e reja, ashtu edhe për ato ekzistuese që janë në procesin e e rinovimit përcaktohen në Kërkesat Minimale të Performancës janë në zbatim të V.K.M. Nr. 537, datë 08.07.2020 "Për Miratimin e Kërkesave Minimale të Performancës së Energjisë së Ndërtesave dhe të Elementëve të Ndërtesave"

Metodologjia konsiston në vendosjen e vlerat e shkallës së CPE të cilat duhet të arrijnë të gjithë ndërtesat e reja ose ndërtesat që do të rinovohen dhe duhet të përmiresohen në mënyrë që të plotësojnë Kërkesat Minimale të Performancës të parashikuara në VKM Nr. 537, datë 08.07.2020 "Për Miratimin e Kërkesave Minimale të Performancës së Energjisë së Ndërtesave dhe të Elementëve të Ndërtesave". Ky specifikim për standardet minimale në çdo kohë do të vendoset nga rregulloret përkatese KMP së energjsë në ndërtesa.

5.1.4 LLogaritja e Vlerësimit të Nivelit Relativ të Konsumit (NRK)

Vlerësimi i nivelit relativ të konsumit përcaktohet si raporti i energjisë primare nga ndërtesa aktuale (dmth. NEA) me normën e synuar/targetin të energjisë nga ndërtesa Referente (dmth. NER), me rezultatin që normalizohet në mënyrë që NER të jetë e barabartë me një vlerësim të nivelit prej 50, pra, NRK = 50 × NEA / NER.

NRK e llogaritur duhet të jetë i rrumbullakoset në numrin më të afërt të plotë, dmth., Nëse pjesa dhjetore e NRK është më pak se 0.5, NRK duhet të rrumbullakoset poshtë; nëse është 0.5 ose më e madhe, NRK duhet të rrumbullakoset lart.

5.1.5 Ndërtimi i shkallës së vlerësimit

Shkalla nga A deri ne G është një shkallë lineare vlerësimi bazuar në dy pika kyçe të përkufizuara si më poshtë:

1. Pika 0 në shkallë është përcaktuar si një performance e ndërtesës që konsumon 0 energji primare vjetore neto shoqëruar me përdorimin e shërbimeve fikse të ndërtesës siç është percaktuar në ligjin 116/2016 neni 9. Kjo është ekuivalente me një Shkallë të Energjisë së Ndërtesës të barabartë me zero të ndërtesës Referente (NEA).

2. Kufiri midis nivelit B dhe C me një Shkallë të vlerësimit të Vlerave deri në 50, për një ndërtese të re, përfaqeson një ndërtesë e cila përkon saktësisht me minimumin e standardeve të performancës së energjisë të përcaktuara në VKM Nr. 537/2020. Për shkak se shkalla është lineare, kufiri midis nivelit D dhe nivelit E i korrespondon një shkalle deri në 100.

Figure 6 Example of a possible EPC format



5.2 Ndërtesa Referente

Specifikimi i Ndërtesës Referente eshte përcaktuar si një praktikë e mirë në sektorin e ndërtesave dhe është baza për vendosjen e Nivelin/Targetin referent të Normës së Energjisë për ndërtesën (NER).

Ky seksion i metodologjisë përcakton Ndërtesën Referente, e cila është baza për vendosjen e shkallës së matjes të energjisë për Certifikatën e Performancës së Energjisë (CPE) dhe të zbatimit të Kërkesave Minimale të Performancës së Energjisë të miratuara me VKM 537/2020. Matja e shkallës së madhësisë së energjisë primare të Ndertesës Aktuale bëhet në krahasim me Ndertesën Referente.

CPE duhet që të dërgojë sinjale tregu për performancën relative të ndërtesave të krahasueshme. Në mënyrë që të sigurohet kjo qëndrueshmëri, Ndërtesa Referente duhet të jetë e njëjtë pavarësisht:

a. Nëse ndërtesa Aktuale është natyralisht e ventiluar apo me ajër të kondicionuar.

b. Zgjedhjes së lëndës djegëse

Ndërtesa Referente duhet të ketë të njejtën madhësi, formë dhe përmasa zonale ashtu si dhe Ndërtesa Aktuale, me të njëjtat standarde përsa i përket matjeve të përmasave (në Seksionin 4.8).

Çdo hapësirë (zonë) në ndërtesën Referente duhet të përmbajë të njëjtin aktivitet (dhe si rrjedhojë, të njëjtat parametra të aktivitetit) siç janë të propozuara për hapesirën ekuivalente në ndertesën Aktuale. Aktiviteti në secilën hapesirë duhet të përzgjihet nga lista e Aktivteteve siç është përcaktuar në databazën e Aktiviteteve (shiko Seksionin 4.2). Ndërtesa Aktuale dhe Referente duhet të jenë me të njëjtin orientim dhe duhet të ekspozohen ndaj të njëjtave kushte klimatike.

5.2.1 Struktura e ndërtesës

Struktura e ndërtesës për Ndërtesën Referentë duhet të ketë Vlerat-U në përputhje me specifikimet në me kreun II.1 pika 1 dhe 2 të V.K.M. Nr. 537, datë 08.07.2020 "Për Miratimin e Kërkesave Minimale të Performancës së Energjisë së Ndërtesave dhe të Elementëve të Ndërtesave". Për këtë të kihet në konsiderate që **ndërtesat e reja** dhe njësitë e tyre, si edhe **ndërtesat ekzistuese** dhe njësitë e tyre kur këto të fundit i nështrohen një rinovimi (ose ristrukturimi) të rëndësishëm përmbushin kërkesat e mëposhtme lidhur me performancën e energjisë:

1. Humbjet e nxehtësisë me transmetim nga **mbështjellja** (ku përfshihen muret, dritaret, dyert, catia dhe dyshemja e mbështetur me tokën) **e ndërtesave të reja** dhe njësitë e ndërtesave të reja të shprehura me koefiçentin e përgjithshëm të transmetimit të nxehtësisë U, nuk tejkalojnë vlerat e lejuara të këtij koeficienti të përcaktuara më poshtë:

Elementi i ekspozuar	Vlera-U (W/m²K)
1. Muret e jashtme në kontakt me mjedisin e jashtëm	0.38

2.	Çatia (e pjerët ose taracë)	0.35
3.	Soleta e papafingos	0.38
4.	Dysheme e mbështetur në tokë	0.5
5.	Komponentët me xham (dritaret me kornize alumin i izoluar, plastike, druri, etj) në të cilët vlera U për strukturat e transparente (dritaret) përfshin xhamin dhe kornizën.	2.00

2. Humbjet e nxehtësisë me transmetim nga **mbështjellësja** (ku përfshihe muret, dritaret, dyert, catia dhe dyshemja e mbështetur me tokën) **e ndërtesave ekzistuese** dhe njësitë e ndërtesave ekzistuese, kur ato i nështrohen një rinovimi të rëndësishëm dhe/ose kur shtohen/zgjerohen, të shprehura me koeficentin e përgjithshëm të transmetimit të nxehtësisë U, nuk tejkalojnë vlerat e lejuara të këtij koeficienti të përcaktuara më poshtë:

	Elementi i ekspozuar	Vlera-U (W/m²K)
1.	Muret e jashtme në kontakt me mjedisin e jashtëm	0.40
2.	Çatia (e pjerët ose taracë)	0.35
3.	Soleta e papafingos	0.45
4.	Dysheme e mbështetur në tokë	0.50
5.	Komponentët me xham (dritaret me kornize alumin i izoluar, plastike, druri, etj) në të cilët vlera U për strukturat e transparente (dritaret) përfshin xhamin dhe kornizën.	2.20

Çdo element i veçantë i ndërtesës ekzistuese si, dyshemeja, muret e jashtme, dritaret dhe/ose çatia, të cilat në gjendjen para rivovimit vërtetohet që kanë vlerën U, nën vlerat e U-së (shprehur në W/m²K) të përcaktuara më lart nuk është e detyrueshme të zvogëlohen më tej për shkak të rinovimit.

Hapjet për daljen e oxhakut dhe hapesirat e tjera të ventilimit të tilla si hapësirat marrëse dhe hapësirat dalëse duhet të mos merren parasysh në ndërtesën Referente dhe sipërfaqja e tyre duhet të zëvendësohet nga materiale jotransparente.

Humbjet e nxehtesisë të papërsëritura të urës termike për çdo element (përfshire dritaret, etj.) duhet të lejohet duke i shtuar 10% vlerave standarde-U. Vini re se vlerat-U, siç janë dhënë në **Error! Reference source not found.** nuk e përfshijnë këtë lejim dhe kështu që modeli llogaritës duhet të përshtatet në mënyrë të qartë.

Për dyshemetë e kateve tokësore zbatohen konsideratat të veçanta, ku vlera-U është një funksion i raportit perimetër me siperfaqe. Për këto raste duhet të bëhen përshtatjet e mëposhtme[11]:

1. Nëse vlera e llogaritur është më e madhe se 0.25 W/m²K, vlera 0.25 W/m²K duhet të përdoret në ndertesën Referente.

[11] Sipas udhëzimeve të dhëna në Udhëzuesin A të CIBSE(2006).

2. Nëse vlera e llogaritur është më e vogël se 0.25 W/m²K pa izolim shtesë, kjo vlerë më e vogel duhet të përdoret në ndërtesën Referente.

Gjatë modelimit të një elementi shtesë të ndërtesës, kufiri midis ndërtesës ekzistuese dhe zgjerimit duhet të shpërfillet (d.m.th., të supozohet që nuk ka transferim nxehtësie përgjatë tij).

Kapaciteti termik i elementeve të ndërtimit duhet të jetë siç përcaktohet në Tabela 32 **Kapaciteti termik i elementëve të ndërtimit në ndertesën Referente**

.

Tabela 32 Kapaciteti termik i elementëve të ndërtimit në ndertesën Referente

Elementi	Kapaciteti termik[12] (kJ/m²K)
Mur i jashtëm	11.7
Çatia	12.0
Kati përdhes	36.0
Mur i brendshëm	11.9
Dyshemeja e brendshme (dhe tavani i brendshëm)	8.6

Depertueshmëria e ajrit në ndërtesën Referente duhet të jetë 10 m³/h per m² të sipërfaqes së zarfit ne 50 Pa. Metoda e llogaritjes që është përdorur për të parashikuar normën e infiltrimit duhet të përdori depërtueshmërinë e ajrit si parameter për përcaktimin e rrjedhjeve në zarfin mbështjellës të ndërtesës. Për përputhshmëri dhe certifikim e njëjta metodë duhet të përdoret në ndërtesat Aktuale dhe Referente dhe duhet të ndjekë metodën e specifikuar në EN 152429.

5.2.2 Dritaret, dyert dhe dritaret në çati

Transmetueshmëria totale e energjisë diellore (BS EN 410 vlera-g) dhe koeficenti i transmetimit të nxehtësisë së xhamit duhet të merren sipas Tabela 33 **Transmetueshmëria e dritës së diellit për siperfaqet e qelqta të ndertesës Referente**

. Këto të dhëna vlejnë për dritaret e mureve vertikal dhe dritaret e çatisë. Vlerat e duhura për orientimet e ndërmjetme mund të bazohen në interpolimin linear.

[12] Llogaritja e kapacitetit termik në EN ISO 13790:2004

Tabela 33 Transmetueshmëria e dritës së diellit për siperfaqet e qelqta të ndertesës Referente

Orientimi i sipërfaqeve të qelqta	Transmetueshmeria e energjisë diellore	[illegible]
Veri, Veri-Lindje, Jug, Veri-Perendim	0.72	0.76
Lindje, Jug-Lindje, Jug-Perendim, Perendim	0.58	0.61
Horizontal	0.43	0.46

Siperfaqet e dritareve, dyerve dhe dritaret e çative në ndërtesën Referente duhet të përcaktohen siç është vendosur në nën-paragrafet e mëposhtme dhe duhet që gjithashtu të jenë në përputhje me konventat e matjes të caktuara në udhëzuesin e Seksionit **Error! Reference source not found.**.

1. Në varësi të kritereve të mëposhtme të gjitha muret e jashtme duhet të kenë dritare dhe të gjitha çatitë duhet të kenë dritare çatie.

2. Kopjoni zonat e dyerve të këmbësoreve, dyerve që mundesojnë aksesimin e automjeteve në ndërtesë dhe dritaret që ekzistojnë në elementin përkates të ndërtesës Aktuale.

3. Nëse sipërfaqja totale e ketyre elementëve është më e vogël sesa ajo që lejohet nga Tabela 34 **Përqindja e sipërfaqeve të hapura në ndertesën Referente**

4. , balanca duhet të përbëhet nga dritare ose drita çatie, sipas rastit.

5. Nëse sipërfaqja totale e elementëve të kopjuara e kalon limitin që lejohet nga Tabela 34 **Përqindja e sipërfaqeve të hapura në ndertesën Referente**

6. , sipërfaqet e kopjuara duhet të ruhen por nuk duhet të shtohen dritare ose drita çatie.

7. Sipërfaqet e përcaktuara në Tabela 34 **Përqindja e sipërfaqeve të hapura në ndertesën Referente**

8. përfaqesojnë zonat e hapjeve në mur ose çati dhe përbejnë zonën e qelqtë plus kornizën. Dritaret duhet të kenë një faktor kornize prej 10% (d.m.th., 90% e sipërfaqes së hapësirave është xham) dhe dritat e çatisë kanë një faktor kornize prej 30%.

Tabela 34 Përqindja e sipërfaqeve të hapura në ndertesën Referente

Lloji i Ndertesës	Dritaret (të siperfaqeve të mureve të ekspozuara)	Dritaret e çatisë (te sipërfaqeve të çative të ekspozuara)
Banesat	30%	0%
Ndërtesa të tjera rezidenciale (ku njerezit jetojnë përkohesisht ose përgjithmonë)	30%	20%
Vende mbledhjesh, zyra dhe dyqane	40%	20%
Ndërtesat industrial dhe ato të magazinimit	15%	20%

Për më tepër zbatohen rregullat e mëposhtme:

9. Ndërtesa Referente nuk ka dyer hyrëse që përdoren shpesh, edhe nëse ato ndodhen në ndertesën Aktuale.

10. Në ndërtesën Referente dyert e aksesimit të ndërtesës nga këmbësorët dhe automjetet duhet të merren si jotransparente (d.m.th., pa xham).

11. Asnjë sipërfaqe xhami nuk duhet të përfshihet në bodrume. Në gjysmë-bodrume (d.m.th., aty ku muri i hapësirës së bodrumit është kryesisht poshtë nivelit të tokës por dhe pjesërisht mbi tokë), përqindjet e Tabela 34 **Përqindja e sipërfaqeve të hapura në ndertesën Referente**

12. duhet të zbatohen për pjesën mbi tokë me zero xhama për pjesën poshtë nivelit të tokës.

5.2.3 Sistemi NVAK

Zgjedhja e shërbimeve të ngrohjes së hapesirës dhe ujit te engrohtë në ndërtesën Referente është përcaktuar nga të dhëna mbi formën më të zakonshme të sistemeve të ngrohjes dhe ujit të ngrohtë në lloje të ndryshme ndërtesash në zona të ndryshme klimatike të Shqipërisë. Gjithmonë duhet të përdoren sistemet e mëposhtme, pavarësisht lëndës djegëse dhe sistemit të përdorur në ndërtesën Aktuale.

1. Ngrohja hapësirës sigurohet nga sistem që funksionon me bartës energjetik energji elektrike ose me bartës energjetik të ndryshëm nga energjia elektrike.

2. Ngrohja e ujit sigurohet nga kaldaja lokale me energji elektrike ose me bartës energjetik të ndryshëm nga energjia elektrike.

Ndërtesa Referente ka një strategji fikse shërbimi pavarësisht strategjisë së adoptuar në ndërtesën Aktuale. Për këte arsye:

1. Çdo hapësirë ngrohet siç është përcaktuar nga "temperatura e taruar në ngrohje" të përcaktuara në bazën e të dhënave sipas aktiviteteve në ndërtesa.

2. Koeficenti Sezonal i Performancës së Ngrohjes (SCoP) për ngrohjen me energji elektrike është përcaktuar të jetë 0.85 dhe për sistemet të tjerë që punojnë me bartës energjetik të ndryshëm nga energjia elektrike 0.8.

3. Energjia e përdorur për sistemet mbështetëse është produkt i 0.61 W/m² dhe ditëve vjetore të funksionimit të sistemit të ngrohjes nga baza e të dhënave sipas aktiviteteve në ndërtesa.

4. Çdo hapësirë ftohet me energji elektrike, bazuar në oraret operative të përcaktuara në bazën e të dhënave sipas aktiviteteve në ndërtesa, me "temperaturën e taruar në ftohje" pavarësisht nëse hapësira në ndërtesën Aktuale ka furnizim ftohës apo jo. SSER ftohëse duhet të merret si 2.5 (ky faktor përfshin një lejim për energjinë e ventilatorëve gjatë kohës kur sistemi operon, kështu që asnjë energji e përdorur për sistemet mbështetëse shtesë nuk duhet të merret në konsideratë).

Një hapësire që nuk trajtohet në ndërtesën Aktuale (dmth., pa ngrohje dhe pa ftohje) nuk duhet të ngrohet ose ftohet edhe në ndërtesën Referente. Kjo do të thotë që të gjitha nivelet e mundshme të shërbimit janë vendosur në një shkallë të vetme. Nese një lloj akomodimi i veçantë nuk ka nevojë për ajër të kondicionuar (p.sh. magazina), atëherë kërkesa për ftohje do të jetë zero dhe asnjë kërkesë për energji nuk do të llogaritet. Nëse një lloj i veçantë aktiviteti ka gjithmone nevojë për ftohje (p.sh., një dhomë tregtare për ruajtjen e produkteve), atëherë do të llogaritet një nivel bazë ftohjeje. 25°C sikurse është zgjedhur në vend të nivelit të zakonshëm të komfortit prej 28°C, për shkak se llogaritjet bazohen në një Vit Referent Test (që përfaqëson parametrat mesatare tipike të kushteve klimaterike).

Për zonat me aspirim mekanik lokal, ku ventilatori është brenda zonës, dendësia e fuqisë së ventilatorit është produkt i shkallës së shkarkimit të përcaktuar nga përdoruesi dhe i një ventilatori me fuqi specifike prej 0.50 W për l/s. Për zonat ku aspirimi mekanik ndodhet lar nga zona, densiteti i fuqisë së ventilatorëve është produkt i shkallës së shkarkimit të përcaktuar nga përdoruesi dhe i një fuqie specifike të ventilatorit prej 0.80 W për l/s. Energjia e ventilatorëve të shkarkimit do të jetë një shtesë e energjisë e përdorur për sistemet mbështetëse të dhënë në pikën 3 më sipër.

Në ndërtesën Referente:

1. Nuk duhet të konsiderohen pajisje që shërbejnë për rikuperimin e nxehtësisë.

2. Nuk duhet të konsiderohet kontrolli i kërkesës për ventilim.

Efiçenca e përgjithshme e sistemit UNS duhet të merret si 95%. Kërkesa për energji duhet të merret si sasia që nevojitet për të ngritur temperaturën e ujit nga 10°C ne 60°C, bazuar në kërkesat e specifikuara në bazën e të dhënave sipas aktiviteteve në ndërtesa. Baza e të dhënave sipas aktiviteteve në ndërtesa përcakton një shifër totale ditore shprehur në l/(m² dite) për secilin lloj aktiviteti.

Energjia primare nga përdorimi i shërbimeve fikse të ndërtesës në ndertesën Referente llogaritet si Norma e Targetuar e Energjisë (NER) për të arritur në performancën energjetike të përdorur për të normalizuar energjinë primare të përdorur në ndërtesën Aktuale.

Nuk është menduar që përkufizimi i ndërtesës Referente të ndryshojë me ndryshimin e standarteve të Kodit të Ndërtimit, sepse kjo do të thotë se vlerësimi i energjisë i nje ndërtese të caktuar do të ndryshojë gjithashtu edhe nëse eficenca e saj energjetike nuk ka ndryshuar. Prandaj ndërtesa referente mbetet gjithmonë siç është përcaktuar më sipër.

5.2.4 Densiteti i fuqisë së ndriçimit

Për ndriçimin e përgjithshëm:

1. Në hapësira zyrash, magazinimi dhe industriale pjestoni me 100 ndriçimin e përcaktuar për hapësirën e dhënë për llojin e aktivitetit në bazën e të dhënave sipas aktiviteteve në ndërtesa, pastaj shumëzoni me 3.25 W/m² për 100 Lux. Kjo përfshin të gjitha hapsirat që merren kryesisht me detyra zyre, përfshire klasat, sallat e seminareve dhe dhomat e konferencave nëpër shkolla.

2. Për hapësira të tjera, pjestoni ilumnancën në mënyrë të saktë për aktivitet përkatëse në zonë me 100 dhe pastaj shumëzojeni 4.5 W/m² per 100 lux.

Zonat në ndërtesën Referente që janë të shënuara në bazën e të dhënave sipas aktiviteteve në ndërtesa si të përshtatshme për të përftuar ndërrim manual lokal, do të modelohen me ndërrim manual lokal me kusht që sipërfaqja e dyshemesë së çdo zone të jetë më pak se 30 m². Përndryshe ndriçimi i përgjithshëm komandohet në mënyrë qendrore në bazë të orëve të punës sipas aktivitetit të përshkruar në bazën e të dhënave sipas aktiviteteve në ndërtesa. Theksohet se ndërrimi manual lokal zbatohet vetëm për ndriçimin e përgjithshem (dmth., nuk aplikohet për ndriçimin natyral).

Lidhur me ndriçimin në ndërtesën Referente duhet të konsiderohet gjithashtu:

- Për ndriçimin natyral përdorni densitetin e shfaqjes së ndriçimit të përshtatshëm për një aktivitet të caktuar nga baza e të dhënave sipas aktiviteteve në ndërtesa.
- Ndriçimi i përgjithshëm në ndërtesën Referente nuk përfiton nga kontrolli i sensorëve të okupimit.
- Për ndriçimin natyral përdorni densitetin e shfaqjes së ndriçimit të përshtatshëm për një aktivitet të caktuar nga bazën e të dhënave sipas aktiviteteve në ndërtesa.
- Ndricimi i pergjithshem ne ndertesen Referente nuk perfiton nga kontrolli i sensoreve te perdorimit.
- Ndriçimi i vitrinave në ndertesën Referente nuk përfiton nga kontrolli automatik kohor.
- Si ndriçimi i përgjithshëm dhe ndriçimi natyral (kur është i përshtatshëm) do të përdorin të njëjtin profil operimi siç përcaktohet në bazën e të dhënave sipas aktiviteteve në ndërtesa për secilin aktivitet.

5.3 Ndërtesa Aktuale

Paragrafët e mëposhtme përshkruajnë kërkesat specifike për mënyrën se si është modeluar ndërtesa Aktuale.

5.3.1 Zarfi mbeshtjellës i ndërtesës

Hapësirat e oxhakut dhe hapësirat e tjera të ventilimit siç janë hapësirat marrëse dhe hapësirat dalëse duhet të mos merren parasysh në ndërtesat Aktuale dhe Referente dhe sipërfaqja e tyre duhet të zevëndesohet nga materiale jotransparente (çati ose mur).

Humbjet e nxehtësisë të urave termike për secilin element (përfshirë dritaret etj.) duhen lejuar duke i shtuar 10% vlerave U-mesatare të ponderuara me sipërfaqe standard, ose me një metodë ekuivalente që plotëson kriteret e EN ISO 14683.

Në rastet ku një metode ekuivalente që plotëson kriteret EN ISO 14683 përdoret për të konsideruar urat termike në ndërtesën Aktuale duhet të ketë një opsion ku ose përdoren direkt vlerat perkatese Psi ose përdoren vlerat e parazgjedhura siç specifikohet në **Error! Reference source not found..**

Tabela 35 Vlerat e parazgjedhura Psi për ndërtesën Aktuale (W/mK)

Lloji i bashkimit të elementëve	Përfshirë veshjen metalike	Duke mos përfshirë veshjen metalike
Çati dhe mur	0.42	0.18
Mur dhe dysheme e katit përdhes	1.73	0.24
Mur dhe Mur (qoshe)	0.38	0.14
Mur dhe dysheme (jo e katit përdhes)	0.04	0.11
Qemer mbi dritare ose dyer	1.91	0.45
Parvaz poshtë dritares	1.91	0.08
Pjesa anësore e dritares ose derës	1.91	0.09

5.3.2 Ndriçimi

Ndriçimi përcaktohet sipas nivelit të zonës (hapesirës së mbyllur). Densiteti i përgjithshëm i energjisë (W/m2) i nevojshëm për të arritur ndriçimin e projektimit në secilën zonë furnizohet si e dhënë hyrëse me kusht që ndriçimi sipas projektit të jete i barabartë ose më i madh se niveli i ndriçimit të një aktiviteti të caktuar në databazën e Aktiviteteve. Kur ndriçimi i projektuar është më i vogel se niveli i ndriçimit të aktivitetit të metodologjisë së llogaritjes, densiteti i përgjithshëm i energjisë do të pro-vlerësohet automatikisht në nivelin e ndriçimit të aktivitetit të metodologjisë së llogaritjes. Për shembull, një zyrë me densitet ngarkese të instaluar prej 6 W/m² që siguron ndricicm prej 300 lux (dmth. 2 W/m² per 100 Lux) do të përshtatet në 8 W/m² për shkak të pajtueshmërisë, sepse aktiviteti i metodologjisë së llogaritjes supozon një ndriçim prej 400 lux.

Për llogaritjet e energjisë, ndriçimi i pwergjithshëm mund të përcaktohet në mënyrë eksplicite, duke llogaritur dhe futur fuqinë e projektuar/instaluar, por fuqia rezultante në secilën zonë duhet të raportohet në përmbledhjen e dokumentit të fuqisë. Në rastet kur ndriçimi i përgjithshëm përcaktohet nga llogaritja duhet të aplikohet një faktor mirëmbajtjeje që është i përshtatshëm për instalimin e ndriçimit siç përcaktohet në Shoqatën e Ndriçimit bazuar në Manualin e Ndriçimit (CIBSE, ISBN 9781906846022).

Për ndriçim të përgjithshëm, përveç metodës eksplicite, mund të përdoren dhe dy metodat e mëposhtme me inferencë, për të përcaktuar ndriçimin e përgjithshem. Këto metoda përdorin përcaktimin e kurbës Reference së ndriçimit.

- **Metoda me inference 1** – Kurba Reference e Ndriçimit - Ndriçimi i përgjithshëm në ndërtesë bazohet në ndriçimin me eficencë prej 60 lumens për vat dhe densiteti i fuqisë rezultante (W/m²) do të ndryshojë si funksion i gjeometrisë së çdo zone të modeluar e cila do të përcaktohet duke përdorur ekuacionin e mëposhtëm:

Ekuacioni 1 *Densiteti i fuqisë për 100 lux = $(1.93 + 0.007\times R + 0.063\times R^2)/MF$*

Ku R është raporti i sipërfaqes totale të murit[13] *me sipërfaqen totale të katit, ku vlera maksimale për R është 8 dhe MF është faktori i mirëmbajtjes. Dendësia e fuqise për 100 lux më pas shumëzohet me nivelin e ndriçimit sipas llojit të aktivitetit, i cili përcaktohet nga databaza e Aktiviteteve dhe pjestohet me 100.*

.

- **Metoda me inference 2** - Përcaktoni eficencën e llambës në lumen për vat dhe raportin e prodhimit të dritës të ndriçuesit për të percaktuar eficencën e sistemit të ndriçimit në lumen per vat, të cilat mund të pro-vlerësohen kundrejt kurbës Referente të ndriçimit *(që bazohet në 60 lumen për vat)* përcaktuar nga **Error! Reference source not found.** për të konkluduar një densitet fuqie për ndriçimin e përgjithshëm. Gjithashtu mund të futet projektimi për ndriçim specifik për çdo zone nëse dihet dhe dendësia e fuqisë më pas do të pro-vlerësohet sipas kritereve të mësipërme.

Ndriçimi i përgjithshëm në ndertesën Aktuale do të përfshijë aftesinë e modelimit të shfrytëzimit maksimal të ndriçimit natyral, ndërrimin e ndriçimit manual lokal (kur është e përshtatshme) në atë me anën kontrollin e sensorëve të okupimit së hapesirës. Gjithashtu do të përfshije aftësinë e modelimit të kontrollit të ndriçimit konstant (siç është përcaktuar në EN 15193:2007[14]) duke reduktuar densitetin e përgjithshëm të fuqisë së ndriçimit me 10%, nëse është e aplikueshme.

Kontributi i dritës së diellit gjatë ditës nga dritaret duhet të përfshihet në shqyrtimin e shfrytëzimit maksimal të ndriçimit natyral.

---

[13] Për qëllime të llogaritjes së densitetit së fuqisë së ndriçimit, sipërfaqja e përgjithshme e murit përfshin fasadat e ekspozuara dhe ndarjet e brendshme, por jo ndarjet/muret virtuale të përdorura për të përcaktuar zonat perimetrale në zonat e planit te hapur. Sipërfaqja e dyshemesë duhet të përjashtojë hapesirat në dysheme ose tavanet virtuale.

[14] EN 15193:2007 – Performanca energjetike e ndertesave – Kriteret energjetike per Ndricim.

Ndriçimi i vitrinave do të përkufizohet sipas eficencës mesatare të llambës së ndriçimit për secilën zone, e cila do të pro-vlerësohet kundrejt një eficence prej 15 lumen për vat për të përshtatur metodologjinë e llogaritjes së vlerës së ndriçimit që lidhet me aktivitetin.

Do të ketë një opsion për caktimin e kontrollit automatik të ndërrimit të nivelit të ndriçimit në funksion të kohës në nivel zonal për ndriçimin në ndërtesën Aktuale që do të rezultojë në reduktimin e vlerës së energjisë vjetore me 20%.

Si ndriçimi i përgjithshëm ashtu dhe ndriçimi natyral (kur është i përshtatshëm) do të përdorin të njejtin profil operimi siç përcaktohet në databazën e Aktiviteteve për secilin aktivitet.

5.3.3 Zarfi mbështjellës dhe pjesa e brendshme e ndërtesës

Për ndërtesat e reja dhe pjesën e brendshme të ndërtesës ku shërbimet energjetike janë realizuar dhe NVKA nuk shtohen derisa ndërtesa të jetë shitur ose dhënë me qera, përdoruesit e metodologjisë duhet të identifikojnë cilat shërbime janë supozuar në fazen 'siç është ndërtuar'. Shërbimet e supozuara duhet të përcaktohen në nivelin e zonës me anë të diferencimit të zonave 'të zarfit mbështjellës të ndërtesës' nga zonat „pjesës së brëndshme të ndërtesës".

Nëse llogaritja kryhet në fazën 'siç është ndërtuar', përqindja e energjisë që lidhet me NVAK, ndriçimin dhe sistemet e UNS që shërbejnë për zonat 'për zarfin mbështjellës të ndërtesës' nuk do të llogariten në konsumin e përgjithshëm të energjisë së ndërtesës, si dhe në katin përdhes që lidhet me të. Theksohet se këto sisteme janë plotësisht funksionale dhe llogariten në mënyrë që të ofrohet shërbimi i pritshëm, të mirëmbahen temperaturat e përcaktuara, të sigurohet ndriçimi dhe uji i ngrohtë në të gjitha zonat, si "zarfit mbështjellës të ndërtesës' nga zonat "pjesën e brëndshme të ndërtesës". Kjo do të thotë se kushtet e kufijve midis zonave 'zarfit mbështjellës të ndërtesës' nga zonat "pjesën e brëndshme të ndërtesës" që janë konsideruar, por asnjë energji nuk është përdorur nga sistemet energjetike apo sistemet e ndriçimit gjatë shërbimit të zonave 'zarfit mbështjellës të ndërtesës'. Në të gjitha rastet e tjera, p.sh., analiza e kryer në fazën 'siç është projektuar' ose për zonat e brendshme, energjia do të llogaritet si zakonisht.

Energjia e prodhuar nga burimet e rinovueshme të energjisë duhet të ndahet në bazë të peshës së sipërfaqeve kur analiza bëhet në fazën "siç është ndërtuar". Në këtë fazë llogaritet vetem pjesa e zonave në ' pjesën e brendshme të ndërtesës '.

Energjia që lidhet me sistemet e kombinuara të prodhimit të njëkohshëm të nxehtësisë dhe energjisë elektrike (CHP) do të zbatohet vetëm në zonat 'në' pjesën e brendshme të ndërtesës.

6. Metoda e llogaritjes për parametrin e performancës termike Gvt

6.1 Koeficienti i humbjes volumetrike të nxehtësisë, G_{vt}

Koeficienti i humbjes volumetrike të nxehtësisë Gv përcaktohet në rregulloren ekzistuese Shqiptare VKM 38/2003. Ai merr në konsideratë humbjet e nxehtësisë nëpermjet transmetimit përmes elementëve të zarfit mbështjellës të ndërtesës dhe nyjeve të ndërtesës nëpërmjet ventilimit përmes infiltrimit dhe sistemeve fiks të ventilimit. Në thelb kjo është një matje e performancës termike të zarfit mbështjellës të ndërtesës.

Koeficienti përdoret tashmë si një tregues i performancës për ngrohjen e ndërtesave të reja dhe llogaritet si sasia e humbjeve të nxehtësisë për 1 m^3 të vëllimit të ngrohur të ndërtesës për diferencën 1°C ndërmjet temperaturës së brendshme dhe asaj të jashtme. Përkufizohet nga formula:

$$G_v = \frac{Q}{V_b\left(t_{in} - t_{ou}\right)} \qquad [W/m^3K]$$

G_v = Koeficienti i humbjeve volumetrike globale (W/m^3 K)

Q = humbja totale e nxehtësisë (Watt) = Q_{tr} +Q_{vent}

Ku Q_{tr} është humbja e nxehtësisë prej transmetimit dhe Q_{vent} është humbja e nxehtësisë prej ventilimit.

V_b = volumi i ngrohur (m^3)

t_{in} = temperatura e brendshme (^{0}C)

t_{ou} = temperatura e jashtme (^{0}C)

Vlera maksimale e lejueshme e Gv për një ndërtesë në zona të ndryshme klimatike të Shqipërisë dhe për sisteme të ndryshme të ngrohjes është dhënë në Tabela 36 **Koeficienti maksimal global Gv i lejuar për humbjen e nxehtësisë për një ndërtesë të re, per zona të ndryshme klimatike (W / m3.K) në funksion të lendës djegëse që përdoret për ngrohje**

më poshtë.

6.2 Metodologjia ekzistuese për llogaritjen e G_V sipas Ligjit Shqiptar për Energjinë në Ndërtesa dhe VKM. 38, 16/01/2003

Së pari, humbjet totale në ndërtesën në fjale **(Q)** llogariten në mënyre analitike, e cila është e barabartë me sasine e humbjeve për ventilim ose ndryshim të ajrit **(Qvent)** dhe humbjet e transmetimit termik **(Qtr)**, të cilat përbëhen nga humbjet termike me konveksionin dhe përcjellshmëri në zarfin mbështjellës të sipërfaqes së planit **(Qpl)** dhe humbjet mbi ura ose nyje termike **(Qn).**

$Q = Q_{tr} + Q_{vent} = (Q_{pl} + Q_n) + Q_{vent}$

6.2.1 Humbjet në lidhje me infiltrimin/ventilimin e pakontrolluar në ndërtesë: Q_{vent}

Kjo shprehje nënkupton para së gjithash, "ndryshimin e ajrit të brendshëm dhe zëvendësimin e tij me ajrin e jashtëm", një nocion me anë të të cilit ajri i brendshëm largohet për shkak të:

- Infiltrimi për shkak të rrjedhjes nëpër dyer dhe dritare si pasojë e defekteve në prodhimin e tyre, përdorimit të keq dhe mbi të gjitha si pasojë e paaftësisë për të bërë "mbylljen hermetike";
- Infiltrimi përmes komponenteve ndryshe 'ndërtimor' të zarfit të ndërtesës, përmes projektimit të keq ose mjeshtërisë së keqe në ndërtim
- Infiltrimi për shkak të hapjes dhe mbylljes së dyerve dhe dritareve për çfarëdo arsye: aromat, mbinxehja, përdorimi i dobët i sistemit të ngrohjes (asnje kriter), ventilimi i shpejtë për arsye të ndryshme, etj.

6.2.2 Ventilimi mekanik në ndërtesa

Në rastin e heqjes së ajrit me mjete mekanike (ventilator) është e qartë se ajri i ngrohtë që është brenda është zëvendësuar nga ajri i ftohtë që vjen nga jashtë dhe ky shkëmbim shkakton një ngarkesë shtesë termike. Humbjet përkatëse te cilat quhen "humbje për shkak të infiltrimit dhe ventilimit" janë edhe më të rëndësishme sepse:

Diferenca ndërmjet temperaturës së brendshme dhe të jashtme është e madhe, ($t_{in} - t_{ou}$) dhe rryma e nxehtësisë, Q, për shkak të ndryshimit të ajrit është e madhe dhe e barabartë me:

$$Q_{vent} = 0.34Vn(t_{in} - t_{ou})$$

ku:

Q_{vent} - humbjet (vat)

0,34 - vlera mesatare e kapacitetit volumetrik të ngrohjes të ajrit të ngrohur (W/m^3K)

V - volumi i dhomës së ngrohur [m^3]

n - Numri i ndryshimeve të ajrit në dhomën e shqyrtuar.

t_{br}, t_j - temperatura e brendshme dhe e jashtme në (°C)

Për banesat "numri i ndryshimeve të volumit së dhomës në një orë" është konstant domethënë madhësi fikse. Kjo situatë është një marrëdhënie midis nevojave higjienike dhe konsumit të energjisë. Në të vërtetë shkalla e përtëritjes së ajrit mund të jetë shumë më e lartë ose shumë më e ulët në varësi të disa faktoreve si ekzistenca apo jo e erës, cilësia e pajisjeve të mbylljes së dyerve dhe dritareve, si dhe ekspozimi i fasadave dhe hapjeve. Nga eksperienca kjo vlerë varion nga 1 në 10. Tekstet zyrtare i kanë marrë parasysh këto të dhena, por zbatimi i tyre

është shumë delikat. Në shtëpitë individuale ventilimi i përhershëm është i detyrueshëm sidomos për kuzhinën, tualetet dhe banjot, të cilat në shumë raste kërkojnë ventilim.

6.2.3 Humbjet për transmetimin e nxehtësisë nga muret dhe lidhjet/nyjet

Një pjesë e rëndësishme e nxehtësisë humbet përmes zarfit të ndërtesës përmes transmetimit. Këto humbje janë më të rëndësishmet sepse:

Diferenca midis temperaturave të brendshme dhe të jashtme është e madhe ($t_{in} - t_{ou}$)

Koeficienti i transferimit të nxehtësisë 'K' përmes ndarjeve brenda/jashtë lidhet me sipërfaqen e madhe të transmetimit të nxehtësisë 'S':

Këto humbje janë llogaritur me formulën përkatëse për murin e sheshtë:

$$Q_{tr} = KS(t_{in} - t_{ou})$$

Q_{tr} - humbjet në mure sipërfaqe (Watt)

K - koeficienti i transmetimit të nxehtësisë së murit ($W/m^2.^oC$[15])

S - sipërfaqja e ndarjes të marrë në konsideratë (m^2)

t_{br}, t_j - temperatura e brendshme dhe e jashtme (°C)

Humbjet totale per tre sipërfaqe janë:

$$Q_{pl} = (K_1S_1 + K_2S_2 + K_3S_3)*(t_{in} - t_{ou})$$

Koeficienti i humbjes së nxehtësisë së nyjeve termike jepet për njësi linear dhe shumëzohet me të njëjtën gjatësi të nxehtësisë (lidhja e nxehtësisë). Si rezultat:

$$Q_{ny} = K_{ny}L(t_{in} - t_{ou})$$

ku:

Q_{ny} - humbjet lineare termike (W)

K_{ny} - koeficienti i transferimit të nxehtësisë për një metër lidhjeje lineare (m)

L - gjatësia e lidhjes (m)

t_{in}, t_j - temperatura e brendshme dhe e jashtme (°C)

---

[15] K ne sistemin e vjeter eshte shprehur ne [kkal/m²h°C] dhe $K_{[kkal/m^2h^oC]} = 0.86K_{[W/m^2.^oC]}$

totali i të gjitha humbjeve termike të ndërtesës është: :

$$Q_{tr} = \sum \left(Q_{pl} + Q_{ny}\right) = \left(\sum K_i F_i + \sum K_{ny}^i L_{ny}^i\right)(t_{br} - t_j)$$

6.2.4 Analiza e humbjeve termike lokale koeficienti Gv i humbjeve volumore të nxehtësisë

Së bashku humbjet maksimale termike për një ndërtesë jepen si shuma e humbjeve për shkak të transmetimit dhe humbjeve për shkak të ventilimit (ndryshimit të ajrit si pasojë e infiltrimit, ventilimit të kontrolluar).

$$Q_{NG} = Q_{tr} + Q_{vent} \qquad \text{in [Watt]}$$

ku:

Q_{tr} - humbjet e nxehtësisë për transmetim në nyje të shprehura në vat

Q_{vent} - humbjet e nxehtësisë ndryshimin e ajrit (Vat)

6.3 Zonat klimatike të Shqipërisë dhe vlerat e lejuara(limit) te Gv

Tabela 36 **Koeficienti maksimal global Gv i lejuar për humbjen e nxehtësisë për një ndërtesë të re, per zona të ndryshme klimatike (W / m3.K) në funksion të lendës djegëse që përdoret për ngrohje**

më poshtë jep vlera kufizuese për Gv për zona të ndryshme klimatike në Shqiperi, në varësi të lendës djegëse që përdoret për ngrohje dhe vëllimit të ndërtesës.

Tabela 36 Koeficienti maksimal global Gv i lejuar për humbjen e nxehtësisë për një ndërtesë të re, per zona të ndryshme klimatike (W / m3.K) në funksion të lendës djegëse që përdoret për ngrohje

Lloji i ngrohjes	Pa energji elektrike (me lende djegese)			Me energji elektrike		
Zonat Klimatike / Volumi i nderteses. V_b	A	B	C	A	B	C
V_b<150m^3	1.60	1.75	2.00	1.30	1.35	1.45
150m^3 < V_b <300m^3	1.45	1.60	1.90	1.20	1.25	1.35
300 < V_b	1.30	1.45	1.75	1.10	1.15	1.25

Zonat klimatike bazohen në Grade Ditët e Ngrohjes për një vit mesatar:

Zona A: me më pak se 1300 Grade Dite Ngrohje (HDD) ne vit

Zona B: me 1301-2300 HDD

Zona C: me më shumë se 2301 HDD

.

A1 Zonimi i mjediseve te brendeshme

A1.1 Rregullat për ndarjen e zonave

Mënyra se si një ndërtesë është e ndarë në zona ndikon në vlerësimin e performancës së energjisë. Prandaj, në mënyrë që të sigurohet përputhshmëria e zbatimit, kjo metodologji përcakton rregullat e zonimit që duhet të zbatohen gjatë vlerësimit të performancës energjetike të ndërtesës.

Rezultati perfundimtar i procesit të zonimit do të jetë nje grup zonash që dallohen nga të gjithë të tjerat në kontakt me të përmes një ose me shumë dallimeve të mëposhtme:

- Aktiviteti bashkangjitur me të (Shiko seksionin 4.2)
- Sistemi NVKA që i shërben atij
- Sistemi i ndriçimit brenda tij
- Aksesimi i dritës/ndriçimit natyror (se Diellit) (përmes dritareve në mure ose në çati).

Për këtë qëllim, procesi i sugjeruar i zonimit brenda një skeme të caktuar kati është si më poshtë:

1. Ndani dyshemenë në fusha të veçanta fizike, të kufizuara nga kufijtë fizike, siç janë muret strukturore ose elementë të tjerë të përhershëm.
2. Nëse ndonjë pjesë e një zone është shërbyer nga një lloj i ndryshëm sistemi NVKA ose ndriçimi, krijoni një zonë të veçantë të kufizuar nga shtrirja e këtyre shërbimeve.
3. Nëse ndonjë pjesë e një zone ka një aktivitet tjetër që po ndodh në të, krijoni një zonë të veçantë për çdo aktivitet.
4. Atribuoni vetëm një Aktivitet në secilën zonë rezultuese.
5. Ndani secilën zonë rezultuese në Zona që marrin sasi të konsiderueshme drite dielli, të përcaktuara nga kufijtë që janë:
    - Në një distancë prej 6 metrash (m) nga një mur i jashtëm që përmban të paktën 20% xham.

- Në një distancë prej 1.5 x lartësia e dhomës përtej buzës së majës të kulmeve, sipërfaqja e së cilës është të paktën sa 10% e sipërfaqes së dyshemesë.
- Nëse ndonjë zonë rezultative është më pak se 3 m e gjerë, përfshijeni atë brenda zonave perreth.
- Nëse Zonat rezultuese mbivendosen, përdorni arsyetimin/diskrecionin/gjykimin tuaj për ta përfshirë pjesën e mbivendosur në një ose me shumë Zona.

6. Bashkojini të gjitha zonat e afërta të cilat shërbehen nga të njëjtat NVKA dhe sisteme ndriçimi dhe të cilat brenda tyre kanë të njëjtin Aktivitet (p.sh., dhomat e hoteleve fqinje, zyrat me aktivitet të veçantë etj.) përveç rasteve kur ekziston një arsye e mirë për të mos e bërë këtë gjë.

A2 Baza e të dhënave të veprimtarisë MKLL

A2.1 Hyrje

Metodologjia Kombëtare e Llogaritjes kërkon që përcaktimet e aktivitetit për një ndërtesë të përcaktohen duke zgjedhur nga një grup aktivitetesh të standardizuara që lidhen me një lloj specifik ndërtimi. Baza e të dhënave përmban një listë të llojeve të ndërtesave dhe llojeve të hapësirave (aktiviteteve) që mund të ekzistojnë në secilën prej tyre.

Për të arritur qëndrueshmëri në krahasimet midis ndërtesave të ngjashme, të cilat mund të përdoren në modele të ndryshme aktuale të funksionimit, një numër i parametrave për zonat e veprimtarisë janë fikse për secilin aktivitet dhe lloj ndërtimi, sesa lihen në diskrecionin e përdoruesve. Këto janë:

- Pikat e taruara të temperaturës së ngrohjes dhe ftohjes
- Standardet e ndriçimit
- Standardet e ventilimit
- Dendësia e okupimit (person/m2) dhe përfitimet e brendshme të nxhetësisë
- Fitimet e nxhetësisë nga pajisjet
- Fitimet e nxhetësisë nga lagështia e brendshme në rastin e pishinave dhe kuzhinave
- Kohëzgjatja kur parametrat e taruar, standarde, dendësitë e okupimit dhe fitimet e nxhetësisë duhet të ruhen
- Kushtet "set back" kur ato nuk ruhen

A2.2 Llojet e ndërtesave

Përdoruesit e bazës së të dhënave sipas aktiviteteve në ndërtesa mund të zgjedhin dhe caktojnë Llojin e Ndërtimit më të përshtatshëm për ndërtesën me të cilën po punojnë. Ekzistojnë 22

Lloje Ndërtimesh në bazën e të dhënave standarde, të grupuara në 9 kategori të identifikuara në ligjin PEN.

Çdo lloj ndërtese ka një përzgjedhje të aktiviteteve të lidhura që zakonisht ndodhin brenda një ndërtese standarde respektivisht llojit.

A2.3 Aktivitetet

Çdo lloj ndërtese ka një përzgjedhje të aktiviteteve të lidhura që zakonisht ndodhin brenda një ndërtese standarde respektivisht llojit.

Një aktivitet specifik caktohet për secilën zonë të ndërtesës dhe kjo përdoret për të identifikuar dhe caktuar vlera specifike në parametrat e përdorur për ndërtimin e kërkesës së ndërtesave për shërbime.

Çdo aktivitet në një lloj ndërtese ka gjithashtu një grup skedulesh që përshkruajnë në mënyrë të përgjithshme mënyrën e përdorimit të ndërtesës përsa i përket banimit, përdorimit të ndriçimit, pajisjeve dhe sistemeve të ftohjes dhe ngrohjes në baza orare.

Tabela 36 më poshtë tregon parametrat kryesorë për secilin aktivitet në bazën e të dhënave, së bashku me shembuj të llojit të informacionit të ruajtur.

Tabela 36 Përshkrimi dhe shembujt e parametrave kryesorë të lidhur me secilin aktivitet

PARAMETRI	PËRSHKRIMI
Kondicionimi	Lloji i kondicionimit në hapësirë për aktivitetin. Një aktivitet klasifikohet si: E kondicinuar - Një aktivitet i kryer gjithmonë në një hapësirë të kondicionuar termikisht; E pakondicinuar - Një veprimtari që zhvillohet gjithnjë në një hapësirë e cila nuk është e kondicinuar termikisht; E kondicinuar ose e pakondicinuar - Një aktivitet që mund të zhvillohet në një hapësirë tw kondicinuar ose në një hapësirë e cila nuk është e kondicinuar termikisht
Densiteti i okupimit (person/m^2)	Dendësia e okupimit gjatë periudhës pik (persona/m2). Kjo vlerë tregon numrin e personave për m2 në hapësirën ku aktiviteti zhvillohet gjatë periudhës pik të okupimit të hapësirës.
Aktiviteti Metabolizmit	Energjia e emetuar nga një person, në varësi të llojit mesatar të aktivitetit në hapësirë (ulur, vrap, etj) (W/person)
Temperatura e taruar në ftohje	(°C) Përcakton temperaturën (d.m.th. tarimin e termostatit ftohës) në hapësirën e okupuar në cilën pikë kërkohet ftohja.
Temperatura e taruar në ngrohje	(°C) Përcakton temperaturën (d.m.th. tarimin e termostatit ngrohës) në hapësirën e okupuar, në cilën pikë kërkohet ngrohja.

Temperatura "set back' në ngrohje	(°C) Përcakton temperaturën minimale në hapësirën në të cilën kërkohet ngrohja, zakonisht gjatë periudhave të pangopura ose periudhat e mosveprimit ose okupimit minimal, për të shmangur kondensimin / dëmtimin nga ngrica ose për të parandaluar që ndërtesa të bëhet shumë e ftohtë dhe të zvogëlojë kërkesat e pikut të ngrohjes gjatë operimit normal.
Sasia e ajrit të fresket (lit/s/ pers)	Kërkesa minimale e ajrit jashtë (të freskët) për person kur hapësira është e okupuar (l/s/person)
Ndriçimi (Lux)	Niveli i dritës në kur hapësira është e okupuar (dritë nantyrale ose elektrike) (lux).
Nxehtësia e emetura nga paisjet	Ngarkesa e pajisjeve kur hapësira është e okupuar (W / m2) ose pajisjet janë në përdorim. Ky është fitimi i nxehtësisë në hapësirë (i gjeneruar nga pajisjet).
Uji i ngrohtë sanitar	Kërkesa për ujë të ngrohtë nga banorët në hapësirë (l për m2 në ditë). .

Në aneksin 4 është vendosur "Baza e të dhënave sipas aktiviteteve në ndërtesa (activity database)" e cila plotëson në mënyrë komplementare tabelën 2 të shtojcës 1 tek V.K.M. Nr. 537, datë 08.07.2020 Për Miratimin e Kërkesave Minimale të Performancës së Energjisë së Ndërtesave dhe të Elementëve të Ndërtesave. Për elemente të njëjta, prevalon tabela e dhënën në Aneksin 4.

A2.4 Oraret e aktiviteteve

Përveç parametrave të renditur në Tabelën 36, baza e të dhënave të aktiviteteve gjithashtu cakton një sërë oraresh (skedulesh) për secilin aktivitet siç vijon:

- Okupimi i ndërtesës (zonës) - përmes orareve të shfrytëzimit
- Ndriçimi - përmes orareve të ndriçimit
- Pajisjet - përmes orareve të punës së pajisjeve
- Ngrohja - përmes orareve të ngrohjes
- Ftohja - përmes orareve të ftohjes.

Për secilën nga kategoritë e mësipërme, llojet e mëposhtme të orarit (skedulit) kërkohen të vendosen për çdo aktivitet:

Oraret vjetore: identifikon për çdo aktivitet, periudhat brenda vitit ku mund të ndryshojnë zënia, ndriçimi, pajisjet, ngrohja dhe ftohja, siç mund të ndodhë për shembull në shkolla ku sa më sipër do të jenë të ndryshme gjatë kohës së shkollës kundrejt periudhave të pushimeve (p.sh. pushimet e verës, Pushimet e Pashkëve dhe Krishtlindjeve, etj).

Oraret javore: kjo identifikon, për secilin aktivitet, orare të ndryshëm të funksionimit brenda ditëve të ndryshme të javës, dhe për këtë arsye u cakton vlera të ndryshme shfrytëzimit,

ndriçimit, pajisjeve, ftohjes dhe ngrohjes siç kërkohet. Këto orare kryesisht do të bëjnë dallimin midis modeleve të funksionimit të ditës së javës dhe fundjavës, siç është e përshtatshme.

Oraret ditore: kjo identifikon modelet e ndryshme të funksionimit orë pas ore gjatë çdo lloji të ndryshëm të ditës (p.sh. 8 deri në 5 gjatë ditës së javës kundrejt orëve të reduktuara ose të pavlefshme të punës gjatë fundjavave) për shfrytëzimin, ndriçimin, pajisjet, ftohjen dhe ngrohjen.

- Vlerat e **orarit të shfrytëzimit** për çdo orë korrespondojnë me raportin e zënies në çdo orë me dendësinë (e pikut) të zënies.
- Vlerat e **orarit të ndriçimit** për secilën orë korrespondojnë me raportin e kohës në çdo orë ku do të ndizen dritat (ose thjesht 1 nëse dritat do të ndizen në orë dhe 0 nëse jo).
- Vlerat e **orarit të punës të pajisjeve** për secilën orë korrespondojnë me raportin e fitimit të pajisjes me vlerë nominale në çdo orë.
- Vlerat e **orarit të ngrohjes** për çdo orë korrespondojnë me temperaturën e kthimit ose pikën e përcaktuar të nxehtësisë (kur duhet të jetë i ndezur ngrohja).
- Vlerat e **orarit të ftohjes** për çdo orë korrespondojnë me pikën e caktuar të ftohjes (kur ftohja duhet të jetë e ndezur) ose null (bosh) përndryshe.

A3 Faktorët e eficencës sezonale të sistemit

Në Seksionet 2.5 dhe 2.6, bëhet fjalë për nevojën e dy parametrave kryesorë që lidhen me sistemet NVAK, në mënyrë që të shndërrohet nevoja mujore ose vjetore për ngrohje dhe ftohje në konsum të energjisë për karburantin përkatës:

- ❑ Eficenca sezonale e sistemit në ngrohje: SSEFF
- ❑ Raporti i Eficencës sezonale të sistemit në ftohje: SSEER.

Qëllimi është të sigurojmë një vlerësim realist të eficencës sezonale të përgjithshme të sistemit të gjenerimit të nxehtësisë ose ftohjes, së bashku me sistemin e tij të shpërndarjes (tuba, kanale, etj). Kjo Shtojcë përshkruan një metodë për të nxjerrë figura të tilla, në mungesë të informacionit specifik për sistemet e përdorura në një ndërtesë. Baza e metodës është përshkruar në një punim nga Hitchin në 2007: "*Roger Hitchin, 'HVAC System Efficiencies for EPBD Calculations', REHVA World Congress Clima 2007 WellBeing Indoors, Helsinki 2007*".

Çdo lloj sistemi NVKA shoqërohet me të një vlerë të paracaktuar (Tabela 37) për secilin nga dy parametrat.

- ❑ Për ngrohje: dHSSEFF
- ❑ Për ftohje: dCSSEER.

- Këto vlera modifikohen më pas nga parametra shtesë që futen nga përdoruesi:
- Eficenca e burimit aktual për ngrohje/ftohje
- Fuqia specifike e ventilatorit aktual (FSV)
- Prurja e ajrit në grila dhe njësi të trajtimit të ajrit (AHU) - duke iu referuar standardeve të testimit CEN me të cilat përputhet instalimi aktual.

Inputet e përdoruesve përdoren së bashku me faktorët e korrigjimit për të modifikuar dy parametrat e paracaktuar, (dHSSEFF dhe dCSSËR). Rregullimi është zakonisht në formën (ax + b) ose 1 / (ax + b), ku 'x' është hyrja e përdoruesit (ose parametri i marrë prej tij), dhe 'a' dhe 'b' janë koeficientë konstant që varen nga lloji i sistemit NVKA. Vlerat e paracaktuar 'd' nuk prodhojnë asnjë korrigjim, pasi (ad+b) është përcaktuar të jetë 1.

Shifrat e korrigjuara për sistemin e ngrohjes dhe ftohjes efikasitetet sezonale mund të nxirren duke zbatuar këto ekuacione:

- SSEFF = dHSSEFF / (HSFPadj * HDLadj * HGENadj)
- SSEER = dCSSEER / (CSFPadj * CDLadj * CGENadj).

A3.1 Ngrohje

SSEFF = dHSSEFF / (HSFPadj * HDLadj * HGENadj)

ku:

dHSSEFF: Vlera standard e Eficencës sezonale e sistemit në ngrohje, marrë ngaTabela 37Default System Seasonal efficiency for heating, obtained from Table 37.

HSFPadj: Faktori i korrigjimit në ngrohje SSEFF, i shoqëruar me Fuqinë specifike të ventilatorit (SFP)Correction factor on heating SSEFF, associated with Specific Fan Power (SFP)

HSFPadj= 1/(a*SFP+b),

a = HSFPa (nga Tabela 37from Table 37)

b = HSFPb (nga Tabela 37from Table 37)

SFP = Vlera e SFP e sistemit (e dhënë nga përdoruesi ose vlerë standarde dHSFP nga Tabela 40 Actual SFP for the system (user input or default value dHSFP from Table 40)

HDLadj: Faktor korrigjimi në ngrohje SSEFF, shoqëruar me prurjen e ajrit në grila dhe njësi të trajtimit të ajrit (AHU)Correction factor on heating SSEFF, associated with duct and AHU leakages

HDLadj= (a*AL+b)

a = HDLa (nga Tabela 37from Table 37)

b = HDLb (nga Tabela 37from Table 37)

AL = Prurja e parashikuar e ajrit. Kjo vlerë varet nga klasat e zgjedhura nga përdoruesi për prurjen e kanalit të ajrit dhe prurjen e AHU, si në Tabelat 38 dhe 39Predicted Air leakage. This value depends on the classes chosen by the user for ductwork leakage and AHU leakage, as in Tables 38 and 39.

AL = dDL + dAHUL

HGENadj: Faktor korrigjimi në ngrohje SSEFF, shoqëruar me eficencën sezonale të gjëratorit të ngrohjesCorrection factor on heating SSEFF, associated with the seasonal efficiency of the heat generator

HGENadj = dHEFF / GEN

dHEFF është vlera standarde e eficencës së gjeneratorit të ngrohjes, marrë nga Tabela 40is the default heat generator efficiency obtained from Table 40

GEN = Vlerë e dhënë nga përdoruese (ose standarde) për eficencën sezonale të gjeneratoritUser (or default) value for generator seasonal efficiency

Tabela 37 Ngrohja: Vlerat standarde të eficencës sezonale të sistemit dhe faktorët korrigjues

Sistemi NVKA	dHSSeff	HSFPb	HSFPa	HDLb	HDLa
Sistem qendror ngrohje me uje: radiatore	0.58	1		1	
Sistem qendror ngrohje me uje: konveksues	0.58	1		1	
Sistem qendror ngrohje me uje: ngroje nga dyshemeja	0.58	1		1	
Sistem qendror ngrohje me shperndarje te ajrit te ngrohte	0.7	0.678	0.107	0.837	0.816
Ngrohesa te tjere local – ventilator fryres	0.6	1		1	
Ngrohesa te tjere local – jo me ventilator fryres	0.6	1		1	
Ngrohes me fluid jo te levizshem	0.7	1		1	
Ngrohes me fluid te levizshem	0.6	1		1	
Ngrohes me Djeges me shume shkalle	0.65	1		1	
Ngrohes me fryres ajri	0.65	1		1	
Ngrohes me fryres ajri me fluid te pa qarkullueshem	0.75	1		1	
Fryres me nje dalje VAV	0.48	0.872	0.043	0.809	0.954
Fryres me dy dalje VAV	0.45	0.872	0.043	0.809	0.954

Sistemi NVKA	dHSSeff	HSFPb	HSFPa	HDLb	HDLa
Kabine e brendeshme e paketuar (VAV)	0.54	0.872	0.043	1	0
Sistem ventilator	0.6	0.835	0.057	0.971	0.147
Sistem hyres	0.63	0.829	0.043	0.939	0.305
Sistem me volum constant (norme e fiksuar e ajrit te fresket)	0.65	0.697	0.101	0.737	1.315
Sistem me volum constant (norme variabel e ajrit te fresket)	0.65	0.697	0.101	0.737	1.315
Multizonale (siperfaqe e ngrohte/siperfaqe e ftohte)	0.5	0.727	0.091	0.831	0.843
Terminal ri-ngrohes (volume konstant)	0.43	0.648	0.117	0.833	0.833
Me dy hapesira (me volum konstant)	0.43	0.743	0.086	0.767	1.167
Ciller ne tavan ose qeliza passive cilleri me ventilator fryres	0.56	0.938	0.021	0.977	0.113
Qelize aktive cilleri	0.56	0.938	0.021	0.977	0.113
Pompe nxehtesie me qark primar uji	0.65	0.826	0.058	0.914	0.429
Sistem me nje koke ose me shume koka kondicionimi	2.05	1		1	
Sistem ftohes per nje dhome	2.05	1		1	

Tabela 37 Sistemet e rrjedhjes

CEN klasat e rrjedhjes	dDL
Klasa B	0.02
Klasa A	0.06
Testi por nuk eshte arritur A	0.15
Klasa C	0.0068
klasa D	0.00227

Tabela 38 AHU – axhustimi i rrjedhjeve

CEN AHU - klasifikimi	dAHUL
klasa L1	0.001
klasa L2	0.007
klasa L3	0.020
Me keq se klasa L3	0.060

Tabela 39 Ngrohja/ftohja: Vlerat standarde të eficencës të sistemit dhe fuqia specifike

Sistemi NVKA	dCEFF	dHEFF	dCSFP	dHSFP
Sistem qendror ngrohje me uje: radiatore	2	0.65		
Sistem qendror ngrohje me shperndarje te ajrit te ngrohte	2	0.65		3
Ngrohesa te tjere local – ventilator fryres	2	0.75		
Ngrohes ventilator	2	0.65	2.9	2.9
Sistem me volum constant (norme e fiksuar e ajrit te fresket)	2	0.65	3	3
Sistem me volum constant (norme variabel e ajrit te fresket)	2	0.65	3	3
Fryres me nje dalje VAV	2	0.65	3	3
Sistem me shume koka	2	2.2		
Sistem me shume koka dhe me ventilator	2	2.2	3	3
Ftohes me rryme variabel	3	3.2	3	3
Cillera ne tavan ose qeliza passive cilleri	2	0.65	3	3
Qeliza aktive chilleri	2	0.65	3	3
Pompe nxehtesie me uje	2	0.65	3	3
Sistem me induksion	2	0.65	4	4
Sistem me hapesira dyshe (me volum konstant)	2	0.65	3	3
Multizonale (siperfaqe e ngrohte/siperfaqe e ftohte)	2	0.65	3	3
Terminal ri-ngrohes (volume konstant)	2	0.65	3	3
Sistem qendror ngrohje me uje: me konveksion	2	0.65		
Sistem qendror ngrohje me uje: me ftohje nga dyshemeja	2	0.65		
Ngrohes me rrezatim me fluid jo te levizshem	2	0.75		
Ngrohes me rrezatim me fluid te levizshem	2	0.75		
Ngrohes me Djeges me shume shkalle	2	0.75		
Ngrohes ajri me fluid me presion	2	0.75		
Ngrohes ajri me fluid pa presion	2	0.75		
Me dy hapesira VAV	2	0.65	3	3
Ciller ne tavan ose qeliza passive cilleri me ventilator fryres	2	0.65	3	3
Sistem ftohes per nje dhome	2	2.2		
Ngrohesa te tjere lokal pa fryrje	2	0.75		

A3.2 Ftohja

SSER = dCSSER / (CSFPadj * CDLadj * CGENadj)

Ku:

dCSSËR: Koeficenti i sezonal i percaktuar per ftohjen, sipas **Error! Reference source not found.**.

CSFPadj: Faktori i korrectimit per ftohjes SSER shoqeruar fuqie specifike te ventilatorit (SFP)

CSFPadj = 1/(a*SFP+b),

a = CSFPa (nga Tabela 40)

b = CSFPb (nga Tabela 40)

SFP = SFP aktuale per sistemin (perdorur per vleren e e percaktuar)

CDLadj: Faktori korrektues per ftohjen SSER, shoqeruar me rrjedhes AHU

CDLadj= (a*AL+b),

a = dCDLa (nga Tabela 40

b = dCDLb (nga Tabela 40)

AL = Rrjedhjet e ajrit te parashikuar. Kjo vlere varet nga klasa e zgjedhur per te hapesiren rrjedhese ipas AHU, si ne Tabelen 38 dhe 39.

AL = dDL + dAHUL

CGENadj: Faktori korrectues ne ftohje SSER, I shoqeruar edhe me eficencen sezonale te gjeneratorit ftohes.

CGENadj = dCEFFd / GEN

dCEFFd = vlera e percaktuar e eficences se energjise sezonale per gjeneratorin ftohes te dhene ne Tabela 39

GEN = vlera e perdorur per eficencen sezonale te gjeneratorit qe siguron ftohjen

Tabela 40 Ftohja: Vlerat standarde të eficencës sezonale të sistemit dhe faktorët korrigjues

Sistem HVAC	dCSSËR	CSFPb	CSFPa	CDLb	CDLa
Me nje hapesire VAV	1.12	1.182	-0.061	0.853	0.736
Me dy hapesira VAV	0.99	1.182	-0.061	0.853	0.736
Kabinet e brendeshme e paketuar (VAV)	1.355	1.182	-0.061	1	
Sistem me ventilator fryres	1.355	1.226	-0.078	0.98	0.098
Sistem me induksion	1.2	1.224	-0.056	0.956	0.22
Sistem me volum constant (norme e fiksuar e ajrit te fresket)	0.73	1.675	-0.225	0.876	0.621
Sistem me volum constant (norme variabel e ajrit te fresket)	0.84	1.675	-0.225	0.876	0.621
Multizonale (siperfaqe e ngrohte/siperfaqe e ftohte)	0.5	1.288	-0.096	0.842	0.793
Terminal ri-ngrohes (volume konstant)	0.48	1.304	-0.101	0.828	0.859
Sistem me hapesira dyshe (me volum konstant)	0.48	1.304	-0.101	0.828	0.859
Ciller ne tavan ose qeliza passive cilleri me ventilator fryres	1.68	1.068	-0.023	0.981	0.095
Qeliza active cilleri	1.5	1.064	-0.021	0.98	0.1
Qarku primar i pompes se nxehtesise	1.09	1.209	-0.07	0.939	0.303
Sistem ftohes i vecante per nje dhome	1.42	1		1	
Sistem ftohes per nje dhome	1.42	1		1	

Aneksi 4 - Baza e të dhënave sipas aktiviteteve në ndërtesa

ID	Tipologjia e Ndërtesave	Funksioni/ Zonat	Përshkrimi	Densiteti i Okupimit (pers/m2)	Niveli metabolik (W/pers)	"Temperatura e taruar ne ftohje (°C)	"Temperatura e taruar ne ngrohje (°C)	Temperatura "set back' në ngrohje °C	Sasia e ajrit të freskët (lit/s/pers)	Ndriçimi (Lux)	Nxehtësia e emetura nga paisjet W/m2	UNSI per ditë për m2	Nxehtësia latente nga okupimi %
1079	1.1 Banimi - Banesë e vetme familjare	Dhomë Pritje	Dhoma kryesore e pritjes e shtëpisë.	0.0188	110	25	21	12	10	150	3.9	0.53	39
1080	1.1 Banimi - Banesë e vetme familjare	Dhoma e Fjetjes	Zona përdorur kryesisht për gjumë.	0.0229	90	25	21	12	10	100	3.58	0.53	25
1081	1.1 Banimi - Banesë e vetme familjare	Dhoma e Ngrënies	Zona e cila përdoret kryesisht për të ngrënë.	0.0169	110	25	21	12	10	150	3.06	0.53	39
1082	1.1 Banimi - Banesë e vetme familjare	Tualeti	Zona përmban WC guacën dhe lavamanin i cili është i ndarë nga banjoja kryesore.	0.0243	140	25	21	12	12	100	1.61	0.53	50
1083	1.1 Banimi - Banesë e vetme familjare	Kushina	Zona brenda banesës ku përgatitet ushqimi	0.0237	160	25	21	12	12	300	30.28	0.53	65
1084	1.1 Banimi - Banesë e vetme	Korridor i Banesës	Për të gjitha zonat e qarkullimit brenda	0.0155	180	25	21	12	10	100	1.57	0.53	50

	familjare		banesës.										
1085	1.1 Banimi - Banesë e vetme familjare	Banjo	Zona e përdorur veçanërisht për banjë/ larje. Përmban vaskën dhe/ ose dushin dhe zakonisht një lavaman dhe WC guacën.	0.0187	120	25	21	12	12	150	1.67	0.53	50
1086	1.1 Banimi - Banesë e vetme familjare	Zonat e përbashkëta të qarkullimit	Për të gjitha zonat e përbashkëta të qarkullimit sikurse janë korridoret dhe shkallët jashtë banesës.	0.0196	180	25	21	12	10	100	2.16	0	50
1329	2.1 Rezidenciale - Banesa në bllok apartamentesh	Dhomë Pritje	Dhoma kryesore e pritjes e shtëpisë.	0.0188	110	25	21	12	10	150	3.9	0.53	39
1330	2.1 Rezidenciale - Banesa në bllok apartamentesh	Dhoma e Fjetjes	Zona përdorur kryesisht për gjumë.	0.0229	90	25	21	12	10	100	3.58	0.53	25
1331	2.1 Rezidenciale - Banesa në bllok apartamentesh	Dhoma e Ngrënies	Zona e cila përdoret kryesisht për të ngrënë.	0.0169	110	25	21	12	10	150	3.06	0.53	39
1332	2.1 Rezidenciale - Banesa në bllok apartamentesh	Tualeti	Zona përmban WC guacën dhe lavamanin i cili është i ndarë nga banjoja kryesore.	0.0243	140	25	21	12	12	100	1.61	0.53	50
1333	2.1 Rezidenciale - Banesa në bllok apartamentesh	Kushina	Zona brenda banesës ku përgatitet ushqimi	0.0237	160	25	21	12	12	300	30.28	0.53	65

1334	2.1 Rezidenciale - Banesa në bllok apartamentesh	Korridor i Banesës	Për të gjitha zonat e qarkullimit brenda banesës.	0.0155	180	25	21	12	10	100	1.57	0.53	50
1335	2.1 Rezidenciale - Banesa në bllok apartamentesh	Banjo	Zona e përdorur veçanërisht për banjë/ larje. Përmban vaskën dhe/ ose dushin dhe zakonisht një lavaman dhe WC guacën.	0.0187	120	25	21	12	12	150	1.67	0.53	50
1336	2.1 Rezidenciale - Banesa në bllok apartamentesh	Zonat e përbashkëta të qarkullimit	Për të gjitha zonat e përbashkëta të qarkullimit sikurse janë korridoret dhe shkallët jashtë banesës.	0.0196	180	25	21	12	10	100	2.16	0	50
1317	3.1 Zyrat - private	Depo	Zonat për depozitim të mallrave të pa-ftohura me qëndrim të përkohshëm.	0.0250	140	25	21	12	10	50	0	0	50
1318	3.1 Zyrat - private	Zona e qarkullimit (korridoret dhe shkallët)	Për korridoret dhe shkallët, kur ato janë të ndara nga hapësira e Zyrave, p.sh. kafazi i shkallëve për qasje në pjesë të tjera të ndërtesës.	0.1173	140	25	21	12	10	100	1.85	0	50
1319	3.1 Zyrat - private	Tualeti	Çdo zonë e tualetit. Nëse tualetet janë pjesë e aktiviteteve të zhveshjes/dushit i referohen hapësirave të teshatoreve me dushe.	0.1124	140	25	21	12	12	200	5.48	0	50

1320	3.1 Zyrat - private	Recepcioni	Zona në një ndërtesë që është përdorur për hyrje nga jashtë, nga katet tjera të ndërtesë ose në përgjithësi zona e pritjes që përmban recepcionin.	0.1008	140	25	21	12	10	200	6.19	0.03	39
1321	3.1 Zyrat - private	Dhoma e pajisjeve të lehta	Zonat që përmbajnë pajisjet kryesore të NVK për ndërtesën p.sh. pajisjet si kaldajat/centralet për trajtim të ajrit.	0.1100	180	25	0		10	200	52.5	0	50
1322	3.1 Zyrat - private	Zona e Përgjithshme e Zyrave	Zonat për kryerjen e punëve të zyrës duke përfshirë zyrat dhe dhomat e takimit. Ajo mund të përfshijë korridoret e brendshme që ofrojnë qasje në hapësirat e zyrave, kuzhinat e vogla për çaj brenda hapësirës së zyrave, zonat për fotokopje dhe fakset	0.1110	123	25	21	12	10	400	11.77	0.1965	40.65
1323	3.1 Zyrat - private	Suitë Fitnesi/gjimnastike	Zona që shërben për ushtrime dhe përmban makina.	0.1648	300	25	21	12	30	150	15	0	66

13 24	3.1 Zyrat - private	Dhomë zhveshje me dushe	Zona që përdorët për teshatore e që përmban dushet. Ky aktivitet duhet të përcaktohet si zonë e dusheve me të gjitha hapësirat përcjellëse të teshatoreve. Për zonat të cilat mund të përdoren për teshatore, por të cilat nuk përmbajnë dushe, si që janë ga	0.1000	140	25	21	12	10	100	5	30	50
13 25	3.1 Zyrat - private	Zona për përgatitjen e ushqimit	Zonat ku përgatiten ushqimi apo pijet për stafin dhe vizitorët, p.sh. kushinë në bufe ose në restorantin e zyrave.	0.1080	180	25	17	12	25	500	42.24	0.3 3	65
13 26	3.1 Zyrat - private	Zona e ushqimit/e pijeve	Zonat ku konsumohen ushqimi apo pijet nga personeli dhe vizitorët, p.sh. zonat për tu ulur në bufe dhe restorante të zyrave.	0.2889	110	25	23	12	10	150	14.72	6	39
13 27	3.1 Zyrat - private	Punishte/oficinë - e vogël	Zona për punë të lehta praktike në pozitë të ulur, shpesh përmbajnë disa pajisje, p.sh. prerja e çelsit ose riparim i këpucëve. Sipas përkufizimit, industri e lehtë që nevojitet në Zona banimi.	0.0500	180	25	21	12	10	300	5	0.1	60

1000	3.2 Zyrat - publike	Depo	Zonat për depozitim të mallrave të pa-ftohura me qëndrim të përkohshëm.	0.0250	140	25	21	12	10	50	0	0	50
1001	3.2 Zyrat - publike	Zona e qarkullimit (korridoret dhe shkallët)	Për korridoret dhe shkallët, kur ato janë të ndara nga hapësira e Zyrave, p.sh. kafazi i shkallëve për qasje në pjesë të tjera të ndërtesës.	0.1173	140	25	21	12	10	100	1.85	0	50
1002	3.2 Zyrat - publike	Tualeti	Çdo zonë e tualetit. Nëse tualetet janë pjesë e aktiviteteve të zhveshjes/dushit i referohen hapësirave të teshatoreve me dushe.	0.1124	140	25	21	12	12	200	5.48	0	50
1003	3.2 Zyrat - publike	Recepcioni	Zona në një ndërtesë që është përdorur për hyrje nga jashtë, nga katet tjera të ndërtesë ose në përgjithësi zona e pritjes që përmban recepcionin.	0.1008	140	25	21	12	10	200	6.19	0.03	39
1004	3.2 Zyrat - publike	Dhoma e pajisjeve të lehta	Zonat që përmbajnë pajisjet kryesore të NVK për ndërtesën p.sh. pajisjet si kaldajat/centralet për trajtim të ajrit.	0.1100	180	25	0		10	200	52.5	0	50

1005	3.2 Zyrat - publike	Zona e Përgjithshme e Zyrave	Zonat për kryerjen e punëve të zyrës duke përfshirë zyrat dhe dhomat e takimit. Ajo mund të përfshijë korridoret e brendshme që ofrojnë qasje në hapësirat e zyrave, kuzhinat e vogla për çaj brenda hapësirës së zyrave, zonat për fotokopje dhe faks makinat	0.1110	123	25	21	12	10	400	11.77	0.1965	40.65
1006	3.2 Zyrat - publike	Suitë Fitnesi/gjimnastike	Zona që shërben për ushtrime dhe përmban makina.	0.1648	300	25	21	12	30	150	15	0	66
1007	3.2 Zyrat - publike	Dhomë zhveshje me dushe	Zona që përdorët për teshatore e që përmban dushet. Ky aktivitet duhet të përcaktohet si zonë e dusheve me të gjitha hapësirat përcjellëse të teshatoreve. Për zonat të cilat mund të përdoren për teshatore, por të cilat nuk përmbajnë dushe, si që janë ga	0.1000	140	25	21	12	10	100	5	30	50
1008	3.2 Zyrat - publike	Zona për përgatitjen e ushqimit	Zonat ku përgatiten ushqimi apo pijet për stafin dhe vizitorët, p.sh. kuzhinë në bufe ose në restorantin e zyrave.	0.1080	180	25	17	12	25	500	42.24	0.33	65

10 09	3.2 Zyrat - publike	Zona e ushqimit/e pijeve	Zonat ku konsumohen ushqimi apo pijet nga personeli dhe vizitorët, p.sh. zonat për tu ulur në bufe dhe restorante të zyrave.	0.2889	110	25	23	12	10	150	14.72	6	39
10 10	3.2 Zyrat - publike	Punishte/oficinë - e vogël	Zona për punë të lehta praktike në pozitë të ulur, shpesh përmbajnë disa pajisje, p.sh. prerja e çelsit ose riparim i këpucëve. Sipas përkufizimit, industri e lehtë që nevojitet në Zona banimi.	0.0500	180	25	21	12	10	300	5	0.1	60
12 96	3.2 Zyrat - publike	Parkingu	Zona e destinuar për parking të automjeteve (të mbyllura ose nëntokësore)	0.0059	140	27	0	0	10	100	0	0	50
10 12	3.3 Shitje me pakicë	Lavanderi	Zonë që përdoret vetëm për larje dhe/ose tharje të rrobave duke përdorur makina larëse dhe/ose tharëse rrotulluese. Kjo nuk i përket hapësirave me një makinë individuale larëse brenda një hapësire tjetër (p.sh. zona për përgatitjen e ushqimit).	0.1247	160	25	17	12	12	300	46.35	40	50

1067	3.3 Shitje me pakicë	Zona e qarkullimit (korridoret dhe shkallët) - jo publike	Për të gjitha korridoret jo-publike dhe shkallët. Për hapësirat të qarkullimit publik selekto Zonë e Shitjes- të përgjithshme.	0.1037	140	25	21	12	10	100	2.08	0	50
1068	3.3 Shitje me pakicë	Zona për përgatitjen e ushqimit	Zona ku përgatitet ushqimi.	0.1080	180	25	17	12	25	500	38.19	0.33	65
1069	3.3 Shitje me pakicë	Zona e ushqimit/e pijeve	Zona e projektuar veçanërisht për ngrënie dhe pije.	0.3305	110	25	23	12	10	150	19.1	6	39
1070	3.3 Shitje me pakicë	Dhoma e pajisjeve të lehta	Zonat që përmbajnë pajisjet kryesore të NVK për ndërtesën p.sh. pajisjet si kaldajat / centralet për trajtim të ajrit.	0.1061	180	25	0		10	200	45.88	0	50
1071	3.3 Shitje me pakicë	Zona e Shitjes me Dyqane të Vogla – e përgjithshme	Të gjitha zonat e Shitjes në Njësitë e Dyqaneve të vogla të cilat nuk kanë përqendrim të madh të frigoriferëve / ngrirësve ose aparateve elektrike.	0.1169	140	25	21	12	10	600	5.2	0.04	50
1072	3.3 Shitje me pakicë	Zona e Shitjes me Dyqane të Vogla – e ftohur	Zona e shitjes në Njësitë e Dyqaneve të Vogla projektuara për të akomoduar një sasi të konsiderueshme të frigoriferëve / ngrirësve si që janë supermarketet apo sallat e ushqimit.	0.1169	140	25	21	12	10	600	25	0.04	50

1073	3.3 Shitje me pakicë	Zona e Shitjes me Dyqane të Vogla – elektrike	Zonat e shitjes në Njësitë e Dyqaneve të Vogla projektuara për të akomoduar një sasi të konsiderueshme të pajisjeve elektrike si që janë zonat e shitjes së ndriçueseve dhe zonat e shitjes IT/TV/Hi-Fi .	0.1169	140	25	21	12	10	600	52.04	0.04	50
1074	3.3 Shitje me pakicë	Depo	Zonat për depozitim të mallrave të pa-ftohura me qëndrim të përkohshëm.	0.1037	140	25	21	12	10	50	0	0	50
1077	3.3 Shitje me pakicë	Tualeti	Çdo zonë e tualetit	0.1037	140	25	21	12	12	200	4.17	0	50
1078	3.3 Shitje me pakicë	Zona e Përgjithshme e Zyrave	Zonat për kryerjen e punëve të zyrës duke përfshirë zyrat dhe dhomat e takimit. Ajo mund të përfshijë korridoret e brendshme që ofrojnë qasje në hapësirat e zyrave, kuzhinat e vogla për çaj brenda hapësirës së zyrave, zonat për fotokopje dhe faks makinat	0.0951	123	25	21	12	10	400	12.18	0.1965	40.65
1295	3.3 Shitje me pakicë	Parkingu	Zona e destinuar për parking të automjeteve (të mbyllura ose nëntokësore)	0.0043	140	27	0	0	10	100	0	0	50

1297	3.3 Shitje me pakicë	Vitrina	Zona në të cilën ndriçimi displej përdoret për ndriçimin e produkteve me xhamëzim sipër nga jashtë, si që janë vitrinat e dyqaneve, por të cilat janë në kuti/të mbyllura, të ndara nga hapësira kryesore e shitjes.	0.0433	140	25	21	12	10	50	1.89	0	50
1305	3.3 Shitje me pakicë	Zona e shitjes me pakicë – të përgjithshme	Të gjitha zonat e Shitoreve të Mëdha të cilat nuk kanë përqendrim të madh të frigoriferëve/ngrirësve ose aparateve elektrike.	0.1169	140	25	21	12	10	600	5.2	0.04	50
1306	3.3 Shitje me pakicë	Zona e shitjes me pakicë – e ftohur	Të gjitha zonat e Shitoreve të Mëdha të projektuara për të akomoduar sasi të konsiderueshme të frigoriferëve/ngrirësve ose aparateve elektrike.	0.1169	140	25	21	12	10	600	25	0.04	50
1307	3.3 Shitje me pakicë	Zona e shitjes me pakicë – elektrike	Zonat e Shitoreve të Mëdha projektuara për të akomoduar një sasi të konsiderueshme të pajisjeve elektrike si që janë zonat e shitjes së ndriçueseve dhe zonat e shitjes IT/TV/Hi-Fi .	0.1169	140	25	21	12	10	600	52.04	0.04	50

1308	3.3 Shitje me pakicë	Zona e shitjes me shumicë – të përgjithshme	Të gjitha zonat e Depove për Shitje të cilat nuk kanë përqendrim të madh të frigoriferëve/ngrirësve ose aparateve elektrike.	0.1169	140	25	21	12	10	600	5.2	0.04	50
1309	3.3 Shitje me pakicë	Zona e shitjes me shumicë – e ftohur	Të gjitha zonat e Depove për Shitje të projektuara për të akomoduar sasi të konsiderueshme të frigoriferëve/ngrirësve ose aparateve elektrike.	0.1169	140	25	21	12	10	600	25	0.04	50
1310	3.3 Shitje me pakicë	Zona e shitjes me shumicë – elektrike	Zonat e Depove për Shitje të projektuara për të akomoduar një sasi të konsiderueshme të pajisjeve elektrike si që janë zonat e shitjes së ndriçueseve dhe zonat e shitjes IT/TV/Hi-Fi .	0.1169	140	25	21	12	10	600	52.04	0.04	50
1208	4.1 Arsimi - Shkollat	Dhomë zhveshje me dushe	Zona që përdorët për teshatore e që përmban dushet. Ky aktivitet duhet të përcaktohet si zonë e dusheve me të gjitha hapësirat përcjellëse të teshatoreve.	0.1414	140	25	21	12	10	100	4.85	30	50
1209	4.1 Arsimi - Shkollat	Zona e qarkullimit (korridoret dhe shkallët)	Për të gjitha zonat te qarkullimit si që janë korridoret dhe shkallët.	0.1100	140	25	15	12	10	100	2	0	50

12 10	4.1 Arsimi - Shkollat	Palestra të mbyllura	Zona ku mund të luhen sportet e brendshme, të palestrës.	0.0527	300	25	15	12	10	300	1.94	0	66
12 11	4.1 Arsimi - Shkollat	Zona e ushqimit/e pijeve	Zona për ulje ku konsumohen ushqimi dhe pijet.	0.2000	110	25	23	12	10	150	18.54	6	39
12 12	4.1 Arsimi - Shkollat	Zona për përgatitjen e ushqimit	Zona ku është përgatitur ushqim, p.sh. bufe e kuzhinës	0.1815	180	25	17	12	25	500	49.5	0.3 3	65
12 13	4.1 Arsimi - Shkollat	Holli/salla e ligjëratave/hap ësirë e takimeve	Zona që mund të akomodojë një numër të madh të njerëzve të ulur.	0.2183	140	25	21	12	10	300	2	0.1 5	39
12 14	4.1 Arsimi - Shkollat	Sallë e kompjuterëve	Hapësira me densitet të lartë të punës në tavolinë dhe densitet përkatës të IT.	0.2183	120	25	21	12	10	300	30	0.6	39
12 15	4.1 Arsimi - Shkollat	Laboratori	Impiant që siguron kushte të kontrolluara në të cilat mund të kryhen hulumtime shkencore, eksperimente dhe matje.	0.2099	160	25	21	12	12	800	10.95	0	39
12 16	4.1 Arsimi - Shkollat	Dhoma e pajisjeve të lehta	Zonat që përmbajnë pajisjet kryesore të NVK për ndërtesën p.sh. pajisjet si kaldajat/centralet për trajtim të ajrit.	0.1100	180	25	0		10	200	50.5	0	50
12 17	4.1 Arsimi - Shkollat	Recepcioni	Zona e ndërtesës e cila përdoret për hyrje nga jashtë ose nga katet tjera të ndërtesës.	0.1155	140	25	21	12	10	200	5.59	0.0 3	39

12 18	4.1 Arsimi - Shkollat	Depo	Zonat për depozitim të mallrave të pa-ftohura me qëndrim të përkohshëm.	0.1210	140	25	21	12	10	50	0	0	50
12 19	4.1 Arsimi - Shkollat	Pishinë	Zona që përmban një pishinë. Ky aktivitet duhet të përdoret për tërë sallën e pishinës.	0.1458	160	32	28	12	15	300	2	0	66
